


UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

**FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE
SHKENCAVE POLITIKE**

PROGRAMI STUDIMOR: DIPLOMACI

**UNIVERSITETI I EJK
JNE YHIBEP3HTET
SEE UNIVERSITY**



PUNIM MAGJISTRATURE

**Tema: “Toleranca imperiale dhe multikulturalizmi - shembull
Sistemi i Miletit”**

Mentori:

Prof. dr. Ali Pajaziti

Kandidati:

Besim Musliu

Tetovë, 2019

PËRMBAJTJE

ABSTRAKT	5
АΠΙCΤΡΑΚΤ	6
ABSTRACT	7
HYRJE	8
LËNDA E HULUMTIMIT	9
QËLLIMI I HULUMTIMIT	9
HIPOTEZAT	9
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	10
RËNDËSIA E PUNIMIT	12

KAPITULLI I

SHTETI OSMAN – HISTORIKU

I.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SHTETIN OSMAN	14
I.1.1 Origjina e turqve	14
I.1.2 Ngritja dhe rënia e Shtetit Selxhuk	15
I.1.3 Ngritja e Perandorisë Osmane	16
I.1.4 Dobësimi i Perandorisë Osmane	19
I.1.5 Rënia e Perandorisë Osmane	20
I.1.6 Rregullimi shtetëror i Perandorisë Osmane	21
I.1.7 Karakteristikat demografike të Perandorisë Osmane	22
I.2 TË DREJTAT E MUSLIMANËVE DHE JOMUSLIMANËVE NË PERANDORINË OSMANE	24
I.2.1 Përbërja fetare e popullsisë së Perandorisë Osmane	24
I.2.2 Kushtetuta e Perandorisë Osmane	27
I.2.3 Të drejtat e muslimanëve në Perandorinë Osmane	28

I.2.4 Të drejtat e jomuslimanëve në Perandorinë Osmane.....	29
<i>I.2.4.1 Të drejtat dhe liritë e të krishterëve në Perandorinë Osmane.....</i>	29
<i>I.2.4.1 Të drejtat dhe liritë e hebrenjve në Perandorinë Osmane.....</i>	30
I.3 REFORMAT GJATË PERIUdhËS SË TANZIMATIT.....	32
I.3.1 Kuptimi për Tanzimatin.....	32
I.3.2 Reformat e Tanzimatit.....	32
I.3.3 Impakti i Reformave të Tanzimatit në Shqipëri.....	34

KAPITULLI II

TOLERANCA DHE MULTIKULTURA

II.1 TOLERANCA NË SHTETIN OSMAN.....	38
II.1.1 Kuptimi për tolerancën.....	38
II.1.2 Toleranca në Perandorinë Osmane.....	39
II.2 SHOQËRIA MULTIKULTURORE DHE CIVILIZIMI OSMAN.....	41
II.2.1 Shoqëria multikulturore në Perandorinë Osmane.....	41
II.3 TOLERANCA FETARE DHE KOMBËTARE NË PERANDORINË OSMANE – SISTEMI I MILETIT.....	47
II.3.1 Kuptimi i fjalës millet.....	47
II.3.2 Miletet.....	48
<i>II.3.2.1 Mileti musliman (Ummeti).....</i>	48
<i>II.3.2.2 Mileti ortodoks.....</i>	49
<i>II.3.2.3 Mileti armen.....</i>	49
<i>II.3.2.4 Mileti hebre.....</i>	50
II.3.3 Sistemi i Miletit.....	51

KAPITULLI III

SISTEMI I MILETIT DHE REFLEKSIONET E TIJ NË SHEKULLIN XXI

III.1 SHOQËRIA MODERNE E SHEKULLIT XXI DHE REFLEKSIONI I SISTEMIT TË MILETIT NË TË.....	58
--	----

III.1.1 Kuptimi për shoqërinë.....	58
III.1.2 Shoqëria moderne.....	59
III.1.3 Refleksioni i Sistemit të Miletit në shoqërinë moderne.....	62
III.2 SHOQËRIA MULTIKULTURORE NË MAQEDONI – SHEMBULLI I PROJEKTIT SKANDALLOZ “SHKUPI 2014”	70
III.2.1 Përbërja kombëtare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë.....	70
III.2.2 Përbërja fetare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë.....	72
III.2.3 Projekti “Shkupi 2014”: Kontrovers dhe tendencioz.....	77
III.3 KOHA MODERNE – SENSI I PATRIOTIZMIT KOMBËTAR DHE TOLERANCA TEK SHQIPTARËT	81
III.3.1 Sensi i patriotizmit kombëtar tek shqiptarët.....	81
III.3.2 Toleranca fetare tek shqiptarët.....	83
PËRFUNDIME.....	87
LITERATURA E SHFRYTËZUAR.....	91

ABSTRAKT

Perandoria Osmane ka qenë njëra nga perandoritë më të mëdha që njeh historia botërore. Kjo perandori gjatë zhvillimit të saj përgjatë historisë ka pasur shtrirje territoriale të ndryshme dhe njëherit edhe ka pasur numër të ndryshëm të popullsisë. Duhet theksuar se gjatë shekullit XVI ka pasur shtrirje më të madhe territoriale, përkatësisht është shtrirë në tre kontinente: Evropë, Azi dhe Afrikë. Gjatë periudhës kur me Perandorinë Osmane ka udhëhequr sulltan Sulejmani, territori i saj është shtrirë në Evropën Juglindore, në një pjesë të caktuar të Evropës Qendrore, në vendet e Kaukazit, Azinë e Vogël, Azinë Jugperëndimore, Afrikën Veriore dhe përgjatë bregdetit të Detit të Kuq. Pra, shtrirje më të madhe territoriale ka pasur në vitin 1683, kur sipërfaqja e saj ka arritur 5.200.000 km². Ndërsa në vitin 1914 Perandoria Osmane është shtrirë në një territor prej 1.800.000 km². Perandoria Osmane zgjerim më të madh territorial ka arritur në shekullin e XVI, më saktë bëhet fjalë për kohën e sulltan Sulejman Kanunit. Koha e sulltan Sulejman Kanunit konsiderohet Etapa e Artë e Perandorisë Osmane, ngase në vitet që ai ishte në pushtet, pra në vitet 1520-1566, kjo perandori përjetoi një zgjerim shumë të madh që nuk ishte parë ndonjëherë më parë. Kjo shfaqje dhe ky afirmim ndikoi që në vendet perëndimore, e sidomos në vendet evropiane, të cilat përjetonin përçarje të rrezikshme politike dhe fetare.

Qëllimi për të cilin u formua Perandoria Osmane ishte mbrojtja e Islamit, ngritja e flamurit të tij në lindje të Azisë së Vogël dhe shkatërrimi i Bizantit që kërcënonte muslimanët. Osmani ftoi muslimanët që të bashkohen nën flamurin islamik. Kjo porosi u bë platformë në të cilën bazoheshin udhëheqësit e Perandorisë në kohën e fuqisë, krenarisë dhe dominimit të tyre. Ftesës së tij iu përgjigjën shumë njerëz, të cilët i nxiste dëshira e madhe për të ndihmuar Islamin dhe për ta rrëzuar Perandorinë Bizantine.

Perandoria Osmane ka qenë një shtet i të gjithë qytetarëve dhe aty kanë gjetur trajtim të drejtë të gjithë qytetarët pa dallim race, kombësie, feje apo dallimi shoqëror. Jomuslimanët kanë gëzuar të gjitha të drejtat dhe liritë që ju kanë takuar. *Sistemi i Miletit* ishte një sistem që u vendos në Perandorinë Osmane në periudhën nga shekulli XVI e deri në fillim të shekullit XX. Ky sistem kishte të bëjë, apo më saktë përcaktonte me ligj statusin e pakicave jomuslimane dhe autonominë e bashkësive fetare. Gjatë ekzistencës së saj 600 vjeçare, Perandoria Osmane u zhvillua si një sistem shtetëror shumë-besimësh. Sistemi i Miletit përbënte sistemin ligjor të statusit të secilës bashkësi të veçantë fetare dhe të gjithë jomuslimanëve në bazë të së drejtës islamike. Domethënë milletet ishin formuar në bazë të feve jo sipas aspektit kombëtar.

“Një pakicë çifute mund të mbijetojë në të njejtën mënyrë që kanë mbijetuar në botën arabe pakicat e tjera... nën Perandorinë Osmane, me sistemin e milletit, kjo funksionoi fare mirë. Ajo që kishin ata atëherë duket shumë më njerëzore nga kjo që kemi tani”.

Edward SAID, për gazetën Haaretz

Fjalë kyçe: Perandoria Osmane, Islam, Sistemi i Miletit, muslimanët, jomuslimanët, bashkësitë fetare.

АПСТРАКТ

Османската Империја била една од најголемите империи што познава светската историја. Оваа империја за време на својот развој во текот на историјата имало разнo територијално распространство, но истотака во неа бројот на жителите бил менлив. Треба да се потсети дека за време на XVI век, Османската Империја имало најголемо територијално распространство, поточно таа била распространета на трите континенти: Европа, Азија и Африка. Во периодот кога со Османлиската Империја го раководел султан Сулејман, неговата територија имало распространство во Југоисточна Европа, во дел од Централна Европа, во Кавказ, Мала Азија, Југозападна Азија, Северна Африка и по крајбрежјето на Црвено Море. Значи, таа најголемо територијално распространство имало во 1683 година, кога неговата територија достигнала површина од 5.200.000 км². Додека во 1914 година, Османлиската Империја се распространила во територија со површина од 1.800.000 км². Периодот на владеењето на султан Сулејман се назначува како Златна епоха на Османлиската Империја, затоа што за времето на неговото владеење, поточно во периодот од 1520-1566, ова империја доживеа најголемо распространување што не беше остварено никогаш претходно.

Целта за која се формирало Османлиската Империја било заштитувањето на Исламот, издигнувањето на неговото знаме во истокот на Мала Азија и уништувањето на Византиската Империја која била ризик за муслиманите. Царот Осман ги повика муслиманите за да се обединат под исламското знаме. Ова порака се претвори во платформа во која се базирале владетелите на Османлиската Империја за времето на нивната сила, гордоста и нивната доминација. На неговата покана му одговорија многу луѓе, кои ги поттикнуваше големата желба за да помогнат Исламот и од друга страна да го урнат Византиската Империја.

Османлиската Империја било држава на сите граѓани и во неа нашле правичен третман сите граѓани без разлика на расата, националноста, верската припадност или социјалната состојба. Немуслиманите во потполност ги оствариле сите права и слободи што им припаднале ним. *Милетскиот систем* бил систем кој се вовел во Османлиската Империја во периодот почнувајќи од XVI век па се до почетокот на XX. Овој систем со закон го регулираше статусот на немуслиманските малцинства и автономноста на верските заедници. За време на 600 годишното егзистирање, Османлиската Империја се развивало како систем на држава со разни вери. Милетскиот систем го означуваше системо-правниот статус на сите верски заедници и на немуслиманите врз основа на исламското право. Значи дека милетите биле формирани врз основа на верата но не врз етничката припадност.

“Едно еврејско малцинство може да опстојува исто како што опстоиле другите малцинства во арапскиот свет... под Османлиската Империја, ова со Милетскиот систем функционирало многу добро. Тоа што тие го имале тогаш било почовечно од тоа што го имаме ние сега”.

Edward SAID, за весником Haaretz

Клучни зборови: Османлиската Империја, Ислам, Милетски систем, муслиманите, немуслиманите, верските заедници.

ABSTRACT

The Ottoman Empire was one of the biggest empires that the world history knows. Throughout history the development of this empire marked different territorial expansions and it also had a variable number of population. It must be emphasized that during the sixteenth century the empire achieved its biggest territorial expansion. It was expanded into three continents: Europe, Asia and Africa. During the reign of sultan Suleyman, its territory was expanded into southeastern Europe, in some parts of Central Europe, in Kavkaz, Small Asia, southwestern Asia, north Africa and along the coast of Red Sea. Its biggest territorial expansion was achieved in 1683, with a total area of 5.200.000 square kilometers. While in 1914, the empire had a territory of 1.800.000 km². The biggest territorial expansion was achieved in the sixteenth century, during the reign of sultan Suleyman Kanun. His period is considered as the golden age of the empire, because during his reign, i.e. 1520-1566, the empire experienced an expansion which had never been seen before. This affirmation and development alerted the western countries, especially the European countries which at that time were experiencing dangerous political and religious dissensions. The reason why the Ottoman Empire had been formed was the protection of Islam, raising Islamic Flag in the eastern part of Asia Minor and the destruction of Byzantium which threatened Muslims. The empire invited Muslims to join under the Islamic Flag. This message became a platform of leaders of the empire in the verge of power, pride and their domination. A lot of people responded to this invitation, who were driven by their desires to help Islam and ruin the Byzantium Empire.

The Ottoman Empire was a state of all its citizens. There was equal treatment among all citizens, no matter their race, ethnicity, religion or social status. Non-Muslims had all the rights and freedoms like the other citizens. The system of Milet was a system which was established in the Ottoman Empire from the sixteenth to the beginning of the twentieth century. This system had to do with the laws referring to Non-Muslim minorities and the autonomy of religious unions. During its existence of six hundred years, the Ottoman Empire developed as a state system of multiple religions. The system of Milet constituted the law system of statuses of every special religious union and all the other statuses referring to Non-Muslims based on the Islamic Law. This shows that the milets were formed on the basis of religion not on the basis of nationality.

“A Jewish minority could survive at the same time like the other minorities survived in the Arab world under the Ottoman Empire with the help of the system of millet. This functioned quite well. What they had at that time, seems to be more human than that what we have nowadays”.

Edward SAID - for the newspaper Haaretz.

Keywords: Ottoman Empire, Islam, System of Milet, Muslims, Non-Muslims, Religious Unions.

HYRJE

Në fillim të shekullit XIV, në kufijt në mes Bizanit dhe shtetit Selxhuk, si një bejlluk (pashallëk) i vogël ishte themeluar Shteti Osman, i cili pas një periudhe të shkurtër kohore duke u rritur arriti në nivelin e një shteti shumë të fortë, i cili ishte në gjendje të ndryshojë rrjedhën e historisë. Osmanlinjtë si bartës të identitetit të një strukture shoqërore muslimane, duke e pranuar apo adaptuar të drejtën e Sheriatit Islam, kishin siguruar vazhdimësinë e këtij sistemi në të gjitha institucionet e shtetit. Qasja e njohur si tolerance, është njëri nga faktorët më të rëndësishëm që e dallon Shtetin Osman, si një shtet turko-islam nga shtetet tjera moderne. Osmanlinjtë për shkak të qasjes tolerante, siç nuk cënoi lirinë fetare dhe të ndërgjegjes si elemente vendore të atyre që i kishin marrë nën administrimin e tyre, gjithashtu edhe i mbrojti nga çdo lloj shtypje dhe rrezik.

Perandoria Osmane është një shembull historik parë në aspektin e bashkëjetesës së grupeve të ndryshme fetare dhe sociale, që ishin pjesë e strukturës popullore të tij, gjatë periudhës me tepër se 600 vjeçare të ekzistimit të kësaj perandorie. Në Perandorinë Osmane, muslimanëve, krishterëve dhe hebrenjve (çifutëve), siç iu ishte garantuar mundësia e realizimit të ritualeve fetare dhe pasurimit të identitetit të tyre kulturor, ashtu edhe duke treguar respekt për besimet dhe traditat juridike të ndryshme të çdo shoqërie, ishte siguruar mundësia e zbatimit apo ndjekjes së traditave dhe mënyrave të tyre të jetuarit. Perandoria Osmane ishte shteti i vetëm më i madh që në periudhën e mesjetës, njohu apo pranoi zyrtarisht tre fetë monoteiste dhe që garantoi të jetuarit bashkërisht në mënyrë të harmonizuar të anëtarëve të grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare.

Sistemi i Miletit ishte një sistem mjaft i veçantë që ekzistoi në Perandorinë Osmane gjatë gjithë historisë së ekzistimit të saj. Ky sistem funksionoi në mënyrë të përkryer në Perandorinë Osmane, respektivisht ai mundësoi që të gjithë popujt me fe të ndryshme t'i gëzojnë të drejtat tyre fetare dhe të jetojnë në harmoni të plotë me njëri-tjetrin. Perandoria Osmane ekzistoi derisa secili e ndjente shtetin si të tijin, pra ishte i kënaqur me kushtet jetësore, të drejtat dhe liritë që gëzonte. Ligji vlente për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë fetare, kombëtare, racore apo klasore. Kur humbi drejtësia dhe barabarësia, kur humbën vlerat morale, humbi toleranca dhe respekti, atëherë erdhi shembja e Perandorisë Osmane.

Në punim flitet për Perandorinë Osmane, respektivisht fillimin e formimit të saj, fuqinë e saj, dobësimin dhe në fund shkatërrimin e saj, Sistemin e Miletit, respektivisht cilat janë veçoritë e tij, sa ekzistoi ai, si funksionoi dhe refleksionet e mundshme të tij në kohën e sotme. Punimi përbëhet nga tre kapituj dhe ato janë: **Shteti Osman-Historiku, Toleranca dhe Multikultura, dhe Sistemi i Miletit dhe Refleksionet e tij në shekullin XXI.**

LËNDA E HULUMTIMIT

Në këtë punim shkencor do të hulumtohet funksionimi dhe praktikimi i sistemit të Miletit. Sistemi i Miletit është nocion që nënkupton bashkësi fetare. Ky term iu referohej popujve jomuslimanë, pra konkretisht kishte të bëjë me grekët, armenët dhe jehudët. Sistemi i Miletit ka qenë prezent në periudhën e osmanlinjve dhe atë nga shekulli XV e deri në fillim të shekullit XX. Ky sistemi përcaktonte me ligj statusin e pakicave jo-muslimane dhe autonominë e bashkësive fetare.

Gjatë ekzistencës 600 vjeçare të Perandorisë Osmane u zhvillua një sistem shtetëror ku respektoheshin të drejtat e gjitha besimeve. Sistemi i Miletit përbënte sistemin ligjor të përcaktimit të statusit të secilës bashkësi të veçantë fetare dhe të gjithë jo-muslimanëve në bazë të drejtës islamike. Ky sistem u garantonte grupeve fetare disa të drejta, në mënyrë që ata t'i regullojnë vet çështjet e tyre. Me fjalë të tjera termi *“milet”* e ka kuptimin e bashkësisë fetare.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij punimi shkencor qëndron në atë se, që opinionin të informohet apo t'ia bëjmë më të qartë funksionimin e sistemit të Miletit. Pra, të bëhet e qartë mënyra e funksionimit të këtij sistemi, karakteristikat e tij dhe rëndësia e tij sa i përket respektimit të të drejtave të pakicave kombëtare dhe fetare në Perandorinë Osmane.

Qëllimi kryesor i këtij punimi qëndron kryesisht në këto dy shtylla bazë: dalja në pah mënyrës së respektimit të të drejtave të njeriut në një periudhë që ka të bëjë para shekullit XX-të, dhe nga ana tjetër, si mund që Sistemi i Miletit sot të përdoret dhe të jetë funksional në shoqërinë e kohës tonë. Sistemi i Miletit lirisht mund të shërbejë si shembull për atë se si duhet sillen ligjet lidhur me të drejtat e pakicave kombëtare dhe fetare në çdo shtet të moderuar.

HIPOTEZAT

Njëra nga hipotezat është ajo se toleranca është një bazë e mirë për të funksionuar normalisht një shoqëri multikulturore dhe se në vendin tonë ekziston mundësia që të ketë tolerancë në mes grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare. Në vendin tonë ka mundësi që grupet e ndryshme kombëtare të afrohen në mes vete përmes arsimit, organizimeve të ndryshme kulturore, artistike etj.

Sistemi i Miletit mund të merret si bazë për tolerancë dhe respekt ndërmjet grupeve të ndryshme kombëtare. Edhe pse ky sistem vlerash ka të bëjë me një periudhë të kaluar, ai mund të jetë bazë edhe për kohën e sotme. Ai gjithsesi se mund të vlerësohet si sistem mjaft i mirë sa i përket respektimit të ndërsjelltë në mes grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare.

Deri më sot politika në vend edhe pse ka bërë thirrje për tolerancë dhe respekt, ajo në fakt ka organizuar fshehtas grupe të ndryshme që të destabilizojnë vendin, me çka kanë ndikuar që të thellohen dallimet dhe të ketë armiqësi në shoqëri. Por, sot me ndryshimin e pushtetit kanë filluar ndryshimet dhe se ngadalë po përmirësohen marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni.

Multikulturalizmi ka qenë dhe duhet të jetë një pasuri e madhe për një shtet, ngase një shtet mjaft ineteressant është kur dallohet me një shoqëri multikulturore. Shteti jonë është një nga shtetet multikulturore në Evropë dhe botë, ku aktorë të fushave të ndryshme duhet të punojnë për ngritjen e urave të bashkëpunimit mes grupeve kombëtare dhe fetare, t'i largojnë paragjykimet dhe ndarjet, por të thërrasin për tolerancë, respekt të ndërsjellt dhe bashkëpunim.

Multikulturalizmi dhe respektimi i të drejtave të njeriut, paraqesin vlera të mëdha të cilat janë bazë për integrim në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Njëri ndër segmentet më bazike të Bashkësisë Evropiane është toleranca, multikulturalizmi dhe respektimi i të drejtave të njeriut, qoftë ato kombëtare, fetare, gjinore etj. Maqedonia përderisa po bën përpjekje për t'iu bashkuar BE-së, ajo duhet të plotësojë disa kriterë bazike, ku ndër to janë edhe të drejtat e njeriut, të cilat deri më tani janë shkelur në mënyrë flagrante nga ana e pushtetit.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Mbi bazën e referimit të një sistemi rregullash kërkimore, në përputhje studimin shkencor të problematikës gjegjëse, do ti qasem hulumtimit dhe studimit me këto metoda:

- *Analiza e përmbajtjes*
- *Metoda e analizës dhe sintezës*
- *Metoda komparative*
- *Metoda e dokumentacionit,*
- *Metoda e të dhënave kuantitative dhe statistikore.*

- **Analiza e përmbajtjes**

Kjo metodë është njëra nga metodat që përdoret në punimet që kanë të bëjnë me pjesë nga historia, pra me ndodhitë në periudha të ndryshme historike. Padyshim se kjo metodë është e nevojshme që të përdoret edhe në këtë punim, duke pasur parasysh se kemi si shembull Sistemin e Miletit, i cili ka qenë i pranishëm në një periudhë të caktuar historike, më sakt në shekullin e XIX, në Perandorinë Osmane. Kjo metodë na mundëson që të njihemi me informacione mjaft të nevojshme, të cilat e kanë karakterizuar një periudhë historike, si dhe na mundëson që të bëjmë krahasim të disa veçorive shoqërore që kanë qenë të pranishme në periudhat e kaluara dhe si janë tani. Metoda historike është mjaft e rëndësishme dhe që ndihmon në përpilimin e punimit.

▪ Metoda e analizës dhe sintezës

Përdorimi i metodës së analizës bëhet në fillim dhe është mjet i hulumtimit, ndërsa sinteza është përfundimi i qëllimit të hulumtimit. Me anë të analizës i kuptojmë njohuritë dhe karakteristikat e gjërave që trajtohen, ndërsa me anë të sintezës i kuptojmë lidhjet dhe raportet e tyre si sistem i njësuar.

Përdorimi i metodës së analizës në hulumtimet kërkimore aplikuar në punim, nënkupton studimin e mirëfilltë të elementeve përbërëse të temës së punimit dhe atë: duke përfshirë tolerancën, multikulturalizmin dhe Sistemin e Miletit, si shembull më i mirë.

Metoda e sintezës është parim kërkimor-hulumtues në ndarjen e fenomeneve, problemeve dhe proceseve në grupe, me të gjitha dallimet dhe ndërlidhjet midis tyre. Në këtë drejtim parimi i kësaj metode në rastin tonë mund të jetë: *sinteza deskriptive dhe sinteza funksionale*.

▪ Metoda e dokumentacionit

Me fjalën klasifikim nënkuptohet parimi kërkimor me anë të cilit ndonjë kuptim i përgjithshëm, me përcaktimin e parimeve ndahet në pjesë përbërëse dhe në faktorë. Kjo metodë është parakusht për analizën kërkimore-shkencore.

Metoda kuantitative (sasiore) dhe statistikore

Karakteristikat e sistematizimit të tipave të të dhënave statistikore shpjegojnë dinamikën dhe manifestimet e dukurive, problemeve, proceseve nga të cilat mund të sjellim edhe qëndrime për të njëjtat probleme. Rezultatet e analizave të shumta statistikore shprehen në disa forma të ndryshme dhe atë: në formë ilustrimesh, me anë të tabelave etj.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Si çdo punim shkencor që shkruhet, poashtu, edhe ky shpresojmë të jetë një prurje për audiencën shkencore dhe akademike, si dhe do t'iu përgjigjet pyetjeve të padefinuara, në mënyrë të qartë dhe me metodologji shkencore.

Si në të kaluarën, por edhe sot, në debate të ndryshme mjaft e diskutuar është çështja që ka të bëjë me tolerancën dhe multikulturalizmin. Edhe pse shtetet demokratike merren si shembull i mirë i tolerancës në mes grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare, mirëpo, nuk duhet harruar se edhe në sistemet e dikurshme shtetërore ka ekzistuar toleranca në mes grupeve të ndryshme kombëtare dhe fetare. Ajo është me rëndësi që në paqe të jetojnë grupet e ndryshme kombëtare dhe fetare. Pa tolerancë gjithsesi se nuk ka mundësi që grupet e ndryshme shoqërore të jetojnë në qetësi, por të ndarë dhe në armiqësi të përhershme.

Sa i përket multikulturalizmit, ne duhet fillimisht të nisemi nga ajo se shembull është edhe vendi jonë, në të cilin jetojnë disa grupe kombëtare dhe religjioze, të cilat kanë dallime të theksuara në kulturë, tradita, në mënyrën e organizimit të jetës, në praktikimin e fesë dhe në shumë gjëra tjera. Sikur shteti jonë që dallohet me multikulturalizëm, njësoj janë edhe shumë shtete tjera në Evropë dhe botë. Por, në shumë vende, grupi kombëtar më i madh pretendon të ushtrojë dominim mbi grupet e tjera kombëtare, gjë që shihet si veprim qëllimkeq. Probleme kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë në shoqëritë multikulturore, por ato duhet të tejkalohen duke gjetur gjuhë të përbashkët, pra me anë të tolerancës.

Rëndësia e punimit qëndron kryesisht në paraqitjen e shembujve më të mirë të tolerancës në shoqëritë multikulturore, si vlerë morale, e cila ka ekzistuar dhe duhet të ekzistojë edhe në ditët e sotme. Përmes punimit për aktorët e pushtetit qendror dhe lokal, për pjesëmarrësit në shoqëritë civile dhe aktorë jepet mesazh për tolerancë dhe vlerësim të vlerave të tjetrit, se vetëm kështu është e mundur jeta e përbashkët.

KAPITULLI I

SHTETI OSMAN - HISTORIKU

I.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI SHTETIN OSMAN

I.1.1 Origjina e turqve

Në rajonin që sot quhet Turkistan kanë fiset oguz dhe familjet e tyre të mëdha, të cilat u njohën me emrin turk ose turq (turk-etraq). Fiset oguz banuan këtë hapësirë gjeografike: në lindje fillon nga Rrafshlarta e Mongolisë dhe pjesës veriore të Kinës, në perëndim shkon deri te Deti Kazvin, në veri duke filluar nga rrafshinat e Siberisë dhe duke shkuar në jug deri tek gadishulli i Indisë dhe rrafshlarta e Iranit (Persisë). Turqit selxhukë ishin fise nomade, pra fise që kryesisht merreshin me blegtori dhe gjithmonë në lëvizje. Lëvizja e vazhdueshme e tyre ishte për shkak të gjetjes së kullotave të bujshme për bagëtinë.

Deri në shekullin e VI, familjet turke jetonin në rajonin e Turkestanit, mirëpo në gjysmën e dytë të shekullit VI, ato filluan që të lëvizin nga vendbanimet ku jetonin në drejtim të Azisë së Vogël. Me rëndësi është të përmendet se, lëvizjet e tyre në drejtim të Azisë së Vogël ishin për shkaqe të ndryshme. Historianët përmendin një sërë shkaqesh që ndikuan në shpërnguljen e tyre drejt Azisë së Vogël.

Disa historianë shprehin mendimin se, shpërngulja e familjeve turke nga vendlindja e tyre ishte kryesisht për shkaqe ekonomike. Ato nuk kishin mundësi t'i siguronin kushtet ekzistenciale për jetë në atdheun e tyre, andaj u shpërngulën duke kërkuar kullota të bujshme, tokë pjellore dhe pasuri tjera natyrore. Pra, një gjë e tillë i detyroi ato që të shpërngulen në drejtim të Azisë së Vogël, ku ekzistonin kushte mjaft të volitshme për jetë.

Ndërsa, disa historianë tjerë këto shpërngulje i konsiderojnë të bëra për shkaqe politike. Shkaku politik i shpërnguljeve që u bënë nga familjet turke kishte të bëjë me shtypjet që ua bënin fiset mongole. Fiset mongole dhe familjet e tyre njiheshin si mjaft agresive në Azi, ato përveç se paraqisnin kërcënim për familjet turke, njëherit ishin kërcënim serioz edhe për kinezët dhe fiset e tjera që jetonin në Azi.

Familjet turke duke lënë trojet e veta, filluan të hulumtojnë për vende të reja, ku do të kishin një jetë më të mirë e të sigurt. Ato u detyruan t'ia mësynin anës perëndimore dhe zbritën afër bregut të lumit Xhejhun (lumit Amu Darja). Për një kohë të caktuar qëndruan në Taberistan dhe Xhurxhan, ku ishin më afër tokave islame, të cilat muslimanët i çliruan pas betejës së Nehavendit dhe rënies së shtetit të sasanitëve në vendet persiane dhe atë gjatë vitit 641.¹

Ushtritë islame në vitin 642 lëvizën në drejtim të vendeve të Babit, me qëllimin që t'i çlirojnë ato. Ato toka ishin të banuara nga familjet turke. Komandanti i ushtrisë islame Abdurrahman bin Rebia u takua me mbretin e turqve, mbretin Shehirbraz, i cili kërkoi nga Abdurrahmani të bëjë marrëveshje paqeje, duke i shprehur gatishmëri për pjesëmarrjen e ushtrisë

¹ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 27.

islame në luftë kundër armenëve. Komandanti i ushtrisë islame Abdurrahmani e dërgoi atë te komandanti i përgjithshëm Suraka bin Amër, ku kyi fundit i dërgoi letër halifit Umer bin el-Hatab, duke e informuar lidhur me rastin. Halifi Umer bin el-Hatabi miratoi marrëveshjen dhe pas kësaj nuk ka ndodhur asnjë konflikt në mes turqve dhe ushtrive muslimane, por së bashku marshuan drejt tokave të armenëve me qëllim çlirimin e tyre dhe përhapjen e fesë islame atje.²

Në kohën e halifit të drejtë e të urtë, Uthman bin Afan, u bë çlirimi i vendeve të Taberistanit, pastaj ushtritë muslimane kaluan lumin Xhejhun në vitin 31 hixhrij ose viti 651 dhe zbritën në vendet përtej këtij lumi. Shumë prej turqve pranuan fenë islame, njëherit u bënë mbrojtës të flaktë të kësaj feje dhe morën pjesë në mesin e ushtrive muslimane për çlirimin e vendeve tjera dhe përhapjen e islamit.

Mu'tasimi i abasitëve pasi që e mori hilafetin, i hapi dyert e ndikimit turk. U dha turqve shumë poste udhëheqëse në shtet dhe në administrimin e çështjeve të shtetit. Politika e Mu'tasimit ishte tkurrja e ndikimit persian.³

Interesimi i Mu'tasimit për racën turke shkaktoi një pakënaqësi të ashpër në mesin e njerëzve dhe të ushtarëve. Mu'tasimi u frikësua nga zemërimi i njerëzve kundër tij dhe për këtë arsye ndërtoi një qytet të ri, i cili u quajt Samerra, ku u vendos ai, ushtria dhe përkrahësit e tij. Kështu turqit filluan që nga ajo kohë të shfaqen në role të rëndësishme në skenën historike islame, sa që themeluan dhe një shtet të madh islam, i cili ka qenë në lidhje të fuqishme me halifët e shtetit abasit, që u njoh me emrin Shteti Selxhuk.⁴

I.1.2 Ngritja dhe rënia e Shtetit Selxhuk

Paraqitja e selxhukëve në skenën e ngjarjeve në Lindjen Arabe Islame kishte një ndikim të madh në rrjedhojën e ngjarjeve politike në atë rajon, të cilin e ndante hilafeti abasit sunit në njërën anë, dhe sundimi i fatimit shi'it në anën tjetër.⁵

Selxhukët themeluan një shtet të madh turk, i cili u shfaq në shekullin XI, që përfshinte Horasanin, Turkestanin, Iranin, Irakun, Shamin dhe Azinë e Vogël. Qendra e shtetit selxhuk në fillim ishte në Rej të Iranit, e pastaj u transferua në Bagdad të Irakut. Ndërkohë që u ngritën edhe disa shtete të vogla si në Horasan, Turkestan, Sham dhe Azi të Vogël, por që të gjithë i bindeshin sulltanit selxhuk në Iran dhe Irak.

Tugrull Beu, lideri selxhuk, arriti të rrëzojë Shtetin Buvejhit në vitin 1055 që ishte me qendër në Bagdad dhe zhduku rebelimet e problemet. Tugrull Beu kishte personalitet të fortë, intelegjencë të mprehtë, guxim të rrallë dhe ishte njeri fetar, i devotshëm dhe i drejtë. Për këtë

² Po aty, fq. 28.

³ Po aty.

⁴ Po aty, fq. 29.

⁵ Po aty, fq. 30.

arsye ai gjeti përkrahje dhe ndihmë të madhe nga populli. Ai përgatiti një ushtri të fuqishme dhe punoi për bashkimin e selxhukëve në një shtet të fortë.⁶

Pas vdekjes së Tugrull Beut, frenat e pushtetit i morri Alp Arslani. Ndodhën pakënaqësi dhe përçarje lidhur me marrjen e pushtetit nga ana e Alp Arslanit, por ai arriti që ato të shuheshin. Pas vdekjes së Alp Arslanit, udhëheqjen e sulltanatit e morri i biri i tij Melikshahu. Këtë gjë e kundërshtoi udhëheqësi i selxhukëve të Kermanit, pra xhaxhai i tij Kaurd Ibën Xhefri.

Shteti selxhuk në kohën e sulltanit Melikshah është zgjeruar shumë, sa që kufijtë e tij shtriheshin nga Afganistani në lindje, deri në Azinë e Vogël në perëndim, si dhe deri në Sham në jug. Me vdekjen e sulltan Melikshahut, përfundon edhe periudha e fuqisë së Shtetit Selxhuk, të cilën periudhë e përfundoi gjatë kohës së tre sulltanëve të njohur: Tugrull Beut, Alp Arslanit dhe Melikshahut.

Sulltani Melikshah kishte katër djem dhe ato ishin: Berkijarku, Muhamedi, Senxheri dhe Mahmudi. Mahmudi që nga fëmijëria ishte i njohur si Nasirudin Mahmud dhe pas vdekjes së babait të tij ishte caktuar për marrjen e pushtetit. Sundimi i tij me Shtetin Selxhuk ishte për gati afro 2 vite dhe atë nga viti 1092-1094. Pas vdekjes së Mahmudit, në pushtet erdhi Ruknudin Mudhafer Berkijaruk bin Melikshah i cili udhëhoqi me Shtetin Selxhuk nga viti 1094-1105. Pas tij, në pushtet erdhi Gijathudin Ebu Suxha Muhamed. Ai me sulltanatin udhëhoqi në periudhën nga 1105-1128. Gijathudin Ebu Suxha Muhamed ishte sundimtari i fundit i Shtetit të Selxhuk.⁷

I.1.3 Ngritja e Perandorisë Osmane

Osmanët rrjedhin nga një fis turkmen, i cili jetonte në Kurdistan në fillim të shekullit të XIII. Ata ishin blegtorë dhe bënë një jetë nomade. Për shkak të luftërave që bënë mongolët në krye me Xhingis Kanin në Irak dhe rajonet lindore të Azisë së Vogël, Sulejmani i cili ishte gjyshi i Osmanit, në vitin 1220 u shpërngul me familjen e tij në qytetin Ahlat të Anadollit. Pas vdekjes së tij në vitin 1230, e trashëgoi i biri Ertugrulli, i cili vazhdoi lëvizjen e tij në veriperëndim të Anadollit. Pas vdekjes së Ertugrullit në vitin 1299, pushtetin e morri Osmani, i cili e ndoqi politikën ekspansioniste të babait të vet, duke u zgjeruar në tokat romake.⁸

Osmani ishte ai që bashkoi emiret më të vogla në një shtet. Në kohën e udhëheqësit Osman shteti u zgjerua, u bë i fuqishëm dhe i respektuar. Sipas emrit të tij, shteti u quajt Shteti Osman, ndërsa banorët osmanlinj. Në mesin e shekullit XIV, Sulltanati Osman u bë shteti më i fuqishëm në Azinë e Vogël. Atëherë osmanët filluan pushtimet në Gadishullin Ballkanik.⁹

Osmani me shtetin udhëhoqi gjatë periudhës 1299-1327. Ai la pas vete Perandorinë Osmane me një sipërfaqe prej 16.000 km². Arriti që të sigurojë për Perandorinë Osmane dalje në

⁶ Po aty, fq. 30-31.

⁷ Po aty, fq. 42.

⁸ Po aty, fq. 47.

⁹ Boshkoski, M., Ilioski, J. Dervishi, N. (2016): Historia për klasën e VII, Prosvetno Dello, Shkup, fq. 75.

Detin Marmara, si dhe arriti që me ushtrinë e tij të rrezikojë dy qytete bizantine me rëndësi të asaj kohe: Iznik (Nikea) dhe Bursa.¹⁰

Pas vdekjes së Osmanit, pushtetin në Perandorinë Osmane e mori biri i tij Orhani. Orhani ndoqi pothuajse të njëjtën politikë sikur prindi i tij. Betejat e Orhanit ishin të orientuara kundër Bizantit dhe për çlirimin e Konstandinopojës. Ai interesohej për reforma në sistemin e çështjeve administrative, për forcat ushtarake, për përhapjen e fesë islame dhe ndërtimin e xhamive, hapjen e shkollave dhe themeloi institucione shkencore në të cilat vendosi si udhëheqës dijetarët.

Pas Orhanit, në udhëheqje të Perandorisë Osmane erdhi Murati I, i cili dallohej me trimëri të jashtëzakonshme, luftëtar guximtar, fisnik dhe besimtar. Pranë vetes kishte një grup të njerëzve të zgjedhur, komandantë dhe ekspertë ushtarakë. Prej tyre kishte formuar një këshill dhe me ta konsultoej për sa iu përket betejave çliruese, politikës së brendshme dhe të jashtme. Murati i I zgjeroi territorin e Perandorisë Osmane në Azinë e Vogël dhe Ballkan-në të njëjtën kohë. Në Gadishullin Ballkanik, ushtria osmane e udhëhequr nga Murati I sulmoi vendet e Perandorisë Bizantine dhe në vitin 1360 arriti të pushtojë qytetin Edrene. Ai me ushtrinë e tij arriti të fitojë Betejën te lumi Maricë dhe Betejën e Fushë Kosovës.

Fitorja e Betejës tek lumi Maricë në vitin 1371, osmanlinjve definitivisht u mundësoi të përforcoheshin në Gadishullin Ballkanik, kurse pas kësaj në vitin 1385 e morrën edhe Sofjen dhe në vitin 1386 e morrën edhe qytetin e Nishit.¹¹

Më 15 qershor të vitit 1389, ushtria osmane korri fitore në Betejën e Fushë Kosovës. Serbët, boshnjakët dhe bullgarët bënë një aleancë ushtarake, me qëllim që të ndalin përparimin e ushtrisë osmane me në krye sulltan Muratin e I. Pas fitores së ushtrisë osmane ndaj ushtrive aleate krishtere ballkanike, sulltan Murati I doli në fushën e betejës për të parë personalisht numrin e të vrarëve muslimanë dhe njëherit të vizitojë edhe të plagosurit. Me dinakëri sulltan Muratit të I i afrohet robi Millosh Obiliqi, i cili duke u shtirur se donte të kërkojë falje dhe të pranojë islamin, me thikë nga afër vretë këtë sulltan osman.

Ushtria osmane në vitin 1391 pushton qytetin e Shkupit dhe më pas gjithnjë e më shumë po ia mësytin Bosnjës. Deri në rënien përfundimtare të Bosnjës në vitin 1463 dhe të Hercegovinës më vitin 1482, osmanlinjtë kishin nën kontroll shumë vende.¹²

Mjaft e rëndësishme në Perandorinë Osmane është periudha e udhëheqjes së sulltanit Mehmet Fatihut II. Ai llogaritet si sulltani i shtatë osman në zinxhirin e familjes osmane. Ai njihej me llagapin “El-Fatih”-Çlirimtari. Mori pushtetin në Perandorinë Osmane me 18 shkurt të vitit 1451 kur kishte vetëm 22 vjet.

¹⁰ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 73.

¹¹ Hasanoviq, B. (2000): Ilmuddin, Sh.b., Furkan ISM, Shkup, fq. 265.

¹² Po aty.

Në muajt prill dhe maj të vitit 1453, nën udhëheqjen e sulltanit Mehmet Fatihu i II, ushtria osmane fillon sulmet ndaj qytetit të Konstandinopojës. Më 29 maj të vitit 1453, ushtria osmane e udhëhequr nga Mehmet Fatihu i II merr kontrollin e Konstandinopojës, me çka përfundimisht shkatërrohet Perandoria Bizantine, njëra nga perandoritë më të fuqishme në Evropë. Mehmeti Fatihu i II me të pushtuar Konstandinopojën, ndërroi emrin e tij në Islambull, pra që në përkthim i vjen “Shtëpia e Islamit”. Ky qytet buzë Ngushticës së Bosforit, qytet me një pozitë mjaft strategjike u bë kryeqendër e Perandorisë Osmane.

Perandoria Osmane zgjerim më të madh territorial ka arritur në shekullin e XVI, më saktë bëhet fjalë për kohën e sulltan Sulejman Kanunit. Koha e sulltan Sulejman Kanunit konsiderohet Etapa e Artë e Perandorisë Osmane, ngase në vitet që ai ishte në pushtet, pra në vitet 1520-1566, kjo perandori përjetoi një zgjerim shumë të madh që nuk ishte parë ndonjëherë më parë. Territori i Perandorisë Osmane shtrihej në Evropë, Azi dhe Afrikë. Kjo shfaqje dhe ky afirmim ndikoi që në vendet bashkëkohore, e sidomos në vendet evropiane, të cilat përjetonin përçarje të rrezikshme politike dhe fetare. Për këtë arsye qëndrimi i shteteve evropiane ndaj Perandorisë Osmane ndryshonte krahas gjendjes së secilit shtet.¹³




Foto. 1. Harta e shtrirjes së Perandorisë Osmane që nga themelimi e deri më 1683.

¹³ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 228.

I.1.4 Dobësimi i Perandorisë Osmane

Të gjithë historianët, pa përjashtim, pajtohen unanimisht se madhështia e Perandorisë Osmane mori fund me vdekjen e sulltanit Sulejman Kanunit më vitin 1566. Shenjat e dobësimit të kësaj perandorie filluan të shihen qysh në periudhën e Sulltan Sulejmanit, kur edhe ai kishte rënë nën ndikimin e gruas së tij Rokslanës, e cila kurdisi komplotin kundër princit Mustafa, në mënyrë që djali i saj Selimi II të marrë postin e sulltanit pas babait të tij.¹⁴

Nga shenjat e dobësimit të Perandorisë Osmane në periudhën e sulltan Sulejmanit të II (Sulejman Kanunit), është fillimi i tërheqjes së tij nga mbledhjet e këshillit, shfaqja e dhunës në familje, si dhe pamundësia për t'u ballafaquar me problemet ekonomike dhe shoqërore, të cilat shkaktuan ndezjen e kryengritjeve popullore në Rumeli dhe Anadoli.

Edhe pse shkaqet e rënies së Perandorisë Osmane ishin të shumta, emërues i përbashkët i të gjitha shkaqeve ishte largimi i të gjykuarit me të drejtë dhe ligj. Devijimi i sulltanëve të fundit të Perandorisë Osmane nga ligji hyjnor, si dhe neglizhenca e shoqërisë islame në urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja pati ndikim negativ në të. Shumë u shtuan armiqësitë e brendshme në mes njerëzve, pasuritë plaçkiteshin dhe shkelej nderi. Në shtet shpërthyen luftra, përçarje dhe urretje, ndërsa nga ana tjetër rritej fuqia e rusëve, anglezëve, francezëve, serbëve, bullgarëve.

Disa pashallarë në Perandorinë Osmane e tepruan me punë të shëmtuara. Mbytnin njerëz të pafajshëm, plaçkitnin pasuritë e tyre. Shembull mund të merret Ibrahim Pasha i njohur me emrin Dalai, i cili ishte ministër i sulltan Muratit të III dhe njëherit ishte kryeprinc në provincën e Dijar Bakirit, ku bëri lloje të ndryshme të zullumit: vrau, përdhunoi, plaçkiti pasurinë etj. Kur i arriti lajmi sulltan Muratit III për këto zullume dhe u ngrit padi ndaj Ibrahim Pashës, njerëzit kishin frikë të dëshmojnë kundër tij, gjykatësi nuk pati mundësi të hulumtojë mirë rastin ngase motra e Ibrahim Pashës kishte një autoritet të madh te sulltan Murati III.¹⁵

Në përgjithësi u shtua zullumi i turqve mbi arabët, kurdët dhe shqiptarët. Me ardhjen e bashkimxhinjve (pjesëtarëve të organizatës Ittihat ve Terakki) në pushtet, filloi zullumi në katër anët e shtetit. Përveç zullumit të madh, një devijim shkatërrues ishte edhe luksi i tepruar, si një devijim i tmerrshëm nga metodologjia që ndoqi Perandoria Osmane në kohën e fuqisë, fitores dhe krenarisë së saj. Prej këshillave të Mehmet Fatihut me të cilën i këshilloi përgjegjësit e tij ishte edhe kjo: “Kujdesu ndaj pasurisë së shtetit dhe mos shpenzo pasurinë e shtetit në luks ose pas punëve të kota dhe mos shpenzo më shumë se sa kërkon nevoja, ngase kjo është nga shkaqet kryesore të shkatërrimit, kështu që ishte e natyrshme që pas këtij devijimi dhe pas kësaj zhytjeje në luks dhe epshe të shkatërrohej Perandoria Osmane¹⁶.

¹⁴ Po aty, fq. 297.

¹⁵ Po aty, fq. 558.

¹⁶ Po aty, fq. 560.

I.1.5 Rënia e Perandorisë Osmane

Në fund të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX, Perandoria Osmane hyri në një krizë të thellë shoqëro-politike. Shkaqet ishin të karakterit të brendshëm dhe të jashtëm. Njëra nga to ishte shpërbërja e sistemit timaro-spahik. Kriza e brendshme në Perandorinë Osmane u shfaq nëpërmjet tendencave për pavarësi dhe separatizëm të pashallarëve. Pushteti qendror osman ishte i detyruar të veprojë me forcë kundër këtyre feudalëve dhe me forcë ta imponojë vullnetin e pushtetit qendror.

Në fillim të shekullit XX në Perandorinë Osmane bëhen përpjekje për reforma. Politikën reformiste të sulltan Selimit të III e vazhdoi sulltan Mahmudi i II. Një nga reformat e tij më rëndësi ishte shpërbërja e ushtrisë jeniçere më vitin 1826 dhe formimi i ushtrisë së rregullt.¹⁷

Pas vitit 1834 ishte hequr sistemi timaro-spahik. Feudalëve që e kishin pronën në çifligje iu njoh pronësia. Një pjesë e madhe e tokës së spahinjve iu dha fshatarëve për ta punuar. Këto reforma kishin të bëjnë me Reformën Agrare në Perandorinë Osmane. Me reformat vazhdoi edhe sulltani Abdulmexhidi I, sidomos me Hattisherifin (Ediktin) e Gjylhanes më vitin 1839-1841. Me Hattisherifin e Gjylhanes të gjithë shtetasit osmanë ishin shpallur të barabartë para ligjit pa dallim nga përkatësia kombëtare dhe fetare.¹⁸

Në fillim të shekullit XX Lëvizja e Turqve të Rinj (Xhonturqve) nuk arriti ta reformojë Perandorinë Osmane dhe ta shpëtojë atë nga shkatërrimi, por ajo arriti ta ndalojë realizimin e Marrëveshjes së Revalit (marrëveshje ruso-angleze). Duke përfutur nga dobësimi i Perandorisë Osmane dhe dështimeve ushtarake të saj, vendet ballkanike si Bullgaria, Serbia, Greqia dhe Mali i Zi formuan Lidhjen Ballkanike, që kishte për qëllim të përzë Perandorinë Osmane nga Ballkani. Në Luftën e Parë Ballkanike Perandoria Osmane u mund nga shtetet aleate të Ballkanit dhe me Marrëveshjen e Londrës të vitit 1913, ajo ishte e detyruar që të lëshojë disa territore si Maqedoninë, Thrakinë dhe Shqipërinë.¹⁹

Pas Luftës së Parë Botërore, Perandoria Osmane përfundimisht u shkatërrua me Marrëveshjen e Paqes së Sevërit në vitin 1920. Greqia pasi u mund me luftë nga Turqia pranoi bisedimet për paqe dhe me Marrëveshjen e Paqes së Lozanës të vitit 1923, ajo fitoi sërish territorin e Thrakisë Lindore dhe Izmirit. Më pas (1924) ishte abroguar sulltanati dhe Turqia ishte shpallur republikë. Ishin kryer disa reforma mjaft të mëdha në shtetin e ri të Turqisë, ndër to mund të përmenden: vendosja e modelit ligjor evropian, aplikimi i alfabetit latin, ndryshohet pozita e gruas, hapen shkollat publike laike etj.²⁰

¹⁷ Ristovski, B., Rahimi, Sh., Mlladenovski, S., Kiselinovski, S., Çepreganov, T. (2016): Historia për klasën e VIII, Sh.b. Albi, Shkup, fq. 32.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, fq. 34.

²⁰ Po aty, fq. 23-24.

I.1.6 Rregullimi shtetëror i Perandorisë Osmane

Në krye të Perandorisë Osmane qëndronte sulltani. Ai ishte sundimtari i tërë perandorisë dhe njëherit ai ka qenë edhe lider suprem fetar. Ai ka qenë pronar i tokës dhe i shtetasve të tij, ndërsa sipas ligjeve islamike, për veprat e veta që ka bërë përgjigjej vetëm para Zotit dhe të dërguarit Muhamed. Pushteti i tij ka qenë i trashëguar dhe trashëgimtarët e tij kryesisht mund të ishin të afërmit nga gjaku.

Ndihmës i parë i sulltanit ka qenë Veziri i Madh. Ai e udhëhiqte Këshillin e Shtetit i cili quhej Divan. Në punën e Divanit merrnin pjesë nëpunësit më të lartë shtetërorë. Që të qeverisej më lehtë, sulltani shtetin e ndante në njësi administrative më të mëdha dhe më të vogla. Njësitë administrative më të mëdha quheshin sanxhaqe. Me sanxhaqet udhëhiqnin sanxhak-bejlerët. Njësitë më të vogla administrative ishin: vilajetet, nahitë dhe kazatë.²¹

Vilajetet si njësi të vogla administrative në kuadër të Perandorisë Osmane, udhëhiqeshin nga ana e valiut. Ndërsa, nahitë poashtu si njësi të vogla administrative udhëhiqeshin nga ana e kadiut.

Sulltani fuqinë e tij e ka bazuar në përkrahjen që i ka dhënë ushtria. Ushtria ka qenë e përbërë nga këto njësi ushtarake: këmbësoria, kalorësia dhe marina. Pjesa më e fortë e ushtrisë e cila ka qenë shumë mirë e stërvitur, ka qenë e njohur me emrin njësia jeniçere. Jeniçerët përbënin gardën personale të sulltanit dhe forcën goditëse të ushtrisë.

Që në kohën e formimit të shtetit, islami u bë religjioni-feja kryesore në shtet. Kushtetuta e Perandorisë Osmane ishte vetë Kur'ani-fjala e Zotit. Në perandori rëndësi e veçantë i kushtohej edukatës fetare, me çka në perandori në funksion ishin shumë shkolla fetare. Mirëpo, me mjaft rëndësi është të theksohet se në Perandorinë Osmane ekzistonte toleranca fetare dhe besimtarët e feve të tjera kishin të drejta të praktikimit të fesë së tyre dhe të jetës së lirë në përgjithësi.

Popullsia e Perandorisë Osmane kryesisht është marrë me bujqësi, blegtori, tregti dhe zejtari. Shtresa më e pasur e popullsisë kanë qenë spahinjët. Ata nga sulltani kanë fituar sipërfaqe të madhe të tokës, por me kusht që ta kryejnë obligimin ushtarak. Në raste të luftës me urdhër të sulltanit, ata patjetër duhej të merrnin pjesë në ekspeditat ushtarake.

Sipas madhësisë së të ardhurave, pasuritë e spahinjve ndaheshin në: timare, ziamete dhe hase. Sipërfaqet e mëdha të tokës llogariteshin si hass-e. Ato i fitonin vezirët dhe nëpunësit më të lartë shtetërorë. Sistemi i tillë në Perandorinë Osmane quhej sistemi timaro-spahik. Tokën e spahinjve e kanë punuar njerëzit e varur feudal që njiheshin si *reja*. *Reja* krahas që ka punuar tokën e vet, ka punuar edhe tokën e feudalëve. Reja ishte e detyruar të paguante tatime për shtetin dhe për spahinjët, si dhe të bëjë punë pa pagesë (angari).²²

²¹ Boshkoski, M., Ilioski, J. Dervishi, N. (2016): Historia për klasën e VII, Prosvetno Dello, Shkup, fq. 75.

²² Po aty, fq. 76.

I.1.7 Karakteristikat demografike të Perandorisë Osmane

Perandoria Osmane ka qenë një nga perandoritë më të mëdha që njeh historia botërore. Kjo perandori gjatë zhvillimit të saj përgjatë historisë ka pasur shtrirje territoriale fluide dhe numër të ndryshëm të popullsisë. Duhet theksuar se gjatë shekullit XVI ka pasur shtrirje më të madhe territoriale, përkatësisht është shtrirë në tre kontinente: Evropë, Azi dhe Afrikë. Gjatë periudhës kur me Perandorinë Osmane ka udhëhequr sulltan Sulejmani, territori i saj është shtrirë në Evropën Juglindore, në një pjesë të caktuar të Evropës Qendrore, në vendet e Kaukazit, Azinë e Vogël, Azinë Jugperëndimore, Afrikën Veriore dhe përgjatë bregdetit të Detit të Kuq. Pra, shtrirje më të madhe territoriale ka pasur në vitin 1683, kur sipërfaqja e saj ka arritur 5.200.000 km². Ndërsa në vitin 1914 Perandoria Osmane ka zotëruar një territor prej 1.800.000 km².


Ky shtet gjigand gjatë historisë së ekzistimit të vet ka ndërruar disa kryeqendra. Soguti ka qenë kryeqendra e Perandorisë Osmane gjatë periudhës 1299-1335. Pastaj administrata e kësaj perandorie ka kaluar në qytetin e Bursas (1335-1363). Më pas nga qyteti i Bursës, kryeqendra e Perandorisë Osmane kalon në Adrianopojë (Edirne) dhe këtu qëndron gjatë periudhës 1363-1453. Ndërsa si kryeqendër e fundit e Perandorisë Osmane ka qenë Stambolli dhe atë gjatë periudhës 1453-1922. Në Stamboll selia e Perandorisë ka qëndruar për kohë më të gjatë, respektivisht për diku afro 470 vite. Ky qytet ka pasur rëndësi të madhe për Perandorinë Osmane, ngase ai ka pasur një pozitë mjaft të volitshme duke u gjendur në Ngushticën e Bosforit, mes Detit Marmara dhe Detit të Zi. Poashtu, duhet theksuar se Stambolli ka paraqitur urë lidhëse mes pjesës aziatike dhe pjesës evropiane të Perandorisë Osmane. Depërtimi i Perandorisë Osmane në Evropë është realizuar pas marrjes së Stambollit.

Me rëndësi për t'u theksuar është fakti se, pjesa evropiane e Perandorisë Osmane është quajtur Rumeli. Rumelia ka përfshirë pothuajse gjithë Gadishullin Ballkanik dhe një pjesë të Evropës Qendrore. Si qytet i cili ka qenë me një rëndësi mjaft të madhe ka qenë Shkupi. Shkupi ka qenë qyteti më i banuar me popullsi muslimane në Rumeli dhe njëherit edhe qyteti më i madh shqiptar në trojet etnike shqiptare. Shkupi është dalluar me një bukuri mbresëlënëse. E gjithë arkitektura ka qenë e stilit oriental, e ndërtuar nga arkitektë të njohur osmanë.

Sa i përket numrit të popullsisë në Perandorinë Osmane ai vazhdimisht ka ndryshuar si pasojë e zgjerimit të territorit, ndryshimit të shkallës së shtimit natyror të popullsisë, paraqitjes së sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme, luftërave apo mungesës së ushqimit. Të dhënat e para për numrin e popullsisë në Perandorinë Osmane datojnë që nga viti 1520 e këndej. Njohja e numrit të popullsisë që ka jetuar në territorin e Perandorisë Osmane ka qenë me një rëndësi të madhe, ngase pushteti fillimisht ka dashur të ketë të dhëna për numrin e popullsisë që jeton në kufijtë e Perandorisë, për përkatësinë fetare të saj, numrin e familjeve etj. Në bazë të numrit të banorëve dhe familjeve është bërë mbledhja e taksave dhe tatimit, rregullimi i shërbimit ushtarak, ndërtimi i infrastrukturës rrugore, ndërtimi i objekteve të karakterit publik etj.

Tabela 1. Numri i popullsisë së Perandorisë Osmane gjatë periudhës 1520-1919.²³

Vitet	1520	1683	1831	1856	1893	1906	1919
Popullsia	11.692.480	30.000.000	27.230.660	35.350.000	17.388.604	20.975.345	14.629.000



Grafikoni 1. Numri i popullsisë së Perandorisë Osmane gjatë periudhës 1520-1919.

Në Perandorinë Osmane gjatë periudhës 1520-1919 në bazë të regjistrimeve të bëra të popullsisë, shihen ndryshime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në vitin 1520, në Perandorinë Osmane ka pasur më pak popullsi se sa në periudhën më pas. Më saktë në vitin 1520 në Perandorinë Osmane kanë jetuar 11.692.480 banorë. Ndërsa sipas të dhënave për numrin e popullsisë më vitin 1683 del se në Perandorinë Osmane kanë jetuar 30 milionë banorë, pra është arritur një dyfishim i numrit të popullsisë krahasuar me vitin 1520. Rritja e numrit të popullsisë në Perandorinë Osmane gjatë periudhës 1520-1683 është kryesisht si pasojë e zgjerimit shumë të madh të kufijve të Perandorisë.

Perandoria Osmane numër më të madh të popullsisë ka pasur në vitin 1856 dhe atë 35.350.000 banorë. Pas vitit 1856 numri i popullsisë në Perandorinë Osmane ka shënuar ulje dhe një gjë e tillë ka ndodhur si pasojë e humbjeve të konsiderueshme territoriale. Ajo vetëm disa vite para se të përfundojë ekzistimin e saj, pra në vitin 1919 ka pasur 14.629.000 banorë.

²³ https://en.m.wikipedia.org/wiki/Ottoman_Empire


I.2 TË DREJTAT E MUSLIMANËVE DHE JOMUSLIMANËVE NË PERANDORINË OSMANE

I.2.1 Përbërja fetare e popullsisë së Perandorisë Osmane

Perandoria Osmane shtrihej territorialisht në tre kontinente, kishte një përzierje të popujve të racave dhe kombësive të ndryshme, si dhe në aspekt fetar ekzistonte një heterogjenitet, pra në mesin e popullsisë së kësaj perandorie ekzistonin fe të ndryshme. Fe zyrtare në Perandorinë Osmane ishte Islami, të cilës fe i takonte shumica e popullsisë së kësaj perandorie. Mirëpo, përveç popullsisë së fesë islame, në Perandorinë Osmane jetonte edhe numër i konsiderueshëm i popullsisë krishtere, e cila radhitej e dyta në këtë perandori. Ndërsa, përveç muslimanëve dhe të krishterëve, në perandori jetonte edhe popullsi e cila i takonte fesë hebreje. Popullsia hebreje ishte në numër shumë më të vogël se popullsia muslimane dhe krishtere.

*Tabela 2. Struktura fetare e popullsisë në Perandorinë Osmane në vitin 1856.*²⁴

Besimtarë të fesë	Islame	Krishtere	Hebraike	Gjithsej
Numri	21.000.000	13.900.000	150.000	35.050.000
Përqindja (%)	59,91	39,66	0,43	100,00



Grafikoni 2. Struktura fetare e popullsisë në Perandorinë Osmane në vitin 1856.

Pra, bazuar në të dhënat nga një regjistrim i bërë më vitin 1856 mund të shihet se në Perandorinë Osmane muslimanët kanë përbërë shumicën e popullsisë, kurse pas tyre janë radhitur të krishterët të cilët kanë qenë në numër të konsiderueshëm. Ndërsa, popullsia hebreje ka qenë në numër shumë të vogël (më pak se 1%).

²⁴ Po aty.

Në bazë të popullsisë shumicë muslimane, Perandoria Osmane ka shpallur fenë islame si fe zyrtare. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë në vitin 1844, në Perandorinë Osmane kanë jetuar 21 milionë muslimanë, të cilët kanë përbërë 59,91% të popullsisë së përgjithshme të kësaj perandorie. Shumica dërrmuese e popullsisë muslimane që ka jetuar në perandori ka qenë sunitë dhe i ka takuar medhhebit hanefi. Në sajë të asaj se fe zyrtare në Perandorinë Osmane është shpallur Islami, është vepruar sipas fesë dhe në zbatim ka qenë Ligji i Sheriatit. Xhamitë kanë qenë objekte ku janë kryer ritet fetare islame. Në territorin e Perandorisë Osmane ka pasur numër shumë të madh të xhamive, të cilat janë ndërtuar me stil oriental dhe në brendi janë zbukuruar me motive shumëngjyrëshe nga natyra dhe me ajete kur'anore.



Foto. 2. Xhamia Aja Sofia në Stamboll.

Duhet theksuar se jo në çdo hapësirë të Perandorisë Osmane ka pasur shumicë muslimane. Muslimanët shumicë absolute kanë qenë në Afrikën Veriore dhe në një pjesë të Afrikës Lindore e shtrirë përgjatë Detit të Kuq, pra këtu kanë përbërë 100% të popullsisë, në Azinë e Vogël, Azinë Jugperëndimore dhe Kaukaz ato kanë përbërë 78,82% të popullsisë së përgjithshme, kurse në pjesën e Evropës, pra në Rumeli, përqindja e popullsisë muslimane ka qenë 29,35%. Pra, në Rumeli popullsia muslimane ka qenë pakicë, kurse shumicë ajo krishtere. Popullsia muslimane në Rumeli, kryesisht ka jetuar në numër më të madh në këto vende: Thraki Lindore, pjesën juglindore të Bullgarisë, Shqipëri dhe Kosovë, Maqedoni, Bosnjë dhe Sanxhak. Sipas disa të dhënave nga regjistrimet e bëra nga pushteti osman theksohet se në trojet shqiptare, përkatësisht në Vilajetin e Kosovës, Manastirit, Shkodrës dhe Janinës kanë jetuar 1,5 milionë shqiptarë, më shumë se gjysma e tyre kanë qenë muslimanë.

Krishterizmi ka qenë fe e dytë pas Islamit në Perandorinë Osmane, mirëpo nuk ka qenë fe zyrtare sikur që ka qenë feja islame. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 1844, në kuadër të Perandorisë Osmane kanë jetuar 13.900.000 krishterë dhe kanë përbërë 39,66% të popullsisë së përgjithshme të Perandorisë. Shumica e të krishterëve kanë qenë ortodoksë, kurse më pak kanë qenë katolikë dhe protestantë. Pjesëtarë të fesë krishtere kanë qenë këta popuj: romunët, grekët, armenët, bullgarët, serbët dhe sllavët e tjerë, si dhe një pjesë e shqiptarëve. Popullsia e fesë krishtere në numër më të madh ka jetuar në Rumeli, kurse e pranishme ka qenë edhe në pjesën aziatike të Perandorisë Osmane. Në Rumeli kanë jetuar 10.640.000 të krishterë dhe kanë përbërë 68,65% të popullsisë së përgjithshme. Ndërsa në pjesën aziatike të Perandorisë Osmane kanë jetuar diku afro 3.260.000 të krishterë, që kanë përbërë 20,31% të popullsisë së përgjithshme të kësaj pjese të Perandorisë. Të krishterët ritet fetare i kryenin nëpër kisha dhe manastire. Ndërtimi i objekteve fetare krishtere bëhej me leje nga autoritetet shtetërore të Perandorisë Osmane. Perandoria Osmane garantonte lirinë e praktikimit të riteve fetare krishtere dhe lejonte ndërtimin e objekteve fetare krishtere.



Foto. 3. Manastiri i Rilës në Bullgari objekt fetar krishter ortodoks me rëndësi për të krishterët e Rumelisë.

Hebraizmi ka qenë fe e tretë në Perandorinë Osmane, me shumë pak besimtarë, të cilët kryesisht kanë jetuar nëpër disa qytete të pjesës evropiane dhe aziatike të Perandorisë Osmane. Sipas të dhënave nga regjistrimi i bërë më vitin 1844 nga autoritetet osmane, në Perandorinë Osmane kanë jetuar 150.000 hebrenj, që kanë përbërë 0,43% të popullsisë së përgjithshme të kësaj Perandorie.

I.2.2 Kushtetuta e Perandorisë Osmane

Jeta e Osmanit, themeluesit të Perandorisë Osmane, ishte luftë dhe thirrje në Rugën e Zotit. Dijetarët e fesë islame e rrethonin dhe ishin me udhëheqësin e perandorisë, pra Osmanin, udhëhiqnin projektet dhe planet administrative, si dhe ekzekutimin e Sheriatit në Perandori. Historia ka porosinë e Osmanit që ia la amanet të birit të tij, Orhanit. Ajo porosi kishte përmbajtje civilizuese dhe legjislative në bazë të së cilës ka verpruar Perandoria Osmane pas tij:

“Biri im, ruaju e mos angazho veten në diçka që nuk e ka urdhëruar Zoti i botërave. Nëse përballesh me ndonjë problem gjatë udhëheqjes, konsultohu me dijetarët e fesë duke marrë mendimin e tyre.

Biri im, ata që të pasojnë ndihmoji dhe përkrahi fuqishëm. Jepu të mira ushtrisë, mos të të mashtrojë shejtani në ushtrinë dhe pasurinë tënde dhe asnjëherë mos u largo nga dijetarët dhe Sheriati.

Biri im, ti e di se qëllimi ynë është kënaqësia e Allahut, Zotit të botërave. Me xhihad drita e fesë sonë i përfshin të gjithë horizontet dhe me këtë arrihet kënaqësia e Allahut të Madhërishëm.

Biri im, ne nuk jemi prej atyre që luftojnë për lakminë e pushtetit ose për dominim mbi të tjerët. Ne jetojmë me Islamin dhe për të vdesim. Për një gjë të tillë, biri im, ti je kompetent.”²⁵

Në bazë të përmbajtjes së kësaj porosie ne mund të nxjerrim parimet, rregullat dhe bazat mbi të cilat është ngritur Perandoria Osmane:

- Kjo është një ftesë për t’iu përmbajtur Sheriatit në çdo gjë, qoftë gjë e vogël ose e madhe, në mënyrë që ligji dhe urdhëri i Zotit të dominojnë në çdo gjë;
- Sistemi i konsultimit synon urtësi të mëdha, qëllime të larta, për shkak se në të ka të mira e përfitime të shumta, të cilat kthehen në favor të ummetit (bashkësisë myslimane), shtetit dhe shoqërisë me dhunti e begati. Mu për këtë edhe Osmani I e porositi të birin që me dijetarët të konsultohet për zgjidhjen e ndonjë problemi. Me këtë udhëzim zbatohet urdhëri hyjnor dhe pasohet tradita profetike;
- Osmani I e kuptoi se feja islame është fe e një thirrjeje të vazhdueshme, që nuk do të ndalet derisa të përfundojë jeta njerëzore në sipërfaqen e Tokës, andaj dhe njëri prej qëllimeve të Shtetit Islam është shtyrja e rrotës së thirrjes islame që sa më parë për të arritur drita islame te çdo njeri. Perandoria Osmane ndihej përgjegjëse të merrej me përhapjen e fesë islame në të gjitha anët e botës. Edhe marrëdhëniet diplomatike në politikën e jashtme i bënte para së gjithash në dobi të Islamit.²⁶

²⁵ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 53.

²⁶ Po aty, fq. 55,57,63.

Dijetarët gjatë kohës së Perandorisë Osmane kanë qenë pikëmbështetje për udhëheqësit e shtetit në luftëra, sprova, probleme e vështirësi. Kanë pasur prirje për të mbledhur njerëzit nën flamurin e xhihadi në Rugën e Zotit, për të zbatuar në përpikmëri Sheriatin tek të gjithë. Nuk e lejonin sulltanin të shkelte ligjet e Sheriatit, përndryshe ata bënin thirrje për revoltë të popullsisë dhe mund të arrinin ta shkarkonin nga detyra. Vendimet e dijetarëve dhe juristëve bazoheshin në: ***Kur'an, traditën profetike (sunnet), konsensusin dijetarëve muslimanë (Ikhma')*** dhe ***analogjia (Kijas)***.

Qëllimi për të cilin u formua Perandoria Osmane ishte mbrojtja e Islamit, ngritja e flamurit të tij në lindje të Azisë së Vogël dhe shkatërrimi i Bizantit që kërcënonte muslimanët. Osmani ftoi muslimanët që të bashkohen nën flamurin xhihadi në Rugën e Zotit. Kjo porosi u bë platformë në të cilën bazoheshin udhëheqësit e Perandorisë në kohën e fuqisë, krenarisë dhe dominimit të tyre. Ftesës së tij iu përgjigjën shumë njerëz, të cilët i nxiste dëshira e madhe për të ndihmuar Islamin dhe për ta rrëzuar Perandorinë Bizantine.

I.2.3 Të drejtat e muslimanëve në Perandorinë Osmane

Perandoria Osmane ishte shpallur shtet ku Islami është fe zyrtare dhe drejtësia bazohet në Sheriat. Sheriati si burime ka: ***Kur'anin, Sunetin e Muhamedit, Pajtimi i Dijetarëve muslimanë (Ikhma')*** dhe ***analogjinë (Kijas)***. Në Sheriat ekzistojnë të drejtat, obligimet dhe dispozitat ndëshkimore që vlejnë për muslimanët. Ligjet e Sheriatit kanë qenë të detyrueshme për muslimanët që kanë jetuar në kufijtë e Perandorisë Osmane.

Sa i përket të drejtave që muslimanët kanë pasur të rregulluara me ligjin islam, ato kanë pasur të bëjnë me lëmi të ndryshme të jetës. Muslimanët në Perandorinë Osmane kanë gëzuar këto lloje të drejtave:

- ***E drejta për të jetuar;***
- ***E drejta familjare;***
- ***E drejta e mbrojtjes së gjakut dhe nderit;***
- ***E drejta e shprehjes së lirë të mendimit dhe të vepruarit;***
- ***E drejta e posedimit të pasurisë, mënyrës së haxhimit të saj dhe trashëgimisë;***
- ***E drejta e shkollimit;***
- ***E drejta për ankesë ndaj padrejtësive.***

Me rëndësi është të theksohet se në Perandorinë Osmane të drejta dhe liri nuk kanë pasur vetëm muslimanët, të drejta dhe liri shumta kanë gëzuar edhe jomuslimanët. Pra, shteti është kujdesur në maksimum që të drejta dhe liri tu garantojë edhe qytetarëve jomuslimanë, pra, t'ju ofrojë siguri, liri dhe barazi në shtet, element ky që do t'i çojë ata të tregojnë lojalitet ndaj Perandorisë.

I.2.4 Të drejtat e jomuslimanëve në Perandorinë Osmane

Perandoria Osmane ka qenë një shtet i të gjithë qytetarëve dhe aty kanë gjetur trajtim të drejtë të gjithë qytetarët pa dallim race, kombësie, feje apo dallimi shoqëror. Jomuslimanët kanë gëzuar të gjitha të drejtat dhe liritë që ju kanë takuar dhe ato kanë qenë të rregulluara dhe të garantuara me Sheriat.

Sheriati islam nuk është i kufizuar vetëm në të drejtën e ithtarëve të tij muslimanë, gjë që në fakt e dallon Sheriatin islam nga ligjet e tjera, sepse aty jomuslimanët dhe muslimanët marrin pjesë në shumë të drejta të përgjithshme, që nuk i ka arritur ndonjë fe apo ligj tjetër. Të drejtat e përgjithshme për jomuslimanët janë të shumta, prej të cilave si më kryesore janë:

- *E drejta për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor;*
- *E drejta për liri në besim;*
- *E drejta në përmbajtje të ligjeve fetare të tyre;*
- *E drejta e tyre për drejtësi;*
- *E drejta për mbrojtje të gjakut, pasurisë dhe nderit;*
- *E drejta për mbrojtje nga armiqësia;*
- *E drejta për sjellje të mirë nga ana e muslimanëve;*
- *E drejta për solidarizim në shoqëri.*²⁷

Perandoria Osmane dallohej me një shumëllojshmëri të popujve, gjuhëve dhe feve. Perandoria i kushtoi vëmendje të posaçme bashkëjetesës, mirëkuptimit dhe harmonisë mes qytetarëve të saj. Fermanët e sulltanëve janë një dëshmi e pakontestueshme që tregojnë qartë që Perandoria Osmane ka aplikuar parimin tolerancës ndaj qytetarëve jomuslimanë. Jomuslimanët i gëzonin pothuajse të gjitha të drejtat që gëzonin edhe muslimanët, gjë që ndikonte që të gjithë qytetarët të jenë të kënaqur me të drejtat që gëzojnë dhe të jetojnë në harmoni me njëri-tjetrin. Garantimi i të drejtave për jomuslimanët dhe gjykimi i drejtë në shtet, ndikoi që për diku 625 vite të ekzistojë Perandoria Osmane.

I.2.4.1 Të drejtat dhe liritë e të krishterëve në Perandorinë Osmane

Një politikë tolerance dhe mirëkuptimi zanafillën e ka që kur sulltan Mehmet Fatihu e çliroi Konstandinopojën, kur i njohu Patriarkanës Ortodokse pavarësinë dhe lirinë e ushtrimit të rriteve fetare. Pas rënies së Konstandinopojës, nga vendet përreth erdhën shumë të deleguar për të përgëzuar sulltan Mehmet Fatihun për fitoren e arritur. Njëri ndër ta që erdhi tek sulltani Mehmet Fatihu, ishte edhe partriarku grek i Jerusalemit, Atanasjasi, i përcjellur nga priftërinjtë, që arriti për t'i kërkuar liritë që iu takojnë të krishterëve. Kjo ishte arsyeja që sulltani Mehmet Fatihu nxorri një ferman, me anë të të cilit ndalonte përzierjen në ritet fetare krishtere, kishat, manastiret dhe vendet e tyre të pelegrinazhit.

²⁷ Ajid, S. (2005): Të drejtat e jomuslimanëve në shtetin islam, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 16.

Sulltani Mehmet Fatihu nuk u mjaftua me kaq, në vitin 1461 solli nga Bursa në Stamboll peshkpoin Havokim dhe e shpalli atë patriark të Kishës Armene, si dhe asaj iu njohën të gjitha të drejtat që i ishin njohur Patriarkanës Ortodokse.²⁸

Në Arkivin Osman të Stambollit gjenden regjistra të kishave, të cilat tregojnë qartë për ekzistim të institucioneve jomuslimane dhe veprimtaritë e tyre fetare e bamirëse që nga viti 1453, pra që nga viti i çlirimit të Konstandinopojës nga ana e sulltan Mehmet Fatihut. Autoritet osmane njihnin tre milete (bashkësi fetare) kryesore krahas atij musliman, i cili ishte mileti kryesor në shtet.²⁹

Në fund të shekullit XVI mileti më i madh i Perandorisë ishte ai i krishterë ortodoksë, i cili përfshinte kishat sllave së bashku me ato greke dhe rumune. Të krishterët ortodoksë ishin të ndarë në një numër patriarkanash të pavarura qysh para pushtimit osmanë. Patriarkana Bullgare ishte e përqendruar në Ohër dhe Tërnovë, Patriarkana Serbe në Pejë dhe Patriarkana Greke e përqendruar në Konstandinopojë. Ritet fetare dhe doktrina e tyre ka qenë pak a shumë e njëjtë me përjashtim të gjuhës.³⁰

Besimtarët e krishterë kanë pasur të drejtë të plotë për t'i riparuar apo rindërtuar kishat. Kur e kanë pyetur teoricientin islam Shejhulislam Ebu Suud çfarë mendimi ka për mundësinë e djegies së ndonjë kishe gjatë rasteve të luftës, ai është përgjigjur në këtë mënyrë: “nëse digjet një qytet, nuk duhet të digjet edhe kisha”.³¹

Fakt interesant është që ministrat e Punëve të Jashtme përzgjidheshin nga aristokracia greke (fanariote). Ndërsa, profesionet si financa, prodhimi i barutit, arkitektura, prodhimi i monedhave, ishin në duart e armenëve. Kjo klasë armene e byrokratëve quhej me emrin “*amira*”.³²

1.2.4.1 Të drejtat dhe liritë e hebrenjve në Perandorinë Osmane

Inkuizicioni të cilin e filluan mbreti Ferdinand dhe mbretëresha Izabela në vitin 1492, rezultoi me dëbimin e mbi 1 milionë muslimanëve nga Spanja, si dhe mbi 300.000 hebrenjve. Një numër i madh i hebrenjve ishin drejtuar kah Afrika Veriore, kurse një pjesë në drejtim të Italisë, por një pjesë e konsiderueshme e tyre u drejtuan kah territori i Perandorisë Osmane. Kështu, me vendosjen e hebrenjve në territorin e Perandorisë, vjen deri te themelimi i bashkësive të mëdha hebraike në këto qytete të mëdha: Stamboll, Selanik, Izmir dhe Edirne. Poashtu, bashkësi hebraike u formuan edhe në disa qytete të Ballkanit dhe të Anadollisë.

²⁸ Berisha, A. (2011): Toleranca osmane dhe të krishterët, *Dituria Islame*, fq. 26.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Несими, Ќ.(2015): Мултирелигиозноста во мултикултурното османлиско општество, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 147.

³² Ortayli, I. (2015): Paqja Osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 159, 161-162.

Udhëheqësit shtetërorë osmanë që nga viti 1326 u kishin lejuar hebrenjve që të ndërtonin sinagoga (faltore) dhe shkolla, liri të plotë udhëtimi, zgjedhje të profesionit dhe të vendbanimit. Në kohën kur hebrenjtë përjetonin persekutime të rënda anembanë Evropës, ata në Perandorinë Osmane ishin në pozita të ndryshme shtetërore, ndër të tjera edhe si diplomatë dhe njerëz të biznesit. Mjekët hebrenj duke pasur dituri të gjera kanë mundur të qëndrojnë afër sulltanëve dhe vezirëve, e me këtë ndonjëherë kishin ndikim në çështjet politike. Para së gjithash, në shek. XVI, hebrenjtë u dërguan si këshilltarë me një grup delegatësh diplomatë osmanë në Evropë, kurse në disa raste hebrenjtë kanë luajtur rolin e ambasadorëve.³³

E ashtuquajtura Letra e Edirnes, shkruar nga një hebre i lindur në Gjermani në fillim të shekullit XV, ofron një pasqyrim konkret të gjendjes në Perandorinë Osmane. Autori i kësaj letre ua përkujton hebrenjve të cilët gjenden në Evropë, që të shkojnë në Perandorinë Osmane dhe kështu të mbrohen nga persekutimet që zhvilloheshin kundër tyre.

Në rajonin e Judesë, Samarisë dhe Galilesë, pra në rajonet e Palestinës, shekuj me radhë jetuan në harmoni muslimanët, krishterët dhe numër i vogël i hebrenjve. Në Jerusalem si qytet i madh dhe ku kishte një përzierje disa popujve të ndryshëm dhe të feve të ndryshme, çdokush mund të lëvizte lirshëm në të gjitha pjesët e qytetit, ndërsa hyrja në tempujt e shenjtë ishte e lirë për të gjithë.

Sulltan Sulejman I Kanuni më vitin 1522 e pushtoi ishullin Rodos. Ai, në ishull ka gjetur hebrenj të cilët kanë jetuar në kushte shumë të vështira si pasojë e padrejtësive nga ana e pushtetit të Venedikut. Gjatë periudhës nga 1525-1526 kur arriti ta pushtojë qytetin e Budapestit, Sulltan Sulejmani kishte vërejtur se popullsia hebreje gjendej në një pozitë shumë të pavolitshme, andaj urdhëroi që ata të dërgohen në Stamboll. Poashtu, edhe hebrenjtë që kanë jetuar në viset e Hungarisë, jetën e kanë pasur mjaft të vështirë, gjë që ka ndikuar që sulltani të urdhërojë që familjet hebreje të vendosen në qytetet: Nigbolu, Pleven dhe Edirne.

Po që se bëhet një vështrim i shkurtër historik ndaj hebrenjve të Irakut të shekullit XIX, mund të shihet se gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, Iraku ishte qendër e hebrenjve. Aty komuniteti hebre jetonte në kushte shumë të mira. David Beth Hillel i cili gjatë viteve 1824-1832 kishte udhëtuar nëpër Irak, Bagdadin e kishte përshkruar si një qytet të madh ku hebrenjtë jetonin në pjesët më të mira të qytetit dhe atë përreth pallateve të udhëheqësve. Sipas Hillel-it, në atë kohë në Bagdad jetonin 6.000 familje hebreje dhe në dispozicion kishin pesë sinagoga. Një numër i madh i hebrenjve kanë qenë tregtarë të pasur. Sekretari i guvernatorit ishte hebre dhe ai i qeveriste hebrenjtë, të cilët e quanin si “mbret i Izraelit”.³⁴

Në vitin 1868 hebrenjtë i kishin edhe gazetatat e tyre. Sistemin e parë shkollor në Irak e themeluan hebrenjtë. Gjimnazi në Bagdad ka ekzistuar që nga viti 1860, ndërsa në vitin 1892 ishte themeluar institucioni i lartë arsimor për vajza, i pari i këtij lloji në Irak.³⁵

³³ www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=1105, vizituar më 12 shtator 2018.

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty.

I.3 REFORMAT GJATË PERIUDHËS SË TANZIMATIT

I.3.1 Kuptimi për Tanzimatit

Tanzimatit ka të bëjë me reformat që u realizuan në Perandorinë Osmane gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX, gjatë kohës së Sulltan Abdulmexhidit I. Gjatë periudhës së Tanzimatit kishte një krizë të rëndë shoqërore dhe politike në Perandorinë Osmane dhe kjo gjendje bënte të domosdoshme reformat. Me reformat që duhej ndërmarrë mendohej që të dilej nga kriza që kishte kapluar Perandorinë Osmane.

Sulltan Abdulmexhidi ishte ai i cili mori guximin për reformim në Perandori. Më 3 nëntor të vitit 1839 shpalli dekretin perandorak i njohur si “Dekreti i shenjtë i Gjylhanës” ose ndryshe i njohur edhe si “Hati Sherifi i Gjylhanes”. Me këtë dekret në Perandorinë Osmane fillon periudha e reformave ose e njohur si periudha e Tanzimatit (që arabisht do të thotë reforma-rregullime). Sipas dekretit, Porta e Lartë do të garantonte jetën, nderin, pasurinë dhe besimin për të gjithë shtetasit pa dallim feje dhe kombësie, do të lehtësonte barrën e taksave të fshatarësisë dhe në vend të administratës së vjetër do të ngrihej një administratë e re, duke marrë si shembull atë të shteteve evropiane.³⁶

Në zbatim të dekretit të Gjylhanes, Porta e Lartë gajtë viteve ‘1840 ndërmori një varg reformash në lëminë e administratës, financave, drejtësisë dhe arsimit. Reformat e reja goditën më tej pushtetin lokal të feudalëve provincialë. Në çdo vend u vendos administrata e centralizuar osmane. Në atë kontekst vend të veçantë zinte edhe organizimi i mëtejshëm i ushtrisë me organizatorë prusë dhe vendosja e shërbimit ushtarak të detyruar por pa shpërblim.

Në historinë shqiptare Tanzimatit ka hyrë si një periudhë e kryengritjeve kundër përndjekjeve nga Porta e Lartë. Ajo me reformat gjatë periudhës së Tanzimatit ndiqte një politikë të centralizimit të qeverisjes shtetërore, qëllimi i të cilës ishte zgjatja e qeverisjes osmane në Shqipërinë e asaj kohe. Kjo periudhë tek shqiptarët njhet për fillimin e kryengritjeve kundër Perandorisë Osmane.

I.3.2 Reformat e Tanzimatit

Sulltan Abdulmexhidi I ka qenë ndër sulltanët më autoritativë të familjes osmane. E donte reformën, sistemet moderne dhe angazhohej që menjëherë t’i zbatonte në praktikë. Ai implementoi reforma të shumta në ushtrinë osmane. Gjatë periudhës së tij përparoi shkenca, u zgjerua rrethi i tregëtisë, u ngritën shumë ndërtesa të mëdha, u vendos rrjeti i telave të telefonit dhe u ndërtuan vija hekurudhore. Mosha e tij e re kur mori pushtetin iu shërbeu disa ministrave që ishin pro Perëndimit që të mbaronin gjërat që kishin filluar me prindin e tij. Fjala është për

³⁶ Grup autorësh (1996): Historia e popullit shqiptar, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, fq. 89.

reformat sipas modeleve evropiane dhe për vendosjen në përdorim të mjeteve të reja që ishin shpikur në vendet perëndimore.

Në dekretin perandorak të shpallur më 3 nëntor të vitit 1839 nga Sulltan Abdurmexhidi I, i njohur si “Hati Sherifi i Gjylhanes”, mes shumë gjërave thuhej edhe kjo: “...Të gjithë njerëzit e dinë se shteti ynë që nga lindja e tij mbështetej kryekëput në parimet e larta dhe në ligjet e pastra të Sheriatit. Si rrjedhojë e kësaj, forca e pushtetit tonë, madhështia, forma dhe bollëku e arritën kulminacionin. Mirëpo, çështja u përmbys para 150 viteve për shkak të moszbatimit dhe mospraktikimit të Sheriati Islam, respektivisht ligjeve të tij të pastra hyjnore. Kështu, shteti ynë përjetoi trazira të llojllojshme e tragjedi të njëpasnjëshme, me ç’rast forca e tij u zëvendësua me dobësinë, ndërsa pasuria e tij u zëvendësua me varfërinë...”³⁷

Ky dekret perandorak përmbante shumë nene, disa prej të cilëve mund të përmbledhen si vijon:

1. Sigurimi i jetës, nderit dhe pasurisë së të gjithë shtetasve të Perandorisë Osmane, pa marrë parasysh përkatësinë fetare;
2. Garantimi i metodës së drejtë për shpërndarjen dhe dhënien e tatimeve;
3. Të vepruarit me drejtësi dhe korrektësi në obligimin e shërbimit ushtarak, si dhe përcaktimin e kohëzgjatjes së tij;
4. Barazia në të drejtat dhe obligimet ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve.³⁸

Në këtë mënyrë filloi një periudhë e re, e cila u bë e njohur me emrin “Periudha e Tanzimatit Osman”.

“Hati Sherifi i Gjylhanes”, të cilin e përkrahte Mustafa Reshidi dhe një pakicë e njerëzve që e rrethonin atë, nuk ishte aspak i mirëseardhur e as i përkrahur nga shumica dërrmuese e muslimanëve. Kjo ndikoi që, dijetarët islamë e shpallën hapur kundërshtimin e tyre ndaj këtij dekreti perandorak, ndërsa Mustafa Reshidin Pashën e shpallën si pabesimtar.

Periudha e dytë e reformave filloi me një dekret të ri që u shpall në vitin 1856 dhe që njihet me emrin “Dekreti i Shenjtë Perandorak”. Ky dekret në historinë osmane u bë i njohur si “Hatti Humajuni” dhe ishte më i drejtpërdrejtë nga dekreti i parë dhe më i prirur për t’i imituar vendet perëndimore evropiane.

Në dekretin e dytë u ritheksuan parimet themelore të dekretit të Hatti Sherifit të Gjylhanes. Nga ligjet më të rëndësishme që dolën nga ky dekret ishte Ligji Agrar i vitit 1858, i cili u plotësua me dispozita tjera në vitet më pas. Ligji i Tokës i jepte fund pronësisë feudale ushtarake, sanksiononte pronësinë private mbi tokën dhe garantonte shitblerjen e saj të lirë.³⁹

³⁷ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 405.

³⁸ Po aty, fq. 406.

³⁹ Grup autorësh (1996): Historia e popullit shqiptar, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, fq. 89-90.

Dekreti i Shenjtë, i njohur ndryshe edhe si Hatti Humajun i përmbante këto nene:

1. Anulimi i sistemit rigoroz dhe zhdukja e korrupsionit;
2. Barazia në mobilizimin e ushtrisë ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve;
3. Trajtimi i të gjithë nënshtetasve të Perandorisë Osmane në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh përkatësinë ose doktrinën e tyre fetare;
4. Mbrojtja e të drejtave dhe privilegjeve, të cilat i gëzojnë udhëheqësit e feve të tjera;
5. Zhdukja e pengesave të sistemit të doktrinave, në mënyrë që të gjithë banorët që jetojnë në Perandorinë Osmane ta gëzojnë shtetësinë e barabartë;
6. Çështjet civile që u përkasin nënshtetasve krishterë do të jenë pjesë e një këshilli, i cili do të zgjidhet nga ana e vetë popullit;
7. Hapja e instituteve të studimit për të krishterët, në mënyrë që t'u hapen dyert e punësimit;
8. Dhënia e lejes për të huajt mbi posedimin e tokave (pronave) në shtet, njëherit sulltani premtonte se do të japë përkrahjen e tij me mjete nga buxheti dhe me ekspertë evropianë, në mënyrë që të arrihet zhvillimi i ekonomisë së shtetit.⁴⁰

Me këto dy dekrete Perandoria Osmane hyri në një periudhë që u bë e njohur me emrin “Periudha e Tanzimatit”, term ky që paraqiste reformimin e çështjeve shtetërore sipas ndjekjes së metodave evropiane përëndimore. Me anë të këtyre dy dekreteve, u largua nga skena zbatimi i Sheriatit Islam, ndërsa Perandoria Osmane filloi të modernizohej.

Reformat e Tanzimatit zyrtarisht e futën Perandorinë Osmane në rrugën e zhbërjes së saj si një shtet islam. Kështu, ligjet sekulariste, themelimi i organizatave të ndryshme, shpërfillja e ligjit islam në fushën e tregtisë, politikës dhe ekonomisë, të gjitha këto bënë që muslimanët këto ndërmarrje t'i konsiderojnë zhveshje të Perandorisë Osmane nga Sheriati. Shteti osman tashmë kishte armikun e brendshëm. Në njërën anë depërtimi i ndikimit evropian në sferën e kulturës, ekonomisë dhe politikës, ndërsa në anën tjetër dyshimi me të cilin muslimanët dhe dijetarët muslimanë e shihnin fatin e Perandorisë Osmane, u ndeshën dhe kjo përplasje si pasojë kishte zhbërjen e këtij shteti.⁴¹

I.3.3 Impakti i Reformave të Tanzimatit në Shqipëri

Në trojet shqiptare reformat e para filluan të zbatohen fill pas shpalljes së dekretit të “Hati Sherifit të Gjylhanes”. Pas rënies së pashallëqeve të mëdha shqiptare, Porta e Lartë nuk kishte më besim te funksionarëtshqiptarë, të cilët kishin shfaqur prirjet e tyre drejt qeverisjes së pavarur dhe drejt një shkëputjeje totale nga Perandoria Osmane. Prandaj, në krahinat shqiptare u desh që pushteti të kalojë shkallë-shkallë nga duart e feudalëve shqiptarë tek ato osmanë.

⁴⁰ Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 407-408.

⁴¹ Po aty, fq. 411-412.

Në përputhje me reformën ushtarake, filloi rekrutimi i ushtarëve të rregullt të cilët ishin të moshës nga 15-30 vjet. Të rinjtë shqiptarë duhej të bënin shërbimin e gjatë dhe të rëndë ushtarak, larg nga vendi i tyre dhe në kushte jashtëzakonisht të vështira. Popullsisë shqiptare iu caktua edhe një varg taksash të reja të cilat shkonin për mbajtjen e ushtrisë. Me këto reforma që nisën të zbatoheshin, Porta e Lartë kombësive që jetonin në Perandorinë Osmane u njohu të drejtën e shkollimit në gjuhën e vet amëtare. Mirëpo, ajo vazhdoi të identifikonte kombësinë me fenë dhe muslimanët i quante si “turq”, ortodoksët si “grekë” dhe katolikët si “latinë”. Meqë shqiptarët nuk përbënin një bashkësi të vetme fetare, por ishin të ndarë në muslimanë, ortodoksë dhe katolikë, nuk njiheshin si kombësi më vete. Si rrjedhojë, atyre nuk u njëhej edhe e drejta e përdorimit të gjuhës amtare dhe e zhvillimit të arsimit shqip. Prandaj pas Tanzimatit në trojet shqiptare u rrit numri i shkollave në gjuhë të huaja.⁴²

Duke parë qëndresën e shqiptarëve, sulltani nuk shpejtoi që menjëherë t’i zbatonte reformat në trojet shqiptare. Si rrjedhojë, gjatë viteve ‘40-të të shek. XIX, krahas administratës së re, në disa krahina shqiptare u ruajt administrata e vjetër, ku ende në shërbim ishin feudalët vendas. Kuptohet që reformat e reja që synonin të forconin Perandorinë Osmane, nuk mund të priteshin mirë nga populli shqiptar, i cili ndjeu rëndimin e zgjedhës së huaj si në fushën politike, ashtu edhe në atë ekonomike. Pakënaqësia bëhej edhe më e madhe për arsye se pas pashallëqeve të mëdha u kalua në sundimin e drejtpërdrejtë osman.⁴³

Kryengritjet më të mëdha të viteve ‘30 të shekullit XIX ishin ajo e Beratit dhe ajo e Shkodrës. Kryengritjen e Beratit e fillon popullsia e qytetit në vjeshtën e vitit 1834. Kryengritësit mbyllën qeveritarët osmanë në Kështjellën e Beratit, vunë në dorë magazinat shtetërore të drithit, që më pas rezervat e drithit ia shpërndanë popullsisë. Shumë shpejt Kryengritja e Beratit u përhap edhe në krahinat e tjera si në: Vlorë, Tepelenë, Skrapar, Tomorr, Mallakastër, Sulovë, Vërçë etj. Ndërsa në muajin maj të vitit 1835 shpërtheu një kryengritje e madhe në Shkodër nën udhëheqje të Hamza Kazazit, Dasho Shkrelit etj. Kryengritja përfshiu edhe krahina tjera të Shqipërisë së Veriut. Pjesë në kryengritje morën edhe vullnetarë nga Gjakova dhe Peja.

Kryengritje të mëdha antiosmane shpërthyen edhe në vitet ‘40-të të shekullit XIX. Pas kryengritjeve të banorëve të Prizrenit, Prishtinës dhe të Gjakovës gjatë vitit 1843, në mars të vitit 1844 shpërtheu një kryengritje e re që u shtri në Rrafshin e Dukagjinit, në rrethet e Prishtinës, Shkupit, Kumanovës dhe në krahinën e Pollogut (Tetovë dhe Gostivar). Kryengritësit që arritën numrin në rreth 10.000 vetë, të udhëhequr nga Dervish Cara, çliruan disa qytete.⁴⁴

Në gjysmën e parë të shekullit XIX dhe sidomos pas reformave të reja osmane, në qytetet shqiptare ndodhën ndryshime të rëndësishme ekonomike, të cilat çuan në zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Në disa qytete ndodhi rritja e konsiderueshme e popullsisë, si për shembull Shkodra

⁴² Grup autorësh (1996): Historia e popullit shqiptar, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, fq. 90.

⁴³ Po aty, fq. 90-91.

⁴⁴ Po aty, fq. 91.

me rreth 35.000 banorë dhe Prizreni me rreth 30.000 banorë. Në qytetet shqiptare të shek. XIX ekzistonin po ato degë prodhimi që ishin zhvilluar në shekujt e mëparshëm, si zejtaria, punëtoritë e vogla që merreshin me përpunimin e prodhimeve ushqimore, punëtoritë që merreshin me prodhimin e veshëmbathjes, ato që merreshin me përpunimin e drurit etj. Në shekullin XIX esnafët u kapluan nga një krizë e përgjithshme. Disiplina e vjetër esnafore kishte filluar të shkelej. Zejtarët nuk po i respektonin më rregullat e dikurshme lidhur me sasinë, cilësinë dhe çmimin e artikujve që prodhonin për treg. Dekretet dhe legjislacioni që dolën gjatë periudhës së Tanzimatit e thelluan edhe më shumë procesin e shthurjes dhe të rënies së esnafëve. Monopoli esnafor i prodhimit pësoi një goditje të rëndë. Konkurrenca e lirë dhe ligjet e tjera spontane të tregut po vepronin gjithnjë e më fuqishëm. Çirakët dhe kallfat të çliruar nga disiplina esnafore, mund të punonin kudo si mëditës.⁴⁵

Heqja e sistemit të timarit më vitin 1832, njohja zyrtarisht e pronës private mbi tokën dhe ligjet e tjera që kishin të bëjnë me tokën e që dolën gjatë periudhës së Tanzimatit, tregojnë se baza e vjetër mbi të cilën mbështetej sistemi osman i timarit po shkatërrohej dalëngadalë.

Me njohjen e pronësisë private mbi tokën, u formuan kushte më të favorshme për grumbullimin e tokave në duart e çifligarëve të mëdhenj dhe të pronarëve të rinj çifligarë. Poashtu, vetë Porta e Lartë, shumicën e çifligjeve që ua kishte konfiskuar dikur feudalëve shqiptarë kryengritës si Ali Pashë Tepelenës, Ibrahim Pashë Vërlacit etj., i shpalli pronësi çifligare shtetërore. Edhe institucionet fetare islame dhe ato të krishtere fituan të drejtën e pronësisë çifligare. Si rrjedhojë, vendin e pronësisë mariote-ushtarake tani e kishte zënë pronësia private, kryesisht ajo çifligare. Pjesa më e madhe e çifligjeve shtrihej në viset fushore, ku kishte më shumë tokë të punueshme. Prona çifligare zinte rreth 55% të tokave të punueshme. Me heqjen e sistemit të timarit, fshatarët apo reaja u njohën ligjërisht për pronarë të tokës që e punonin dhe u kthyen në fshatarë të lirë. Ndonëse me prona të vogla toke, kjo kategori fshatarësh përbënte pjesën më të madhe të fshatarësisë shqiptare.⁴⁶

Prapambeturia e shoqërisë shqiptare dhe shtypja osmane përbënin një pengesë shumë të madhe për përhapjen e ideve të reja dhe për zhvillimin e kulturës kombëtare. Kushte më të përshtatshme për zhvillimin e kulturës kombëtare pati jashtë atdheut, si në Stamboll, në Itali, Rumani etj. Rilindasit e parë dhe ata që e vazhduan rrugën e tyre, u bënë ideologë të çlirimit kombëtar dhe mësues, hartuan tekste shkollore dhe vepra letrare. Rilindasit e parë shqiptarë me shkrimet e tyre u përpoqën të shtonin dashurinë për gjuhën shqipe dhe për atdheun. Ndër rilindasit shqiptarë të cilët dhanë kontribut jashtëzakonisht për ngritjen e vetëdijes kombëtare ishin: Naum Veqilharxhi, Jeronin de Rada, Konstandin Kristoforidhi, Zef Jubani etj. Poashtu, kontribut të jashtëzakonshëm dhanë edhe Ismail Qemali, Hasan Tahsini, Sami Frashëri, Pashko Vasa, Jani Vreto, Thimi Mitko, Spiro Dine, Preng Doçi. Rilindasit ishin ata që sakrifkuan shumë për çështjen shqiptare dhe të njëjtët kontribuan në vendosjen e themeleve të shtetit shqiptar.

⁴⁵ Po aty, fq. 92.

⁴⁶ Po aty, fq. 93.

KAPITULLI II

TOLERANCA DHE MULTIKULTURA

II.1 TOLERANCA NË SHTETIN OSMAN

II.1.1 Kuptimi për tolerancën

Toleranca paraqet një vlerë njerëzore e cila është pjesë e etikës dhe moralit të njeriut apo shoqërisë. Fjala tolerancë nënkupton gatishmërinë për të pranuar ose për të toleruar, sidomos mendime apo sjellje që nuk mund të pajtohem me ndjeshmëri me ata që nuk janë si ne. Kjo do të thotë të tregosh respekt për racën, gjininë, kombësinë, fenë, mendimet apo ideologjitë e njerëzve apo grupeve shoqërore dhe të admirosh cilësitë e mira dhe punën e mirë të tjerëve.

Toleranca ka të bëjë me durimin, të kuptuarit që njerëzit e tjerë janë të ndryshëm nga ne dhe moskundërshtim të dallimeve, durim ndaj ekzistimit të shumëngjyshmërisë në aspektin kombëtar, fetar, klasor apo në dallimeve në qëndrime personale. Toleranca është shmangie e dhunës gjatë grindjeve verbale dhe shprehjes së qëndrimeve personale, si dhe gjatë paraqitjes së mosmarrëveshjeve që janë të natyrave të ndryshme.

“Toleranca nuk është qëllim por mjet, është cilësi minimale thelbësore e marrëdhënieve ndërnjerëzore që e shmang dhunën dhe trysninë”. Pa të paqja është e pamundshme. Në saje të tolerancës hapen mundësi shoqërore dhe zhvillohet kultura e paqes.⁴⁷

Indianët kanë qëndrim të mirë për tolerancën, e quajnë *ahimsa* – jodhunë, mosbërie keq as me mendime, as me fjalë, as me vepra, ku kjo nuk është e kufizuar vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj kafshëve dhe bimëve.⁴⁸

Toleranca mund të shfaqet në shumë mënyra, në raste të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Një person mund të mos pajtohet plotësisht me të tjerët për ndonjë çështje të caktuar, ndërkohë që nderon dhe respekton ata me ide dhe qëndrime të ndryshme dhe i trajton me dinjitet dhe nder të plotë. Ajo është e nevojshme në të gjitha lëmitë e jetës, në çdo nivel dhe çdo kohë, sepse ajo luan një rol jetësor për të vendosur paqen dhe dashurinë, nga njësia më e vogël e deri në njësinë më të lartë të shoqërisë.

Toleranca nuk do të thotë që vetëm një person duhet të tregojë tolerancë dhe të tjerët të mos e bëjnë atë. Kur disa njerëz nuk pajtohen për një çështje të caktuar, ata duhet të shprehin qëndrimet e tyre në mënyrë të respektueshme dhe nuk duhet të përdoren fjalët e urrejtjes apo provokimet. Toleranca duhet treguar nga të dyja palët për çështje të ndryshme, në mënyrë që të jetë efektive.

Duke treguar respekt dhe tolerancë ndaj qëndrimeve të tjerëve nuk do të thotë që ju duhet të bëni kompromis me parimet tuaja, ose të përqafojnë apo pranonin idetë e tjerëve. Është thjeshtë një çështje e të drejtave themelore të njeriut.

⁴⁷ “Tolerance: The threshold of peace” (1994): UNESCO, Paris, fq. 14.

⁴⁸ Temkov, K. (2010): Etika për klasën e VI, Qendra Grafike, Shkup, fq. 43.

Duhet të njihet e drejta e çdo qenieje njerëzore që ndjeshmëritë e saj të mos shkelen. Çdo person ka të drejtën të ketë qëndrim dhe ta shprehë atë në mënyrë të lirë.

Mungesa e tolerancës çon drejt mosmarrëveshjeve dhe drejt shfaqjes së dhunës. Paraqitja e dhunës shkatërron paqen dhe sigurinë e shoqërisë. Kur njerëzit dështojnë në një paraqitje të fakteve që kanë, ata humbin durimin dhe tregohen jotolerantë dhe më pas përdorin forcën për t'i arsyetuar dhe përmbushur qëllimet e tyre.

Gjatë historisë kanë ndodhur incidente e konflikte të shumta, të cilat kanë qenë për shkak të asaj se ka munguar toleranca. Incidentet që kanë ndodhur në mes grupeve të ndryshme shoqërore kanë qenë kryesisht si pasojë e dallimeve politike, kombëtare apo fetare. Mos ekzistimi i tolerancës ka shkaktuar gjakderdhje nëpër shumë vende të botës. Incidentet e përgjakshme e kanë cenuar paqen dhe lumturinë e njerëzve, ato kanë shkaktuar pasiguri dhe humbje të jetëve të njerëzve dhe shkatërrim të pasurisë. Sa bukur do të ishte që të gjithë të mundoheshin të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre në një mënyrë të denjë dhe të respektueshme, me tolerancë dhe konsideratë për tjetrin.

II.1.2 Toleranca në Perandorinë Osmane

Perandoria Osmane ka qenë një shtet i madh në të cilin kanë jetuar popuj të ndryshëm, me besime të ndryshme. Pra, në Perandorinë Osmane ka ekzistuar shumëllojshmëri kombëtare dhe fetare, e cila ka qenë një sfidë e madhe për udhëheqësit shtetërorë të Perandorisë. Populli turk ka qenë populli më i numërt në kuadër të Perandorisë Osmane. Edhe muslimanët kanë qenë shumë më në numër se popullsia krishtere dhe hebrenje. Përveç turqve, në Perandori kanë jetuar edhe popuj të tjerë si: grekët, armenët, shqiptarët, sllavët, arabët, romunët, kurdët, romët, tatarët, asirianët, druzët etj. Turqit dhe popujt e tjerë të përkatësisë islame kanë qenë në udhëheqje të Perandorisë Osmane.

Muslimanët kanë pasur tolerancë dhe i kanë respektuar të krishterët dhe hebrenjtë, u kanë dhënë pushtet në vendet e tyre dhe në pushtetin qendror pozita të larta. Perandoria Osmane ka qenë shtet i të gjithë popujve me besim të ndryshëm fetar dhe trajtimi ka qenë i njëjtë për të gjithë. Toleranca ka qenë shtyllë kryesore që ka mbajtur gjallë për 625 vjet Perandorinë Osmane.

Fanariotët, emër ky që përdorej për grekët dhe popuj të tjerë ballkanikë që ishin ortodoksë, ishin element i rëndësishëm në administratën osmane dhe në pushtetin qendror. Ata përkthenin dhe merreshin me marrëdhëniet e jashtme dhe ishin njohës të mirë të gjuhës osmane. Njerëzit e ditur fanariotë kishin studiuar nëpër vende të ndryshme të Evropës dhe i njihnin mirë gjuhët evropiane. Një personalitet fanariot mjaft i shquar ka qenë Kostaki Musurus Pasha. Ai për katërdhjetë vite radhazi ishte në postin e ambasadorit osman në Londër dhe ka qenë njëri nga ambasadorët më të respektuar⁴⁹.

⁴⁹ Ortayli, I. (2015): Paqja Osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 161.

Ndërkohë, profesionet si financat, prodhimi i barutit, arkitektura, prodhimi i monedhave, ishin në duart e armenëve. Klasa e byrokratëve armenë quhej me emrin “*amira*”. Artin Dadjan Pasha ishte më i fundit prej tyre. Ai ka qenë ministër i Financave dhe i Punëve të Jashtme dhe ishte i preferuari i Sulltan Abdylhamitit të II. Në këtë klasë të burokratëve bënin pjesë edhe familjet e njohura të Bezazjanët dhe Baljanët. Ata nuk kishin lidhje me nacionalizmin armen, sepse ishin qytetarë osmanë.⁵⁰

Hebrenjtë edhe pse ishin në numër të vogël në Perandorinë Osmane, i gëzonin të drejtat e tyre si të gjithë qytetarët e tjerë të Shtetit Osman. Muslimanët si shumicë ishin mjaft tolerantë ndaj hebrenjve. Në Perandorinë Osmane hebrenjtë njiheshin si tregtarë mjaft të zgjuar, mjekët më të mirë ishin hebrenj dhe njëherit nga komuniteti hebre kanë dalë shumë intelektualë të shquar. Toleranca e muslimanëve ndaj hebrenjve mund të shpjegohet me këtë shembull konkret: hebrenjtë ndërtuan sinagogën në Hajdarpasha dhe atë e quajtën “Hemedat Israil” që në përkthim do të thotë “Faleminderim i Izraelit”. Një emër të tillë ia dhanë sinagogës së ndërtuar me leje të Sulltan Abdylhamidit të II në përvjetorin e 400 të emigrimit të hebrenjve.

Siç dihet qytetarët osmanë jetonin të organizuar në sistemin e mileteve⁵¹. E njëjta gjë është edhe për mëhallat. Si esnafët e varfër armenë, poashtu edhe bankierët armenë jetonin në të njëjtin vend. Shtëpitë e tyre ishin të ngjitura me njëra-tjetrën. Në Perandorinë Osmane njerëzit nuk banonin sipas klasës shoqërore, por sipas përkatësisë fetare (sipas milletit të tyre).⁵²

Në shekullin e XIX, në Perandorinë Osmane kishte diçka që nuk ekzistonte në asnjë shtet, ngase shumë guvernatorë, ministra, ambasadorë dhe nëpunës të Ministrisë së Punëve të Jashtme që dinin gjuhë të huaja ishin jomuslimanë. Në të gjitha shkollat e Perandorisë Osmane një e treta e nxënësve ishin jomuslimanë. Më saktë, në shkollat më të mira osmane, siç ishin Shkolla e Mjekësisë, apo ajo e Shkencave Politike, një e treta e studentëve ishin jomuslimanë.⁵³

Në Perandorinë Osmane kishte tolerancë në mes grupeve kombëtare, si dhe në mes shumicës muslimane dhe popullsisë jomuslimane. Ky shtet ishte mjaft stabil dhe i dashur thuajse për të gjithë. Mirëpo, pasi humbi toleranca dhe respekti i ndërsjellt, filluan edhe mosmarrëveshjet dhe grindjet në mes turqve dhe popujve tjerë. Por, me rëndësi është të theksohet se, deri te problemet që u paraqitën në Perandorinë Osmane, ndikim të madh kishin faktorët e jashtëm që ngacmonin popujt që ishin me besim krishterë për gjoja më shumë të drejta. Në fakt synimi i fuqive të jashtme ishte që të arrihej shkatërrimi i Perandorisë. Normalisht, përgjegjëse për problemet ishte Porta e Lartë, e cila nuk menaxhoi si duhet mosdurimin tek popullata, por në vend që të sillej me maturi dhe të dialogonte, ajo u mundua që me forcë që t'i shtypte pakënaqësitë e paraqitura tek një pjesë e popullsisë së Perandorisë. Mungesa e tolerancës dhe

⁵⁰ Po aty, fq. 161-162.

⁵¹ Pajaziti, A., Sela, Y., & Trajkoska, J. (2015). *Multikulturalizmi në Republikën e Maqedonisë: Studim i rastit të Kumanovës*, ISPN, Shkup.

⁵² Po aty, fq. 165.

⁵³ Po aty, fq. 166.

respektit solli urrejtje dhe konflikte, të cilat si pajë sollën shembjen e shtetit madhështor të Perandorisë Osmane që ekzistoi shumë gjatë, për 625 vjet ishte model mjaft i mirë për tolerancë dhe respekt në mes popujve me kombësi dhe fe të ndryshme.


II.2 SHOQËRIA MULTIKULTURORE DHE CIVILIZIMI OSMAN

II.2.1 Shoqëria multikulturore në Perandorinë Osmane

Siç është e njohur tashmë, Perandoria Osmane fillimisht u formua si shtet në Anadoll, në të cilin kryesisht gravitonin fiset turke. Por, me kalimin e kohës ajo u zgjerua territorialisht dhe në kuadër të saj hynë edhe popuj tjerë, të cilët për nga gjuha dhe kultura ishin të ndryshëm nga turqit. Duhet theksuar se popujt që u bënë pjesë e Perandorisë Osmane, nuk ishin të gjithë muslimanë, me besime të ndryshme, gjë që paraqiste një sfidë për udhëheqësit shtetëror osmanë. Duke filluar nga shekulli i XIV e më pas, Perandoria Osmane kishte zgjeruar gradualisht kufijtë e vet, dalëngadalë duke përfshirë brenda vetes popuj të shumtë si: rumunët, armenët, sllavët e jugut (serbët, bullgarët, malazezët etj.), grekët, shqiptarët, kurdët, arabët, romët, asirianët, tatarët, hebrenjtë, druzët etj.

Tabela 3. Struktura kombëtare e popullsisë së Perandorisë Osmane sipas regjistrimit të vitit 1856.

Kombësia	Turq	Sllavë	Arabë	Rumunë	Armenë	Grekë	Shqiptarë	Kurdë	Të tjerë
Numri	12.800.000	6.200.000	4.700.000	4.000.000	2.400.000	2.000.000	1.500.000	1.000.000	750.000
Përq. (%)	36,21	17,54	13,30	11,31	6,79	5,66	4,24	2,83	2,12



Grafikoni 3. Struktura kombëtare e popullsisë së Perandorisë Osmane sipas regjistrimit të vitit 1856.

Turqit ishin populli më i madh për nga numri në Perandorinë Osmane, mirëpo, ata nuk ishin shumicë pasi që përbënin 36,21% të popullsisë së përgjithshme. Pas turqve, në numër të konsiderueshëm ishin sllavët, rumunët dhe arabët që kalonin 10%. Nuk ishte aspak i vogël as numri i popullsisë shqiptare që jetonte në Perandorinë Osmane. Sipas të dhënave zyrtare osmane, në Perandorinë Osmane në fillim të viteve '40-të të shekullit XIX kanë jetuar 1.500.000 shqiptarë dhe përbënin 2,38% të popullsisë së përgjithshme të Perandorisë. Roli i shqiptarëve në Perandorinë Osmane ka qenë shumë me peshë, ngase shqiptarët kanë qenë pjesë e udhëheqësisë së kësaj perandorie. Shqiptarët janë njohur si njerëz shumë të guximshëm dhe besnikë, dhe për shkak të këtyre vetive një pjesë e ushtarëve shqiptarë janë emëruar komandantë dhe gjeneralë në ushtrinë osmane.

Edhe pse thelbi i Perandorisë Osmane ka qenë popullsia turke, pjesë e saj e rëndësishme kanë qenë edhe popujt e tjerë. Perandoria Osmane është dalluar me larmi të popujve të kulturave të ndryshme. Me shekuj të tërë popujt me kombësi të ndryshme kanë bashkëjetuar në paqe dhe harmoni.

Popullsia shqiptare ishte e shpërndarë nëpër vise të ndryshme të Perandorisë Osmane, mirëpo, pjesa dërrmuese e saj jetonte në 4 vilajetet: në Vilajetin e Shkodrës, në Vilajetin e Kosovës, në Vilajetin e Janinës dhe atë të Manastirit. Në këto 4 vilajete popullsia shqiptare përbënte shumicën e popullsisë së përgjithshme. Popullsia shqiptare ishte e dy besimeve dhe atë: besimit islam dhe krishterë (ortodoksë dhe katolikë). Diku afër $\frac{2}{3}$ e popullsisë shqiptare ishte muslimane, kurse $\frac{1}{3}$ e saj ishte ortodokse dhe katolike. Vilajeti i Shkodrës njihet për përqindjen më të madhe të popullsisë shqiptare, respektivisht popullsia shqiptare përbënte mbi 98% të popullsisë së përgjithshme që jetonte në vilajet. Sipas të dhënave nga regjistrimi i kryer më vitin 1905-1906, në Vilajetin e Janinës kanë jetuar 227.484 shqiptarë muslimanë, 213.281 shqiptarë ortodoksë dhe vllahë, 91.991 grekë dhe 496 hebrej, kurse në Vilajetin e Manastirit kanë jetuar 457.994 shqiptarë muslimanë, 264.008 shqiptarë ortodoksë dhe vllahë, 198.335 bullgarë, 55.108 grekë, 2.760 romë dhe 254 shqiptarë katolikë dhe protestantë⁵⁴.

Shkupi njihet si njëri nga qytetet më të mëdha shqiptare. Ai ka qenë qendër kryesore e Sanxhakut të Shkupit dhe njëherit edhe qendër e Vilajetit të Kosovës. Të dhënat e para për numrin e popullsisë për këtë qytet jepen nga peshkopi i qytetit të Tivarit në vitin 1604, ku ai ka shënuar se në Shkup ka 40.000 shtëpi dhe diçka mbi 200.000 banorë. Të dhëna për këtë qytet jepen edhe nga udhëpërkruesi Evlija Çelebi, i cili më vitin 1689 jep të dhëna se ky qytet ka 12.000 shtëpi, 120 xhami, 110 çeizma, 70 hamame (banjo publike) dhe 2.115 dyqane dhe diku mbi 60.000 banorë. Ndërsa gazetari francez Leon Igone, i cili në vitin 1878 viziton qytetin e Shkupit, shkruan se qyteti në fjalë ka pasur 30.000 banorë. Në regjistrimet e kryera në fillim të shekullit XX, qyteti i Shkupit ka pasur këtë numër të popullsisë: në vitin 1913 ka pasur 43.331 banorë dhe në vitin 1919 ka pasur 51.758 banorë. Shkupi në Perandorinë Osmane ka qenë i

⁵⁴ Grup autorësh (1996): Historia e popullit shqiptar, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë, fq. 142-143.

njohur si qytet mjaft i rëndësishëm në pjesën evropiane të saj, njëri nga qytetet ku kanë bashkëjetuar në paqe e harmoni popuj me kombësi dhe fe të ndryshme. Në qytet dhe rrethinën e tij shumica e popullsisë ka qenë shqiptare, ku nga ajo shumica dërrmuese ka qenë e fesë islame, kurse pakica e saj ka qenë ortodokse dhe katolike.



Foto. 4. Pamja se si është dukur qyteti i Shkupit kah fundi i shekullit XVI, gravurë e punuar në vitin 1594 nga artisti i mirënjohur holandez Jakobus Haverin.

Popujt e kombësive të ndryshme kanë pasur shtrirje territoriale të ndryshme brenda Perandorisë Osmane. Popullsia shqiptare kryesisht ka jetuar në 4 vilajetet, pra atë të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, popullsia sllave ka banuar kryesisht pjesën veriore dhe lindore të Rumelisë, grekët kryesisht në pjesën jugore të gadishullit Ballkanik, rumunët kanë jetuar mbi lumin Danub, respektivisht në verilindje të Gadishullit Ballkanik, romët dhe hebrenjtë kanë jetuar në grupe të vogla nëpër qytetet më të mëdha të Rumelisë. Turqit si popull më në numër kanë banuar pothuajse në të gjithë Anadollinë, kurdët kanë jetuar në luginën e epërme të lumit Eufrat dhe Tigër, armenët kryesisht në Rrafshlartën Armene dhe hapësirën rreth liqenit Van, kurse në numër të vogël janë gjendur edhe nëpër qytetet e mëdha të Anadollisë. Ndërsa arabët si popull mjaft në numër, kryesisht kanë banuar hapësirën përgjatë bregdetit të Detit Levant, Detit të Kuq, në hapësirën përgjatë brigjeve jugore të Detit Mesdhe, në gjithë territorin e Egjiptit dhe Mesopotaminë.

Në sipërfaqen e tokës jetojnë njerëz të racave, kombësive dhe feve të ndryshme. Mes tyre ekzistojnë dallime të mëdha në aspekt të gjuhës e tyre, në mënyrën e jetës, në doke dhe zakone, mënyrën e praktikimit të fesë etj. Mirëpo, edhe përkaj këtyre dallimeve, njerëzit kanë një të përbashkët se janë qenie e mençur me sjellje racionale, pra që veti që i dallojnë ata nga shtazët.

Dallimet midis njerëzve janë gjenetike dhe sociale që kanë prodhuar konceptin e "qytetërimit". Kur thuhet se njeriu është i qytetëruar nga natyra, dëshirohet të arrihet që qytetërimi të shndërrohet në cilësi të përhershme të njeriut, por pa këmbëngulur që të thuhet se njeriu vetvetiu është i qytetëruar dhe se është i krijuar i qytetëruar. Njeriu ka edhe tipare të egërsisë, por i është dhënë aftësia nga ana e Zotit që ai të përmirësojë gjendjen e vet dhe të qytetërohet.⁵⁵

Peraduria Osmane prej periudhës së osmanëve, respektivisht në bartësit e parë të pushtetit osman deri në periudhën e dy shekujve të fundit, është përqëndruar në sundimin politik, administrativ, ekonomik dhe ushtarak, si dhe mbi të gjitha në atë ideologjik islam. Peraduria Osmane për atë periudhë, me gjithë baticat dhe zbaticat e brendshme, ishte perandori më e fortë tokësore dhe më vonë edhe detare, në kontinentet Evropë, Azi dhe Afrikë. Kjo ishte arsyeja që vendet perëndimore në çdo mënyrë mundoheshin që këtë perandori ta dobësojnë dhe njëherit edhe ta shkatërrojnë. Koncepti ideologjik i Perandorisë Osmane ka qenë islamik, i bazuar në Kur'an dhe Sunet, si dhe në trajtimin korrekt të gjithë qytetarëve të saj. Por, nxitjet e jashtme të popujve ballkanikë për më shumë liri, organizatat konspirative shkatërruese të brendshme dhe të jashtme, ia arritën qëllimit që deri në vitet e '20-ta të shekullit XX të shkatërrojnë këtë ngrehinë të madhe të historisë së njerëzimit.⁵⁶

Peraduria Osmane ka shfrytëzuar resurset intelektuale njerëzore efektive pa marrë parasysh përkatësinë e tyre. Simbolet, konceptet dhe institucionet e Perandorisë Osmane mbajnë gjurmët e kësaj gjithëpërfshirjeje. Sulltanët në të njëjtën kohë ishin edhe kalifë. Vula e Sulltanit Sulejman të II sjell në kujtesën shoqërore si një parameter mentaliteti idealin e Perandorisë Osmane brenda traditës, simbolet e esnafëve dhe oficerëve ushtarakë, si dhe unitetin e thellë besim-histori dhe moral-punë. Në këtë këndvëprim kishte një sistem që buronte më tepër nga një përzgjedhje vetbetuese dhe koherente sesa nga një kaos eklektik.⁵⁷

Çdo akumulim civilizimi dhe çdo shoqëri kulturore që gjendej brenda sistemit osman, kishte gjetur një lloj marrëdhënie legjitimiteti midis vetes dhe rendit politik. Shteti Osman u ballafaqua me një krizë legjitimiteti vetëm në fillim të shekullit të XIX, gjë që ishte për shkak të ndikimit të Revolucionit Francez, problem të cilin më përpara e pati përjetuar edhe Roma menjëherë pas periudhës së vitit 117 pas erës sonë, kohë kur ajo pati zgjerimin më të madh të saj dhe të cilën ajo nuk e arriti ta zgjidhte me sukses. Mbajtja së bashku nga ana e Shtetit Osman, i cili në fillim të shekullit të XVII kishte realizuar zgjerimin më të madh të kufijve të tij, e njerëzve që vinin nga civilizime të ndryshme të këtij rajoni të gjerë.⁵⁸

Sistemi osman ishte një sistem i veçantë. Për Perandorinë Osmane nuk ekzistonte detyrimi për të ndjekur gjurmët e kapitalizmit modern. Në periudhën klasike osmane nuk pati një

⁵⁵ Frashëri, S. (2009): Qytetërimi Islam, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 21.

⁵⁶ Salabi, M. A. (2009): Peraduria Osmane-Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë, fq. 5.

⁵⁷ Çakir, C. (2014): Civilizimi Osman - Politikë•Ekonomi•Art, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 18.

⁵⁸ Po aty, fq. 18-19.

përpjekje shtetëzimi, mbase ekzistonte sundimi ideologjik i shtetit. Përpjekjet e shtetëzimit dhe plogështia nisën pas periudhës së Tanzimatit. Sistemi i vakëfeve është një element bazë i sigurisë sociale dhe një element i rëndësishëm i financës përpara Tanzimatit. Ndërsa, pas Tanzimatit, shteti i mori nën përgjegjësinë e vet sigurinë sociale dhe vakëfet, duke ua humbur gradualisht ndikimin e tyre në shoqëri. Periudha e Tanzimatit përbën fillimin e situatës së dhimbshme sa i përket sigurisë sociale.⁵⁹

Perandoria Osmane e mbylli periudhën e ekzistencës së saj me anë të përplasjes së rrymave si osmanizmi, islamizmi dhe nacionalizmi. Vetë mentaliteti osman zuri vend brenda kësaj përplasjeje. Anëtarët e opozitës që kërkonin të parandalonin shpërbërjen e Perandorisë më tepër ishin të kombësisë turke. Administrata kozmopolite anonte ose nga opozita zyrtare dhe pushteti aktual, ose anonte nga rrymat nacionaliste. Ndërkohë, kishte edhe prej tyre që ishin kundër kërkesave separatiste të grupit etnik dhe fetar, dhe që ishin pjesë e patriotizmit osman.⁶⁰

S'ka dyshim se osmanizmi nuk ishte një nacionalizëm me bazë në vetëdijen e fortë historike. Ai ishte një ideologji pragmatiste dhe atdhetare, që bazohej në traditat e një gjeografie të caktuar. Është e vështirë të hasësh studime serioze që tregojnë se kjo elitë kozmopolite, që ishte pjesë e osmanizmit, kishte një vetëdije të përbashkët historike osmane, poashtu, është e vështirë të gjeësh interpretime historike që bazohen në një vetëdije të tillë. Interpretimet historike të intelektualëve arabë si Butrus el-Bustani, Rifat Tahtavi dhe Abdurrahman Kevakibi, të cilët e shihnin si të detyrueshëm vazhdimësinë e bashkimit (unitetit) osman nga ana administrative, politike dhe ekonomike, kishin një nacionalizëm arab që bazohej tërësisht në racizëm dhe në ndjenja anti-turke.⁶¹

Një fjalë e përdorur shpesh për të përshkruar Perandorinë Osmane është “copë-copë” dhe ekziston një përshtypje e përgjithshme se qeveria osmane qe gjithmonë e paaftë dhe e korruptuar. Megjithatë, dokumenta të panumërta në arkivat e Stambollit tregojnë se deri në shek. e XVI Perandoria Osmane qeverisej nga një strukturë burokratike e përpunuar, jashtëzakonisht e kujdesshme në detyrën e saj të administrimit të një shteti. Vetëm një seri regjistrash, në mbi 1000 vëllime, përmban një regjistrim për qytete, fshatra, popullsi dhe të ardhura për të gjithë Perandorinë nga Budapesti e deri në Bagdad. Diku 50000 e më shumë regjistra të lidhura me miliona letra, ende ruhen në arkivat turke. Këto flasin për një administratë mjaft të përgatitur.⁶²

Regjistrat osmane tregojnë një rritje të numrit të popullsisë dhe për begati në shumicën e zonave të pushtuara. Në territoret arabe, pushtimi osman solli paqe e siguri pas tmerrit të rëndë të sundimit memluk. Edhe në gadishullin e Ballkanit, qeveria osmane solli bashkim dhe siguri, në vend të konflikteve dhe kaosit të mëparshëm. Në luftërat pushtuese, një pjesë e madhe e aristokracisë u shkatërrua dhe pasuritë e tyre u inkorporuan në sistemin feudal osman dhe iu

⁵⁹ Po aty, fq. 29.

⁶⁰ Ortaylı, I. (2015): Paqja Osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 33.

⁶¹ Po aty, fq. 34.

⁶² “Europa dhe turqit”: Qytetërimi i Perandorisë Osmane”, Gazeta Impakt, 25 maj, 2018.

dhuruan ushtarëve osmanë. Mbajtësi i këtyre pronave preokupohej vetëm me të ardhurat dhe nuk kishte të drejta sinjorie. Për pasojë, fshatarët gëzonin liri shumë më të madhe në fermat e tyre sesa më parë, ndërsa veprimi i ligjit osman e parandalonte copëtimin e përqëndrimin e pronësisë mbi tokën.

Një akuzë që i drejtohet Perandorisë Osmane është ajo e tiranisë. Sigurisht që Sulltani nuk ishte demokrat, por në fund të fundit, demokracia siç e njohim dhe e praktikojmë ne atë, ajo ka qenë e pranishme vetëm në pak vende të botës dhe në shumicën e tyre është e vonshme. Sulltani nuk qe një despot i vërtetë, por gardiani suprem i Ligjit të Zotit, të Islamit, ndaj të cilit vetë ai ishte subjekt. Është e vërtetë se Sheriati i jepte atij një pushtet pothuajse despotik dhe se kjo nuk siguronte për zbatimin kundër tij, por, në analizë të fundit, Sheriati mbeti baza e strukturës sociale dhe politike të Perandorisë Osmane dhe vëzhgohej nga sulltanët, sovraniteti i të cilëve pranohej dhe respektohej nga njerëzit, qofshin muslimanë apo të krishterë, si i drejtë dhe i pashmangshëm.⁶³

Në themelin e mentalitetit osman gjendej populli. Pra, shteti është për popullin, më saktë ai është në shërbim të popullit. Mirëpo, me kalimin e kohës shteti u zgjerua shumë dhe si rrjedhojë nuk mund të thuhet se shteti nuk u shkëput nga populli. Kjo shkëputje ishte si një sëmundje dhe vlente për të gjitha ato shtete që kanë pasur një periudhë të gjatë ekzistence. Arsyeja themelore e shtetit është sigurimi i mirëqenies dhe lumturisë së popullit. Kjo gjë shihet shpesh në dokumentat osmane. Për shembull, një ferman shpallet për të parandaluar që paraja të shkojë në Lindje, Pra, ky dokument synonte ruajtjen e mirëqenies sociale të popullit. Në çdo gjë osmane ka një mentalitet të mirëqenies sociale dhe drejtësisë. Përpara plogështimit të shtetit, ajo gjë pasqyrohej nga ana ekonomike. Aktivitetet ekonomike kryheshin nga njerëzit, pra nga individët. Shteti nuk ndërhynte në këta aktivitete. Detyra e shtetit ishte vetëm kontrolli i këtyre aktiviteteve. Prodhimtaria nuk ishte një detyrë e shtetit. Bile dhe në mbledhjen e taksave dhe financa. Perandoria Osmane e pati privatizuar me anë të sistemit të iltizamit (mbledhja e taksave me anë të sipërmarrjes). Në kuptimin fetar dhe politik Perandoria Osmane ishte një shtet centralist, por në kuptim administrativ, ekonomik dhe financiar paraqiste shtet decentralizues.⁶⁴

Shikimi i Perandorisë Osmane si një vazhdimësi e diçkaje të caktuar është rrjedhojë e tradicionalizmit dhe për këtë gjë nuk kishte asnjë kompleks. Çdo gjë që është e mirë duhet të merret. Mirëpo, kjo nuk nëkupton se duhet të merren edhe ato gjëra që nuk i përshtaten Islamit. Mauricie Lombard thotë se: “Muslimanët marrin çdo gjë që kanë dëshirë, por tregojnë zell për të lënë çdo gjë që nuk duan”. Ata mund të hedhin çdo gjë që nuk iu përshtatet. Natyrisht që për t’u zgjedhur nevojitet një aftësi dhe kulturë e madhe. Kur nuk ka kulturë, përzgjedhja ia lë vendin dorëzimit.⁶⁵

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Çakir, C. (2014): Civilizimi Osman - Politikë•Ekonomi•Art, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 29.

⁶⁵ Po aty, fq. 28.

S'ka dyshim se osmanët kanë pasur peshë jo vetëm si shtet, por në të njëjtën kohë edhe si histori. Historia osmane ka pasur një ngritje të lartë nga këndvështrimi i kulturës dhe civilizimit. Ajo përfshin pothuajse gjysmën e historisë islame. Osmanët u shfaqën në skenë në një periudhë kur ende nuk ishte zbuluar bota e re, kur ata pushtuan pjesë të Azisë, Evropës dhe Afrikës. Pra, për shkak të këtyre veçorive, pa shkruar historinë osmane është e pamundur të shkruash historinë e tridhjetë shteteve të vegjël që u shfaqën pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane.⁶⁶

Perandoria Osmane ishte perandoria e fundit që iu përshtat kushteve të botës së re dhe që siguroi kalimin në kombëtarizimin e saj. Në të kundërtën e perandorive kolonizuese, të cilat zhdukën kulturat vendase, Perandoria Osmane në fazën e fundit të historisë së ekzistimit të saj, i çoi drejt kombëtarizimit kulturat vendase dhe kombet e vogla.⁶⁷

Sikur që borgjezia është ajo që formon mentalitetin perëndimor dhe kapitalizmin, poashtu, elementi bazë që formon mentalitetin osman dhe sistemin e tij është zemërgjerësia, e cila vetëm jep dhe synon solidarizimin shoqëror. Në themel të këtij mentaliteti gjenden tasavvufi dhe Islami.⁶⁸

II.3 TOLERANCA FETARE DHE KOMBËTARE NË PERANDORINË OSMANE – SISTEMI I MILETIT

II.3.1 Kuptimi i fjalës millet

Në të vërtetë, fjala *millet* shpreh një përkatësi fetare. Koncepti i saj në formën e termit *nation* është një përdorim të cilin Perandoria Osmane ua solli kombeve të Lindjes gjatë shekujve. Individi jeton i lidhur me autoritetin shpirtëror, financiar dhe administrative të atij komuniteti brenda komparitetit të milletit. Ai e ndërton komparitetin nëse konvertohet në fenë islame. Konvertimi nga feja islame në një fe tjetër nuk është i pëlqyeshëm tek muslimanët. Në periudhën e shekullit XIX brenda bashkësisë të krishtere janë vënë re ndryshime të sektit. Këtu nënkuptohet konvertimi i armenëve në katolikë dhe protestantë, të surjanitëve në katolikë, si dhe të koptëve dhe të bullgarëve të konvertuar në katolikë. Këtu millet i nuk është një koncept, por ai shpreh një organizim shoqëror, një gjendje shpirtërore dhe një këndvështrim të qytetarëve ndaj njëri-tjetrit. Fjala minoritet është futur në jetën shoqërore dhe shtetërore në vitet e fundit të Perandorisë.⁶⁹

Termi arab millet (*milal*-arabisht), është përvetësuar në shqip nga osmanishtja, nënkupton organizimin shoqëror sipas përkatësisë fetare të grupimeve të ndryshme shoqërore. Pra, millet i në Perandorinë Osmane nënkuptonte kombin e përkufizuar sipas besimit fetar. Ky sistem u garantonte këtyre grupeve fetare disa të drejta, në mënyrë që t'i rregullonin vetë çështjet e tyre fetare. Nënshetasit çifutë dhe të krishterë quheshin sipas të drejtës islamike *dhimmi* ose *ehl-i*

⁶⁶ Po aty, fq. 7.

⁶⁷ Ortaylı, I. (2015): Paqja Osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 33.

⁶⁸ Çakir, C. (2014): Civilizimi Osman - Politikë•Ekonomi•Art, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 30.

⁶⁹ Ortaylı, I. (2015): Paqja Osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 35-36.

dhimme që do të thotë “të mbrojtur”. Me çështjet dhe konfliktet që preknin si nënshtetasit muslimanë, ashtu edhe ata të krishterë, merrej e drejta islamike *sheriati*. Pësia e taksave për dhimmit-t ka qenë më e madhe se sa për popullsinë muslimane, por nuk kanë patur detyrimin e pjesëmarrjes në fushatat ushtarake.⁷⁰

II.3.2 Miletet

Siç cekëm më lartë, Shteti Osman është administruar përmes sistemit të bashkësive fetare, që nënkupton lirinë e qeverisjes së bashkësive jomuslimane, tolerancë dhe siguri të ithtarëve të librit (*ehl-i kitab*) në shtetin islamik⁷¹. Deri në shekullin e XIX ekzistonin vetëm tre bashkësi fetare të njohura nga osmanët, pra bëhej fjalë për: bashkësinë hebreje, bashkësia apostolike armene dhe ajo apostolike greke. Por, deri më vitin 1914 numri i bashkësive fetare të njohura u rrit në 17, ku bënë pjesë edhe bashkësi konvertitësh nga kishat e ndryshme të lindjes.

Miletet që ishin pjesë e mozaikut shumëkulturore mbroheshin nga shteti në përputhje me mësimet morale islame,⁷² gëzonin të drejta dhe atë kryesisht të drjta familjare dhe personale, si dhe ishin nën sundimin e autoritetit kishtar përkatës. Ata nxirrnin ligje dhe caktonin taksa brenda sferës së kompetencës së tyre. Kushti ishte të ishin besnikë ndaj Perandorisë Osmane. Në rastin kur një pjesëtar i një mileti bënte një vepër kriminale kundrejt një pjesëtari të një mileti tjetër, hynte në fuqi ligji i palës së dëmtuar. Por shumica sunduese islamike ishte gjithmonë eprorë, si pasojë edhe konfliktet ku ishin të përzier muslimanët gjykoheshin me sheriat.

Më vitin 1829 Perandoria Osmane e njohu patriarkatin katolik, por jo duke e përkufizuar si milet tjetër. Patriarku zgjodhi qytetin e Alepos (Siri) si qytet ku do kishte selinë, kurse më vitin 1850 selia u vendos në qytetin Mardin.

II.3.2.1 Mileti musliman (*Ummeti*)

Bashkësitë muslimane përbënin *ummetin*, ku sulltani ishte njëkohësisht edhe në postin e kalifit. Ligjet osmane nuk i njihnin termat si “*përkatësi kombëtarë*” ose “*shtetësi*”, kështu që çdo musliman pavarësisht nga prejardhja etj kombëtare, gëzonte të njëjtat të drejta dhe privilegje. Drejtimet e ndryshme muslimane të besimit, të cilat shiheshin si devijime nga sunizmi, si për shembull shiitë, alevitët dhe jezidët, nuk gëzonin status të veçantë ligjor dhe trajtoheshin në përgjithësi si pjesë e bashkësisë muslimane (*ummetit musliman*). Për t’u theksuar është fakti se vetëm sinkretistët druzë e Durizit dhe të Malësisë së Libanit gëzonin njëfarë pavarësie feudale.

Mileti musliman ishte mileti më i madh në Perandorinë Osmane, i cili përbënte më shumë se gjysmën e popullsisë së kësaj perandorie. Në miletin musliman bënin pjesë të gjithë banorët e Perandorisë që ishin të fesë islame. Me fe islame ishte shumica e popullsisë shqiptare, boshnjake, turke, arabe dhe kurde. Pra, në miletin musliman bënin pjesë njerëz që ishin me kombësi, gjuhë

⁷⁰ https://sq.m.wikipedia.org/wiki/Sistemi_i_Miletit

⁷¹ Jahja, H. (2014): Islami dënon terrorizmin, Alb-Books, Tiranë, fq. 109.

⁷² Po aty, fq. 110.

dhe kulturë të ndryshme. Përkatësia kombëtare ishte shkaku kryesor që të lindin pakënaqësi ndaj dominimit të popullit turk në shumë aspekte.

Në vitin 1856 mileti musliman përbënte 59,91% të popullsisë së përgjithshme të Perandorisë Osmane. Mileti musliman ishte shumicë dërrmuese në pjesën e aziatike dhe afrikane të Perandorisë Osmane, kurse pakicë ishte në pjesën evropiane të Perandorisë (Rumeli). Mileti musliman edhe pse ishte shumicë relative për nga numri, ai gjithmonë ka pasur mirëkuptim dhe tolerancë ndaj mileteve tjera që kanë jetuar në Perandori. Osmanët kanë treguar se duke i trajtuar njerëzit barabartë, ata mund të mbizotëronin dhe të bëheshin ndër popujt më të njohur dhe më të fuqishëm në histori⁷³. Në asnjë periudhë nuk ka munguar respekti, toleranca dhe mirësjellja e muslimanëve ndaj popullsisë jomuslimane. Brenda miletit musliman ka pasur disa sekte fetare me numër të vogël të besimtarëve, që nuk kanë gëzuar ndonjë status të veçantë janë llogaritur si pjesë e miletit musliman.

II.3.2.2 Mileti ortodoks

Që në fillim banorët grekë të Konstandinopojës i kishin të gjithamundësitë të arrinin në pozita të larta në fushën e tregtisë, politikës, fesë dhe ushtrisë. Kështu, Patriarku i qytetit të Konstandinopojës me kalimin e kohës arriti pushtet dhe autoritet të madh fetar dhe politik, por duke qenë gjithmonë nën kontrollin e rreptë të shtetit. Ndër ortodoksët, grekët ishin ata që vendosnin për çdo gjë, megjithëse në miletin ortodoks bënë pjesë edhe bullgarët, serbët, rumunët etj. Fanariotët grekë (siç do quheshin ata më vonë për shkak të selisë së patriarkut në lagjen Fanar/Fener) shërbenin edhe si diplomatë të sulltanit në Evropë dhe si mëkëmbës lokalë të tij në Ballkan. Grekëve që jetonin përgjatë brigjeve të Egjeut iu dhanë privilegje tregtare, poashtu ata formuan edhe flotën luftarake, e cila do të bëhej së shpejti fuqia detare e Perandorisë Osmane. Disa grekë të pasur iu bënë rezistencë bashkatdhetarëve të tyre gjatë luftës së Greqisë për pavarësi në periudhën 1821-1831, ku këtë gjë ata e bënë për shkak të frikës nga humbja e privilegjeve.⁷⁴

Miletin ortodoks në Perandorinë Osmane e kanë përfaqësuar këto institucione fetare krishtere: Kisha Ortodokse Greke me seli në qytetin e Stambollit dhe Kisha Ortodokse Greke me seli në Jerusalem. Besimtarët ortodoksë në Perandorinë Osmane kanë qenë të dytët në numër pas muslimanëve.

II.3.2.3 Mileti armen

Armenët, fillimisht nga shteti osman njiheshin si *bashkësia fetare apostolike armene*. Pjesa më e madhe e popullsisë armene i përkiste besimit ortodoks dhe Kisha Ortodokse Armene ishte institucioni kryesor fetar për pjesën dërrmuese të popullsisë armene, njëherit ishte e pranuar zyrtarisht nga pushteti osman.

⁷³ Merrit, T., "Religious tolerance in the Ottoman Empire", <https://prezi.com/md4-lp-xyd4/success-in-religious-tolerance-for-the-ottoman-empire/>, vizituar më 29.12.2018.

⁷⁴ https://sq.m.wikipedia.org/wiki/Sistemi_i_Miletit

Armenët fenë krishtere e kanë pranuar qysh gjatë shekullit IV kur ishin pjesë e Perandorisë Romake, e më pas edhe pjesë e Bizantit. Edhe kishin pranuar fenë krishtere, politika e Bizantit ndaj armenëve nuk kishte ndryshuar aspak, vazhdoi avazi i vjetër i trajtimit negativ të tyre. Diçka më vonë, raportet mes Bizantit dhe armenëve edhe më shumë ishin keqësuar kur armenët pranuan kishën gregoriane si kishë të tyre. Në kohën kur Konstandinopoja bie në duart e Sulltan Mehmet Fatihut, armenët kanë qenë të organizuar në tre patriarkana: dy Patriarkana Ortodokse Gregoriane me seli në qytetin e Jerusalemit, tjetra me seli në qytetin Eçmijejan, dhe e treta, Patriarkana Katolike Armene me seli në qytetin Sis. Me Kishën Gregoriane Armene kanë qenë edhe: Kisha Siriane, Kisha Etiopiane dhe Kisha Kopte.⁷⁵

Patriarkana Katolike Armene për herë të parë formohet në vitin 1198 në qytetin Sis, dhe e njëjta ka qenë në lidhje të ngushtë me Romën. Pas një kohe në Patriarkanën Katolike Armene tentohet të formohet një qendër dhe të ndahen nga Roma. Në vitin 1441, në qytetin e Eçmijejanit është formuar edhe një entitet nën emrin Patriarkana Katolike Armene, me çka Patriarkana Katolike Armene në qytetin e Sisit bie në plan të dytë.⁷⁶

Pas Marrëveshjes së Paqes së Adrianopojës më vitin 1829, armenët katolikë arritën të sigurojnë garanci për lirinë e fesë dhe njohjen si millet armen i bashkuar e i pavarur nga patriarkati apostolik armen. Deri në vitin 1828, ka vazhduar përndjekja e katolikëve, në mes të dimrit rreth 12.000 armenë katolikë u dëbuan si spiunë frankë nga Stambolli për në Ankara. Më në fund, në vitin 1831 u bashkuan të gjitha konfesionet katolike në Perandorinë Osmane, nën autoritetin e peshkopit të përbashkët (unionist) armen si millet më vete. Me rëndësi është për tu theksuar edhe fakti se, më vitin 1850 zyrtarisht u njohën si komb fetar protestantët armenë.

II.3.2.4 Mileti hebre

Në Perandorinë Osmane, bashkësi fetare e rëndësishme e cila njëherit ishte e pranuar zyrtarisht si millet, ishte edhe ajo hebreje. Ky komunitet i vogël në numër ka qenë në Perandorinë Bizantine, i vogël ka qenë edhe në shekujt e parë të formimit të Perandorisë Osmane. Një numër i madh i hebrenjve vendoset në trojet osmane pas vitit 1492, kur në Spanjë depërtojnë ikuizitorët katolikë.

Hebrenjtë e Perandorisë Osmane nuk ishin grup homogjen, jetonin si pakicë e integruar dhe e toleruar nga popullsia islame në zona të ndryshme socio-kulturore. Ata gëzonin privilegje të ngjashme me fanariotët. Hebrenjtë më të vjetër ishin romaniotët vendas grekofonë. Imigrantët e parë, pra kryesisht ashkenazit erdhën nga Evropa Veriore. Hebrenjtë u rritën në numër si pasojë e imigracionit të sefardëve të ardhur nga Evropa Jugore në fund të shekullit XV, të cilët u vendosën kryesisht në Stamboll, Selanik, Izmir, në rrafshlartën e Anadollisë dhe në Ballkan.

⁷⁵ Несими, Ќ. (2015): Мултирелигиозноста во мултикултурното османлиско општество, Sh.b. Logos-A, Shkup fq. 100-101.

⁷⁶ По аty, fq. 106.

Hebrenjtë e ardhur nga Evropa sollën njohuri shumë të rëndësishme për mjekësinë dhe shtypin. Shtypshkronja e parë osmane filloi me punë në shekullin e XVIII.

Në shekullin e XIX Sistemi i Miletit, i cili ishte formuar në radhë të parë për bashkësitë (komunitetet) greke dhe armene, u zgjerua edhe për bashkësinë (komunitetin) hebre. Deri në fillim të shekullit të XX-të, jehudët bashkë me armenët dhe grekët dominonin në tregëti në të gjithë Perandorinë Osmane. Hebrenjtë ishin të njohur si millet dhe nën urdhërin e autoritetit të hamambashit ose më sakt kryerabinit, i cili ishte i pajisur me privilegje të ngjashme si kreu i kishës greke ose armene.

II.3.3 Sistemi i Miletit

Fjala mil-let në origjinal nënkupton fenë ose bashkësinë e përkufizuar nga feja. Sot, në gjuhën turke shënon kombin⁷⁷. Sistemi i Miletit është një sistem i aplikuar në Perandorinë Osmane në periudhën nga shekulli XV e deri në fillim të shekullit XX. Ky sistem i aplikuar në Lindjen e Afërme dhe në Ballkan për shekujt të tërë, përcaktonte me ligj statusin e pakicave jomuslimane dhe autonominë e bashkësive fetare.

Sistemi i Miletit ka ekzistuar edhe më parë, nuk është shpikje osmane. Romakët i kanë lejuar qytetarët e vet që të ndjekin ligjet e tyre komunale nën juridiksionin e autoriteteve të njohura. Në shekullin V mbretërit sasanidë i kanë trajtuar kristianët si millet dhe iu kanë lejuar bashkjetesën e shumicën zoroastriane. Edhe shtetet islame paraprake të Lindjes së Mesme i kanë trajtuar pakicat jomuslimane, kryesisht të krishterët dhe hebrenjtë, si milete meme të drejta të caktuara për t'i mbrojtur fetë, bashkësitë, vlerat e veta, për zbatimin e legjislacionit të vet të aprovuar nga prijësit fetarë. Osmanlinjtë e kanë modifikuar këtë sistem në drejtime: miletet i kanë zgjedhur prijësit e vet pa ndërhyrje qeveritare, pra kanë qenë apolitikë, kanë vepruar si agjentë të pavarur shtetërore, miletet kanë pasur autonomi të lartë; pos pavarësisë ligjore, të taksave të caktuara, ata kanë pasur të drejtë edhe në arsim, veprimtari afariste dhe në menaxhimin e pronave rezidenciale dhe publike.⁷⁸

Gjatë ekzistencës së saj 600 vjeçare, Perandoria Osmane u zhvillua si një sistem shtetëror shumë-besimesh, ku Sistemi i Miletit përbënte kornizën ligjore të statusit të secilës bashkësi të veçantë fetare dhe të të gjithë jomuslimanëve në bazë të së drejtës islamike. Domethënë miletet ishin formuar në bazë të feve jo sipas aspektit kombëtar (etnik). Nëpërmjet Sistemit të Miletit, Perandoria Osmane u riorganizua duke i vendosur grupet kombëtare në tolerancë përkrah njëri-tjetrit. Sistemi i Miletit u garantonte krishterëve dhe hebrenjve të drejta të caktuara, nga ana tjetër anëtarëve të këtyre bashkësive fetare ua ndalonte mbajtjen e armëve. Pjesëtarët e mileteve jomuslimane kishin për obligim të paguanin të ashtuquajturën “taksë për frymë”.

⁷⁷ Braude, B. (2014): Christians and Jews in the Ottoman Empire, Lynne Rienner Publishers, fq. 15.

⁷⁸ Po aty.

Nga fillimi i shekullit XIX, Perandoria Osmane ishte tashmë vetëm hija e vetvetes. Trazirat e brendshme politike dhe sociale, disfatat ushtarake dhe ndikimi gjithnjë e më i madh nga ana e fuqive të mëdha evropiane, e kishin keqësuar shumë gjendjen e jetës sociale të banorëve të Perandorisë Osmane. Fuqia në rritje e të ashtuquajturës botë krishtere dhe idetë e Revolucionit Francez, shkaktuan tek nënshtetasit e krishterë të Perandorisë Osmane valë pakënaqësish. Fshatarët jomuslimanë si hallka më e dobët e hierarkisë sociale, kishin vetëm dy mundësi: ose të shpërnguleheshin në qytete të sigurta ose t'u luteshin fuqive evropiane për mbrojtje ushtarake.⁷⁹

Perceptimi i Sistemit të Miletit nga ana fetare evoluoi për njerëzit në një identitet të ndjerë si pakicë kulturore, pikëpamje kjo që përputhej me idetë e politikanëve evropianë. Fryma politike e kohës ishte përqendruar tek dhënia e të drejtave të veçanta për pakicat jomuslimane të Shtetit Osman që në qarqet e atëhershme perëndimore dhe të brendshme joislame cilësoheshin si të shtypura.

Jomuslimanët që ishin pjesë e qeverisjes së shtetit, ndonëse e dinin fort mirë kulturën islame, nga shekulli XVIII nisën të interesoheshin për kulturën dhe letërsinë perëndimore dhe për pasojë, me kalimin e kohës ndikimi i Perëndimit filloi që të duket mbi popullatë e krishterë të Perandorisë. Ata deri në shekullin XVII e preferonin shtetin osman, kurse më pas filluan t'i preferojnë qeverisjet e huaja.⁸⁰

Qeveria osmane përpiqej t'i kundërvihej rrezikut të separatizmit kombëtar me anë të reformimit të Sistemit të Miletit përmes shfuqizimit të klerit të mileteve. Në kuadër të reformave të Tanzimatit, qeveria osmane vendosi me dekret në formën e Hatt-i Humajun-it (dorëshkrimi perandorak) të 18 shkurtit 1856 barazinë e të gjithë nënshtetasve të Perandorisë Osmane dhe garantimin e privilegjeve dhe imuniteteve kishtarë, gjë që jo vetëm i vendoste jomuslimanët në një shkallë të barabartë, por kjo formoi edhe një pozitë të privilegjuar që sa erdhi e u zgjerua si pasojë e ndikimit në rritje të shteteve të fuqishme evropiane. Fuqive evropiane, në radhë të parë Anglisë dhe Francës nuk iu interesonte vetëm mbrojtja e të krishterëve në Perandorinë Osmane. Përmes realizmit politik përpiqeshin të ndalnin ekspansionin e Rusisë drejt jugut, qëllim ky që mund ta arrinin vetëm duke penguar çintegrimin e Perandorisë Osmane. Kështu, ato e përkrahën politikën e reformave sepse kjo ishte sipas tyre një strategji që sillte stabilitet.

Për qeverinë osmane Reforma e Miletit ishte kontraproduktiv pasi që favorizoi fuqizimin e borgjezisë në pikëpamje kombëtare brenda bashkësive të nënshtetasve të krishterë. Ky zhvillim u dha shtytje luftërave për pavarësi në Ballkan, duke përforcuar dëshirën për të dalë nga konfederata osmane. Nga ana tjetër kjo çoi edhe në kryngritjen e jomuslimanëve të qyteteve në ekonomi dhe administratë. Ndërsa popullsia muslimane e ndjente këtë zhvillim tashmë si rebelim kundër Perandorisë Osmane dhe fesë islame.

⁷⁹ Po aty.

⁸⁰ Kurtaran U. (2011). "Osmanli İmparatorluğu'nda Millet Sistemi", Journal of the Institute of Social Sciences 8-2011, fq. 57-71

Një ndër pengesat më të mëdha të reformave ishin njohuritë e varfëra të qeverisë osmane mbi shumicën e provincave të Perandorisë. Për shumë rajone nuk ekzistonin as harta gjeografike. Koncepti i shtetit kombëtar kushtëzohej në parim nga barazia e të gjithë shtetasve. Por, elita turke nuk kishte hequr kurrë dorë nga pretendimi se “bashkësia sunduese” përcaktohej përmes përkatësisë në fenë islame. Kjo tendencë u zgjerua nëpërmjet lindjes së turanizmit në fund të shekullit të XIX.

Pas rënies së Perandorisë Osmane, republika e re laike (jo fetare) i dha fund Sistemit të Miletit. Më vonë, nën pushtetin e Turqve të Rinj (Xhonturqve) dhe në Republikën e Turqisë filluan të mos pranohen pakicat kombëtare. Që prej rënies së Perandorisë Osmane, Republika e Turqisë shfaq një mosbesim të thellë ndaj pakicave kombëtare, pasi ajo nuk beson më në lojalitetin e tyre. Perandoria Osmane ishte një shtet musliman, njëherit ishte Perandoria e fundit islame.

Siç shprehet edhe profesor Halil İnalcık, jomuslimanët kaluan katër periudha apo katër faza të ndryshme nën administratën osmane. Në periudhën e fitoreve të para, propaganda e bërë ndikoi shumë dhe pas çlirimit, duke iu dhënë privilegje zejtarëve nga fshati dhe qyteti, klerikëve dhe pronarëve të tokës, u zbatuan rregullat dhe u njohën institucionet juridike të paraçlirimit, u shfuqizua rendi i vjetër nëse kishte kushte të rënda, si dhe u pranuan në hierarkinë ushtarake grupet e vjetra drejtuese dhe pronarët e tokave, ku në veçanti dallohej shtresa e ulët e hierarkisë dhe ata që kishin të drejtë për të bërë aleanca. Edhe pas çlirimit, ky status vazhdoi kështu, meqenëse nuk ekzistonin shkaqe që të detyronin ndryshimin e statusit.⁸¹

Sistemi i Miletit nuk bazohet në parimin e një klasifikimi social. Brenda çdo grupi të milletit kishte njerëz të privilegjuar të shoqërisë osmane. Në përgjithësi, në çdo grup të milletit kishte një kategori të klasifikuar si kategori ushtarake dhe të përjashtuar nga disa apo nga të gjitha taksat e caktuara kundrejt shërbimit që ofronte. Si shembull mund të theksohet ai i ushtarëve të krishterë që quheshin *martolos*, ushtarët bullgarë që ishin me statusin e *spahiut*, mitropolitin grek, priftin armenas, bejlerët greko-ortodoksë të Fenerit, nëpunësit armenas, rabinin apo kryerabinin, ashtu si edhe myderrisin musliman. Jashtë klasës ushtarake, në grupin e gjerë që paguajnë taksa, që punojnë pa pagesë dhe që nuk mbajnë armë, të cilët quheshin si *reja*, në të cilën shtresë bënin pjesë muslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë, midis të cilëve kishte ndryshim në përgjegjësitë e tyre, siç është mospagimi i xhizjes nga ana e muslimanëve dhe pagimi i kësaj takse nga ana e të tjerëve.⁸²

Të gjithë armenasit nuk u organizuan si mileti armenas, por u organizuan në tre milete si armenë gregorianë, katolikë dhe protestantë, ku këta të fundit u organizuan në shekullin e XIX. Gjatë një periudhe të caktuar, bashkësia *surjanite* konsiderohej së bashku me bashkësinë armenase. Ndërsa mileti hebre pjesërisht ishte së bashku me hebrenjtë e sektit *Karai*. Në fermanët dhe në veprime administrative, mileti hebre përmendet me kryerabinin dhe kryetarin e

⁸¹ Ortaylı, I. (2014): Familja në shoqërinë osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 23-24.

⁸² Po aty, fq. 24-25.

sektit *Karai*. Ndarja e këtyre dy bashkësive (komuniteteve) hebreje është vënë re më tepër nga këndvështrimi i çështjeve financiare dhe administrative.⁸³

Bullgarët, serbët, shqiptarët ortodoksë dhe arabët ortodoksë, së bashku me grekët, ishin nën kontrollin dhe administrimin shpirtëror, financiar, administrativ, juridik dhe censurues të Patriarkanës Greko-Ortodokse të Fenerit. Patriarkana Greko-Ortodokse u vendos në lagjen Fener në fund të shekullit XVI. Grupet kombëtare që ishin të konfesionit ortodoksë, ishin në përplasje më shumë me ndikimin e elementit grek dhe me Patriarkanat Greko-Ortodokse se sa me Portën e Lartë gjatë periudhës së lëvizjeve nacionaliste që u zhvilluan gjatë shekullit XIX. Këto përplasje ndërmjet grupeve kombëtare të tjera me atë greke kanë lënë gjurmë të thella në historinë e bashkësive kombëtare. Vetë shkaku i themelimit të Kishës Ortodokse në Maqedoni dhe Bullgari ka qenë si pasojë e pranisë së ndjenjave nacionaliste ngase Patriarkana e Stambollit nuk i lejonte këta elementë që të përdorin gjuhën e vet në ritet fetare dhe në shkollat e tyre, si dhe klerikët e tyre me grada të larta i caktonte prej bashkësisë kombëtare greke. Që nga ajo kohë e deri më sot një situatë e tillë formoi pakënaqësi tek arabët ortodoksë dhe njëherit rriti prirjen dhe aktivitetin e tyre për të kaluar në Kishën Greko-Katolike të quajtur *Melkite*. Kisha Ortodokse që përmendet me veçantinë e të qenurit ekumenike dhe që arriti fuqinë e saj në periudhën osmane, u dobësua me shpëputjen e kishave serbe, vllehe, bullgare dhe greke si kisha autoqefale.⁸⁴

Që shumë kohë më parë, në Stamboll, Izmir dhe Selanik jetonin tregtarë dhe zejtarë italianë. Gjatë periudhës osmane këta ishin vendosur edhe në qytetet Sidon, Tripoli dhe Halep. Në shekujt XVIII dhe XIX, këtu emigruan njerëz të ndryshëm nga Italia dhe vendet e tjera të Evropës Perëndimore, të cilët kishin emigruar për një jetë më të mirë. Këto grupe që i përkisnin Kishës Katolike konsideroheshin si një millet latin, mirëpo, këta nuk e kishin statusin e milletit. Meqenëse drejtuesit e tyre fetar ishin qytetarë të huaj, ata nuk mund të bëheshin kryetar të bashkësisë (komunitetit).⁸⁵

Është e njohur urrejtja që ekzistonte midis hebrenjve dhe të krishterëve, veçanërisht midis greko-ortodoksëve dhe hebrenjve. Në shekullin e XIX, Porta e Lartë u detyrua t'i mbronte hebrenjtë nga sulmet e grekëve ortodoksë dhe ndërhyri për t'i ndaluar trazirat. Urrejtje ekzistonte edhe në mes milletit hebre dhe atij ermen.

Brenda sistemit osman ekzistonin dy grupe fetare situata e të cilave ishte ndryshe nga ajo e grupeve të tjera. Pra, këto dy grupe fetare ishin druzët dhe jeziditët. Dijetarët muslimanë nuk ishin në gjendje t'i përfshinin këto dy grupe brenda popujve të fesë islame. Muslimanët nuk i kanë parë këta dy grupe si anëtarë të bashkësisë (komunitetit) së tyre. Poashtu, ishte e pamundur që këto dy grupe të cilësoheshin si gupe *mileti*. Në disa dokumente është e mundur që të shihet qëndrimi zyrtar i pushtetit osman, i cili nuk i konsideronte jezidët brenda fesë islame. E njohur

⁸³ Po aty, fq. 25-26.

⁸⁴ Po aty, fq. 26-27.

⁸⁵ Po aty, fq. 27.

është se druzët u organizuan midis tyre dhe i kontaktonin si bashkësi (komunitet) më vete. Nga ana juridike, dihet se druzët mjaft mirë përshtaten me fikhun sunit të medhhebit hanefi.

S'ka dyshim se Sistemi i Miletit nuk ka pasur të njëjtën strukturë përgjatë gjashtë shekujve të tij. Veçanërisht pas Tanzimatit, me anë të kërkesës për të përfshirë edhe elementë laikë në administrimin e bashkësisë (komunitetit), dalëngadalë çdo bashkësi (komunitet) ka nxjerrë rregullore dhe ka kaluar në fazën e formimit të asambleve të *miletit* në të njëjtën linjë me institucionin e patriarkut dhe rregullave fetare.⁸⁶

Gjatë gjithë periudhës së ekzistimit të Perandorisë Osmane, Sistemi i Miletit ka mbrojtur identitetet fetare të grupeve që banonin të shpërndarë dhe që ndonjëherë nuk kishin të njëjtën gjuhë, po aq sa edhe të atyre që jetonin në një zonë gjeografike të caktuar. Disa bullgarë dhe shqiptarë të krishterë që ishin greqizuar, në të njëjtën mënyrë edhe të krishterët ortodoksë me origjinë turke dhe që flisnin turqisht, të cilët janë quajtur *karamanët* e Anadollisë, ishin të detyruar ta mbyllin historinë e tyre duke qenë të greqizuar. Ky grup kishte një jetesë të ngjashme me popullsinë muslimane të Anadollit, edhe nga ana gjuhësore dhe nga ana kulturore. Me shkëmbimin e popullsisë, ata nuk u përshtatën për një kohë të gjatë në atdheun e tyre të ri. Në të njëjtën mënyrë, edhe disa grupe kombëtare që ishin të fesë islame, ndonëse kishin ndryshime gjuhësore, e pranuan identitetin turk apo iu bashkuan atij, siç ishte rasti me pomakët.⁸⁷

Sistemi i Miletit nuk mund të jetë bazë e nacionalizmit të tipit perëndimor evropian. Nacionalizmi i tipit perëndimor ka mundur të shfaqet duke u konfrontuar me këtë sistem dhe duke e shfarosur atë. Mospërputhja nga ana gjuhësore pasqyron edhe mospërputhjen nga ana historike. Megjithatë, përvoja historike tregon se Sistemi i Miletit ka ndihmuar për formimin e një identiteti të ri integrues edhe gjatë formimit të nacionalizmit të ri, veçanërisht midis popujve muslimanë.⁸⁸

Sistemi i Miletit është një dukuri e veçantë në histori. Është e kundërta e “shoqërisë persekutuese” (*persecuting society*) të Perëndimit mesjetar⁸⁹. Ky është një organizim origjinal kulturor, social dhe administrativ i shoqërisë osmane. Ai nuk mund të krahasohet as me gjendjen e pakicave në perandoritë kolonialiste dhe as me strukturat federaliste. Edhe gjendja e popujve me fe dhe gjuhë të ndryshme në Ballkan dhe në vendet e Lindjes së Afërme me trashëgimi osmane, nuk ka lidhje me statusin e pakicave në shoqëritë bashkëkohore.

Çështja e pakicave kombëtare në Ballkan është një lëmsh që ka mbetur ende pa zgjidhur. Në vendet e Lindjes së Afërme nuk ekziston një bashkim midis grupeve që u përkasin feve dhe sekteve të ndryshme, por që flasin të njëjtën gjuhë. Herë pas here, baraspeshat e atjeshme prishen nga zhvillimet politike. Si shembull mund të përmendet konflikti midis muslimanëve dhe koptëve (të krishterë-ortodoksë) në Egjipt. Pastaj, si shembull tjetër ku prishen baraspeshat midis

⁸⁶ Po aty, fq. 30.

⁸⁷ Po aty, fq. 32-33.

⁸⁸ Po aty, fq. 33.

⁸⁹ Barkey, K. (2008). *Empire of Difference: The Ottomans in Comparative Perspective*, Cambridge University Press.

grupeve fetare dhe sektare mund të përmendet konflikti sektar që ndodh midis nusarijve dhe sunitëve në Siri, si dhe tensionet dhe konfliktet midis grupeve të ndryshme fetare dhe sektare në Liban. Libani ka qenë dhe vazhdon të jetë një vend i dallimeve të mëdha fetare, pasi që atje kemi numër të madh të sunitëve, shiitëve dhe të krishterëve-ortodoksë, si dhe pakicës druze. Mirëpo, edhe përkaj dallimeve të thella mes grupeve të ndryshme fetare dhe sektare, përsëri është arritur të ruhet hamonia, paqja dhe bashkëjetesa mes bashkësive. Me shekuj të tërë janë shmangur konfliktet ndëretnike dhe ndërfetare, kjo për shkak të thelbit të burimeve fetare dhe lidërshpit të shndëoshë.

Njëherë Sulltan Mahmudi II (ka qeverisur mes 1808-1839) ka pohuar: “Myslimanët i dalloj vetëm në xhami, krishterët në kishë, hebrenjtë në sinagogë. Përndryshe të gjithë janë djemt dhe vajzat e mia!”⁹⁰.

⁹⁰ Po aty, fq. 183.

KAPITULLI III

SISTEMI I MILETIT DHE REFLEKSIONET E TIJ NË SHEKULLIN XXI

III.1 SHOQËRIA MODERNE E SHEKULLIT XXI DHE REFLEKSIONI I SISTEMIT TË MILETIT NË TË

III.1.1 Kuptimi për shoqërinë

Një shoqëri është një grup individësh të përfshirë në një bashkëveprim të vazhdueshëm shoqëror ose një grup i madh shoqëror që ndan të njëjtin territor gjeografik, social dhe kulturor. Si zakonisht shoqëritë karakterizohen nga modelet e marrëdhënieve midis individëve që ndajnë një kulturë, institucione dhe vlera të veçanta.

Termi “*shoqëri*” rrjedh nga fjala latine *societas*, e që kjo e fundit rrjedh nga emri *socius* që do të thotë shokë ose aleatë, që përdoret për të përshkruar një lidhje ose bashkëveprim mes palëve që janë miqësore, ose të paktën civilë. Pa një artikull, termi mund t’i referohet tërësisë së njerëzimit. Edhe pse ata që nuk janë miqësorë ose të pakujdesshëm me pjesën tjetër të shoqërisë në këtë kuptim mund të konsiderohen të jetë “antisocialë”.

Sipas sociologut Pajaziti “shoqëria është grup njerëzish të lidhur me njëri-tjetrin përmes traditave, institucioneve, kulturës ose së paku përmes territorit të përbashkët. Grup individësh të unifikuar nëpërmjet marrëdhënieve normative të veçanta dhe sistematike; strukturë ose organizim shoqëror i formuar nga individët dhe grupet shoqërore dinamike, të cilat mbizotëron dinamizmi profesional, e për shkak të individualizmit të skajshëm nuk janë homogjene. Shoqëria përbën një rrjet të marrëdhënieve, ku për bazë merret e drejta e shkruar, formalizmi, normativizmi, ku individët nisen nga “unë”-ndjenja dhe veprojnë në mënyrë të vullnetshme dhe racionale. Në këtë lloj të organizimit shoqëror vërehen forma të ndryshme të pjesëmarrjes politike dhe shoqërore. Shoqëria mund të konsiderohet grupi më i madh shoqëror. Sipas Durkheimit, në këtë strukturë, në të cilën njerëzit sillen duke e marrë për epiqendër unin e vet, mbisundon solidariteti organik. Në këtë formacion, individët veçohen funksionalisht, sferat e ndryshme të veprimit, shoqatat e ndryshme profesionale e sigurojnë funksionimin dhe vazhdimësinë e jetës. Në shoqëri dallimet statusore dhe shtresimi social janë më të shprehura në krahasim me bashkësinë (*community*).”⁹¹

Ekonomisti skocez Adam Smith pohon se një shoqëri mund të jetojë edhe përkundër pjesëtarëve të saj me dallime vetëm nëse ata refuzojnë ta lëndojnë njëri-tjetrin. Bashkësia është grupim i ndërvarësisë funksionale, i njerëzve me karakteristika të përbashkëta si identiteti kombëtar ose kulturor, solidariteti social, gjuha ose struktura hierarkike.

Grupet e ndryshme mund të dallojnë për nga qasja në avantazhe të tilla si resurset, prestigji apo pushteti. Kjo gjë ndërlidhet me shtresëzimin shoqëror. Sociologët bëjnë një tipologji treshe lidhur me zhvillimin e shoqërive: *paraindustriale* (gjuetia dhe grumbullimi i bimëve, baritore, hortikulturore, bujqësore dhe feudale), *industriale* (kalimi nga prodhimi manifaktural

⁹¹ Pajaziti, A. (2009). Fjalor i sociologjisë, Sh.b. Logos-A, Shkup.

në atë industrial, mallra për çdokënd, shpërngulja e popullsisë fshat-qytet) dhe *post-industriale* (informacioni, shërbimet dhe teknologjia e lartë, sektorin e shërbimeve) vendosin shoqëritë në tre kategori: *paraindustriale*, *industriale* dhe *post-industriale*. Në ditët e sotme flitet për shoqërinë e informacionit që është një koncept pasmodern dhe futurologjik sipas të cilit faktor qenësor i zhvillimit shoqëror është shfrytëzimi i informacioneve shkencore-teknike dhe të tjera, në kuadër të të ashtuquajturit “sektor i katërt” të ekonomisë.

III.1.2 Shoqëria moderne

Shoqëria moderne nuk është rrjedhojë e një zhvillimi stihik dhe të rastit, por ngërthen në vete një histori njëzet e një shekullore. Shoqëria moderne paraqet sistem social specifik.

Sipas Bell, në shoqërinë perëndimore, sistemi dominues ka qenë prona, e garantuar dhe e mbrojtur me ligj, si e dhënë përmes sistemit të martesës dhe familjes. Në shoqërinë amerikane sot, janë tri mënyra të pushtetit dhe mobilitetit social, si: mënyra historike e pronës si bazë e pasurisë dhe pushtetit, aftësitë teknike si bazë e pushtetit dhe pozitës, zyra politike si një bazë e pushtetit. Ndërsa, vështirësia në analizimin e pushtetit në shoqërinë e sotme moderne është se këto tre sisteme bashkë ekzistojnë, përkrijnë dhe mbushin njëri-tjetrin.⁹²

Nëse i kthehemi strukturës sociale në shoqërinë moderne duke i marrë në konsideratë klasën dhe pushtetin, arrijmë në dy përfundime:

- Klasa më e madhe që del në shesh në shoqërinë e re është kryesisht një klasë profesionale;
- Sistemi kontrollues i shoqërisë nuk është i vendosur në një klasë pasuese-profesionale, por në rendin politik, dhe pyetja se kush e drejton rendin politik është një pyetje e hapur.⁹³

Se moderniteti i ka sjellë begati njerëzimit, kjo nuk ka mëdyshje. Në kohën moderne ndodhi revolucioni industrialo-teknologjik, duke ndikuar që të përhapet shkrim-leximi në të gjitha hapësirat e banuara, edhe në hapësirat më rurale më të skajshme të shoqërisë. Falë modernitetit u lindën shtet-kombet me veçoritë që i njohim sot. Moderniteti solli ide të reja politike si liria, barazia, të drejtat e njeriut, laiciteti, pluralizmi politik, diversiteti kulturor etj. Këto ide, e transformuan rrënjësisht botëkuptimin dhe qasjen se mbi cilat parime duhet të ndërtohet shoqëria e re. Epoka e errët e doktrinave të absolutizmit fetar-krishterë u fundos, duke i lënë vend periudhës së njeriut të lirë dhe racional. Mes pushtetit material (perandorak) dhe pushtetit shpirtëror (autoritetit fetar) lindi pushteti i tretë e që është individualiteti.⁹⁴

Sipas Dejvid Bruks ekzistojnë katër forca të mëdha që e përshkojnë shoqërinë moderne. Migrimi global po shkakton diversitet demografik. Globalizimi ekonomik po formon shanse më

⁹² www.mapo.al/shoqeria-post-industriale-dhe-e-ardhmja-e-saj/

⁹³ Po aty.

⁹⁴ <https://sbunker.net/op-ed/82780/mbi-semundjet-e-shoqerise-moderne/>

të mëdha për ngritje në planin ekonomik, por edhe pabarazi të shumta. Interneti po u jep njerëzve më shumë zgjedhje për gjërat që duhet t'i blejnë, t'i përdorin dhe t'u kushtojnë vëmendje. Një kulturë e pavarur i jep vlerë zgjedhjeve individuale dhe vetëvendosjes. Të gjitha këto forca e kanë çliruar individin, ose të paktën individët e mirë arsimuar. Pabarazia e të ardhurave sfidon kohezionin ekonomik, teksa klasat apo shtresat ndahen e largohen nga njëra-tjetra. Diversiteti demografik sfidon kohezionin kulturor, teksa grupe të ndryshme kombëtare e fetare shkaktojnë fërkime mes grupimeve të ndryshme siç ndodh kohëve të fundit mes vendasve dhe migrantëve nga Lindja, Bota e Tretë etj. Vënia e theksit tek zgjedhja individuale, gjegjësisht individualizimi i skajshëm sfidon kohezionin e bashkësisë, lidhjet e formuara sociale dhe stabilitetin në përgjithësi.⁹⁵

Dobësimi i strukturës sociale ka gjeneruar një sërë problemesh. Të rinj të izoluar qëllojnë me armë në shkolla. Shumë njerëz rriten në lagje të fragmentuara e të dezorganizuara. Polarizimi politik rritet, sepse njerëzit shpeshherë nuk ndërveprojnë me ata që janë në anën tjetër. Armiqësia kombëtare, racore e fetare nuk ndalen dhe si pasojë shkattohen konflikte tmerruese.

Që është edhe më e çuditshme, njerëzit i ka pllakosur një ndjesi pafuqie, një humbje efikasiteti. Çlirimi i individit duhej të kishte sjellë fuqizimin në masë. Por me sa duket, njerëzit mund të ndjekin objektivat e tyre, vetëm atëherë kur e dinë se cilët janë, pra kur kanë identitete të forta. Nëse heq strukturën e pasur sociale, ajo që mbetet janë njerëz të pasigurtë për atë që janë në të vërtetë. Është e vështirë të jetosh guximshëm dhe lirshëm, kur vetë themeli yt është i paqëndrueshëm dhe në rrezik.

Në librin e saj të ri “Komonuelthi dhe Marrëveshja”, Marsia Pelli (Marcia Pally) që punon në Universitetin e Nju Jorkut, ofron një koncept kthjellues. Ajo që ne duam, sugjeron ajo, është “ndashmëria mes konteksteve”. Ne duam që të shkojmë, zbulojmë dhe eksperimentojmë përmes mënyrave të reja të të menduarit dhe të jetuarit. Por ne duam gjithashtu të jemi në një kontekst, të përfshirë në familje që na duan dhe bashkësive që ju përkasim, të lulëzojmë në brendësi të një infrastrukture sociale të shëndetshme që na i siguron vlerat dhe objektivat.⁹⁶

Gjatë një tjetër periudhe të fragmentimit kombëtar, Abraham Linkoln lartësoi një dashuri të rigjetur për kombin. Ai luajti me kordat mistike të kujtesës dhe përdori Deklaratën e Pavarësisë si një shkrim dhe udhërrëfyes bashkues. Këto ditë, struktura sociale do të riparohet prej qindra miliona njerëzve që bëjnë marrëveshje lokale, duke zgjeruar rrathët e tyre të eliminimit të ndarjeve sociale dhe racore. Por, ndoshta do të kërkojë që udhëheqësit t'i kthehen historisë për të ringjallur patriotizmin.⁹⁷

Sot më nuk ekziston kurrfarë hamendjeje lidhur me dinamikën e zhvillimit dhe ndryshimit të shoqërisë, sepse të gjithë njëzëri pajtohem për shpejtësinë e rrufeshme të tyre.

⁹⁵ www.bota.al/2016/04/kater-forcat-e-shoqerise-moderne-dhe-si-ta-ribejme-strukturen-tone-sociale/

⁹⁶ Po aty.

⁹⁷ Po aty.

Kështu, ajo që deri para disa ditësh paraqiste shpikje marramendëse e teknologjisë, pas një muaji konsiderohet si inovacion i vjetëruar dhe i demoduar. Të gjitha ndryshimet dinamike që kanë ndodhur dhe po ndodhin, i kanë detyruar shkencëtarët që shoqëritë moderne t'i pagëzojnë me emërtime të ndryshme. Për Turenin dhe Rihten këto shoqëri bashkëkohore quhen *shoqëri pasindustriale*, për Bzhezhinskin *shoqëri teknokratike*, për Dahrendorfin dhe Halmosin *shoqëri e shërbimeve*, për Kanin dhe Vinerin *shoqëri pasekonomike*, për Ecionin *shoqëri pasmoderne*, për Zhak Elujin *shoqëri teknologjike*, për Xhon Nejsbitin *shoqëri informatike*, për Drakerin *shoqëri e diturisë* etj. Mirëpo, nëse i analizojmë pak më thellë këto përcaktime për shoqëritë bashkëkohore, do të shohim se ato emërtime flasin për arritjet e njerëzve, synimet e tyre, për preokupimet, por edhe për obsesionet, presionet dhe streset e mëdha.⁹⁸

Në kohën e këtyre ndryshimeve radikale, njeriu i thjeshtë gjithnjë e më tepër merr pjesë aktive në ndërrimin e politikës globale, me ç'rast nga objekti politik shndërrohet në subjekt politik. Kjo kohë e ndryshimeve të mëdha dhe të shpejta, në fakt shkon në favor të mbarë njerëzimit. Për herë të parë në historinë e shoqërisë njerëzore vërehen dy tendenca jetike për njeriun: në njërin anë është zgjerimi i kohës së lirë, ndërkaj në anën tjetër zvogëlimi i kohës së punës.⁹⁹

Edhe pse jetojmë në këtë botë bashkëkohore apo moderne, prapë gjithnjë shtrohet pyetja se sa e kuptojmë vetveten, pra sa e kuptojmë njeriun në botën e ndryshimeve të shpejta, të mëdha, të thella, krizave, kundërrthënive, botë sa unike aq më shumë edhe botë e ndasive? Sa dhe si ta kuptojmë këtë botë të ndryshimeve të mëdha shoqërore, psikologjike, morale, fetare etj.?! Gjithsesi, për ta kuptuar sa më mirë këtë botë, është e domosdoshme që në radhë të parë ta kuptojmë njeriun në të, mirëpo, për ta kuptuar sa më mirë njeriun bashkëkohorë apo modern, duhet të arrijmë t'i kuptojmë tiparet e botës së sotme. Zhvillimi dhe përparimi apo të arriturat shkencore-teknologjike të njeriut domosdo reflektohen edhe në përjetimin e brendshëm të tij, në njohuritë dhe sjelljen e tij, si dhe patjetër ndikojnë edhe në legjitimitetin shoqëror.¹⁰⁰

Kur flitet për ndryshimet shoqërore, në veçanti theksohet tkurrja e madhe e formave apo formacioneve të bashkësive tradicionale dhe atyre të mëhershme sociologjike. Elementet rurale gjithnjë e më shumë zbehen apo zhduken, kurse dominojnë ato urbane, kështu që thuajse çdo fshat disi bëhet qytezë e vogël, sin ë formimin e saj, ashtu edhe sipas banorëve që ka. Jeta e njerëzve gjithnjë po ndryshon në varësi të ndryshimeve që ndodhin në lëmi të ndryshme të jetës.

Idetë fillestare të modernitetit po rrugëtojnë në një kahje të gabuar. Liria individuale duhet të jetë e shenjtë, por gjithmonë në harmoni të plotë me të mirën e përbashkët. Njeriu nuk mund të jetë i lirë, nëse jeton brenda vetë qelisë individuale të tij. Pa kujdesin për mjedisin dhe shoqërinë ku jetojmë, edhe vetë koncepti i lirisë individuale, si i tillë është jo i plotë.

⁹⁸ Raimi, S. (2009): *Sociologjia*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, fq. 257.

⁹⁹ Po aty, fq. 258.

¹⁰⁰ Sopi, M. S. (2018) "Njeriu në botën bashkëkohore dhe tiparet e saj", *Bota sot*.

III.1.3 Refleksioni i Sistemit të Miletit në shoqërinë moderne

Bota në të cilën jetojmë po pëson një ndryshim epokal. Jemi dëshmitarë të një procesi planetar i cili mund të cilësohet si revolucion teknologjiko-informativ, i cili formon ekonomi dhe sistem botëror. Në një botë të tillë, përmes procesit të ndërvarësisë globale dhe fragmentarizimit subnacional, po duket se po ndryshojnë njohuritë tona për botën, duke filluar nga humbja e sovranitetit kombëtar dhe deri te formimi i strukturave ndërkombëtare politike, ekonomike, kulturore apo të tjera. Në çdo aspekt të procesit të përmendur, shteti humb pjesë të mirë nga sovraniteti i vet.¹⁰¹

Teoria dhe praktika deri më tani shumë ngadalë po i përshtaten globalizimit të përshpejtuar. Personalitete të shquara të shkencës dhe politikës të përballur me atë që po sjell globalizimi, po mundohen me shumë ngulm dhe kokëfortësi, dhe me çdo çmim të ruajnë paradigmen dominante në politikën perëndimore, pra të ruajnë idenë për shtet të centralizuar territorialisht. Frika nga humbja e statuseve dhe privilegjeve të fituara, i largon njerëzit nga kërkimi i zgjidhjeve tjera.¹⁰²

Ekziston model i stabilizimit politik përmes pavarësisë shoqërore. Kjo është një zgjidhje tradicionale, e cila i kundërvihet centralizimit shtetëror. Për shkak se hapësira nuk na mundëson sqarim të detajuar të këtij modeli, duhet të përmendet se në vend dikur ka ndodhur një gjë e ngjashme. Bëhet fjalë për një veçori të Perandorisë Osmane e cila njihet si “Sistemi i Miletit” i Portës së Lartë. Në vazhdim do t’i shpalosim disa veçori të sistemit në fjalë dhe do t’i shqyrtojmë refleksionet e tij në shoqëritë e sotme-moderne.

Shoqëritë në Evropën Juglindore janë multietnike. Multietniciteti është si rezultat i periudhës së gjatë të ekzistimit të perandorive të ndryshme në këtë hapësirë të Evropës. Kështu, për shembull, Maqedonia Antike ka ekzistuar me shekuj, Bizanti këtu ka ekzistuar për 1000 vjet, Perandoria Osmane ka ekzistuar për një periudhë prej 500 viteve. Në kuadër të perandorive kanë jetuar së bashku popuj me kombësi, fe dhe gjuhë të ndryshme. Perandoritë multietnike kanë qenë të detyruara të ndërtojnë mekanizma të ndërlikuar joterritoriale, të cilët i kanë rregulluar raportet e ndërlikuara kombëtare, fetare dhe gjuhësore.¹⁰³

Nga elitat intelektuale në Ballkan, nuk ka pasur interes për hulumtim të modeleve të tilla specifike që kanë të bëjnë fitimin e të drejtave kolektive dhe personale. Veçanërisht kjo ka të bëjë me të ashtuquajturin “Sistem i Miletit” në Perandorinë Osmane, i cili në parim ka ndaluar ndarjet e brendshme territoriale dhe nga ana tjetër ka mundësuar që në paqe dhe harmoni të jetojnë popujt me kombësi, fe dhe gjuhë të ndryshme. Me këtë mënyrë të hulumtimit, nëse jo më shumë, do të mund të kuptohet thelbi i multikulturalizmit dhe i mënyrës së formimit të kombeve

¹⁰¹ Иванов, Ѓ. (2004): “Милетскиот систем – модел на религиозна толеранција”, *Политичка мисла*, Институт за демократија, солидарност и цивилно општество, Скопје, fq. 69.

¹⁰² По аты.

¹⁰³ По аты, fq. 70.

dhe shtet-kombeve në hapësirën e Ballkanit, si dhe njohja e problemeve që edhe tani po i shkaktojnë.

Duke filluar nga shekulli i XIX, përparimi teknologjik dhe ekspansioni i fuqive evropiane ndikoi që në hapësirën e Ballkanit të paraqiten idetë etnocentriste dhe nacionaliste. Fillon të forcohet interesimi dhe dëshira për shtete kombëtare por me tipare të perëndimore, ku territori luan rol mjaft të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit kombëtar. Një gjë e tillë ndikon në paraqitjen tendencave që çojnë drejt një homogjenizimi kulturor-politik dhe atëherë mbretëritë shpërbëhen, por njëherit fillojnë edhe konflikte, luftëra dhe vuajtje, dëbim i popullsisë, gjenocid¹⁰⁴ dhe tendenca për asimilim të popujve nga kjo hapësirë, të cilat gjëra kanë qenë të pranishme deri në vitet e para të shekullit XXI¹⁰⁵.

Perandoria Osmane nuk e ka njohur kuptimin modern për kombësinë. Organizimi i përgjithshëm shoqëror është bazuar në fe, ky që vlen edhe për Perandorinë Bizantine. Sistemi i miletit i referohet një praktike perandorake të popujve të ndarë në komunitete fetare mes shekujve XV dhe XX”, të autonomisë së çdo komuniteti fetar¹⁰⁶. Në këtë sistem patriarku grek, armend he rabini hebre kanë pasur pushtet për ligjvënien dhe ekzekutim të ligjeve civile dhe familjare, të mbledhin taksa dhe t’i menaxhjnë në mënyrë të pavarur bashkësitë e veta. Kjo autonomi ka qenë e kushtëzuar me lojalitetin ndaj shtetit osman. Liderët e mileteve kanë qenë aleatë natyrorë të qeverisë, kurse kishat kanë qenë të integruara në shtetndërtimin perandorak si institucione fetare¹⁰⁷.

Duke u nisur nga ideja qendrore për bashkësinë (xhematin), sulltani gjatë udhëheqjes është konsultuar me shoqatat artizanale (esnafët) ose me bashkësitë fetare (miletet), të cilat e kanë qenë bazë e jetës shoqërore në Perandori. Në interes të sulltanit ka qenë që mos të jetë shumë i afërt me ndonjëri grup, por të mbetet mbi grupet shoqërore me qëllim që mos të ndodh të bëhet rob i ndonjërit prej tyre.¹⁰⁸

Si karakteristike tek Sistemi i Miletit ka qenë ajo që, mileti nuk ka pasur të bëjë me territor të caktuar dhe që ka përcaktuar vetëm përkatësinë fetare të popullsisë. Pjesëtarët e miletit kanë pasur lirinë e lëvizjes në të gjithë territorin e Perandorisë. Një gjë e tillë tregon për faktin pse sot ekziston një shumëllojshmëri e kombeve, feve dhe kulturave në territorin e Ballkanit, laramani kjo që flet për një sistem tolerant ndaj “tjetrit” apo “të tjerëve me kulturë të ndryshme”.

Mileti i krishterë dhe ai hebre kanë pasur liri në udhëheqjen e punëve të tyre të brendshme, kurse raportet e tyre me miletin musliman kanë qenë të rregulluara në mënyrë shumë

¹⁰⁴ McCarthy, J. (2015). *Vdekje dhe dëbim-Spastrimi etnik i myslimanëve osmanë, 1821-1922*, Tiranë: Alsar, fq. 21

¹⁰⁵ Иванов, Г. (2004): “Милетскиот систем – модел на религиозна толеранција”, *Политичка мисла*, Институт за демократија, солидарност и цивилно општество, Скопје, fq. 71.

¹⁰⁶ Sahin, E. (2012). “The Millet System: An Overview of Ottoman Social Policy”, *Cultural Sociology of the Middle-East, Asia and Africa*, New Delhi: Sage Publications, fq. 181-183.

¹⁰⁷ По ату, fq. 182.

¹⁰⁸ Иванов, Г. (2004): “Милетскиот систем – модел на религиозна толеранција”, *Политичка мисла*, Институт за демократија, солидарност и цивилно општество, Скопје, fq. 71.

precize. Për shembull, jomuslimanët nuk kanë pasur mundësi të përhapjes së fesë së tyre dhe kanë pasur mundësinë që të ndërtojnë kisha vetëm me leje të pushtetit osman. Ka ekzistuar kufizim sa i përket martesave të përziera, duke u nisur nga parimet kur'anore, muslimanëve iu është lejuar martesa me ndonjë jomuslimane, kurse një muslimaneje nuk i është lejuar martesa me një jomusliman. Jomuslimanët kanë qenë të detyruar të paguajnë tatim të veçantë (*xhizje*), gjë që ka qenë si pasojë e të liruarit nga kryerja e shërbimit ushtarak. Por në kornizat e këtyre kufizimeve ata kanë pasur vetëqeverisje të plotë, duke respektuar ligjet dhe traditat e veta. Liria e tyre kolektive për praktikim të fesë së vet ka qenë e garantuar me ligj. Të mbrojtura me ligj kanë qenë kishat dhe manastiret e mileteve dhe njëherit kanë pasur të drejtën për të pasur shkollat e veta.

Sistemi i Miletit deri në shekullin e XIX në thelb ka qenë sistem i drejtë (human), mjaft tolerues për dallimet e grupeve dhe mjaft stabil. Pothuajse për një gjysëm mijëvjeçari osmanët kanë udhëhequr me Perandorinë Osmane, e cila është dalluar me një gërshetim të popujve, feve dhe kulturave të ndryshme, me një koekzistencë *sui generis*, të tipit *Pax Ottomana*. Për çudi, shoqëria multietnike, multikulturore dhe multigjuhësore e Perandorisë Osmane ka funksionuar perfekt. Muslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë e kanë praktikuar fenë e vet duke bashkëjetuar me njëri-tjetrin, kështu që kanë pasuruar kulturat e tyre të veçanta edhe elemente nga “tjetri”.

Will Kymlicka thotë se shoqëria osmane nuk ka qenë shoqëri liberale nga shkak se nuk i pranuar gjithë parimet e lirisë individuale. Për shkak se secila bashkësi fetare ka pasur të drejtën e vetëudhëheqjes, nuk kanë ekzistuar pengesa të jashtme gjatë vendosjes së rregullave për një respektim më të mirë të fesë nga ana e besimtarëve. Muslimanët nuk janë munduar që t'i nënshtrorjnë hebraikët, edhe ata nuk e kanë bërë të njëjtën, të dyja palët janë munduar që t'i bëjnë për vete heretikët dhe të pabesët. Dyshimi në besim tek feja islame dhe dalja nga feja islame janë cilësuar si vepra kriminale dhe janë dënuar me ligj nga udhëheqësit fetarë muslimanë. Të gjithë ata që nuk kanë qenë pjesëtarë të kishës, nuk kanë pasur të drejtën që të kenë miletin e tyre dhe janë islamizuar, respektivisht ndaj tyre është përdorur i ashtuquajtur i “xhihadi i vogël” i cili ka të bëjë me thirrjen dhe kthimin e pabesimtarëve në fenë islame. Shembull tipik për këtë janë bogomilët dhe romët që kanë jetuar në kuadër të Perandorisë Osmane. Në bashkësinë fetare krishtere dhe hebraike ka ekzistuar kufizim gjatë praktikimit të lirisë individuale dhe të lirisë së veprimit.¹⁰⁹

Sipas Kymlicka-s Sistemi i Miletit në fakt ka qenë një federatë e teokratëve. Shoqëria osmane ka qenë shumë konservative dhe patriarkale, gjë që është në kundërshtim me idenë për liri individuale për të cilën janë munduar liberalët nga Evropa. Miletet e ndryshme janë dalluar në rrafshin e besimit të tyre fetar. Gjatë historisë 500 vjeçare të mileteve, ka pasur periudha të caktuara kur shumë reformatorë liberalë kanë bërë shtypje në bashkësitë e tyre për kufizim të pushtetit që ka pasur lideri i një mileti. Një kërkesë e tillë është realizuar vetëm se në gjysmën e dytë të shekullit XIX, kur një pjesë e mileteve kanë pranuar kushtetuta liberale, respektivisht

¹⁰⁹ Po aty, fq. 74-75.

duke e shndërruar teokratinë religjioze në një sistem liberalo-demokratik të vetëqeverisjes tek grupet e ndryshme kombëtare. Reformatorët liberalë kanë kërkuar që miletet të përdoren si bazë për një sistem të institucioneve federale, me të cilin do të siguroheshin të drejtat për pakicat kombëtare.¹¹⁰

Por, marrë në përgjithësi, në Perandorinë Osmane ka ekzistuar kufizim strikt sa i përket lirisë së njerëzve lidhur me besimin e tyre fetar. Osmanët e kanë pranuar parimin e tolerancës fetare, vullnetin e besimtarëve të fesë dominante për të bashkëjetuar me besimtarët e feve të tjera, por nuk e kanë pranuar parimin për liri në qëndrimet individuale. Sistemi osman i miletit është ndoshta modeli më i zhvilluar i tolerancës fetare joliberalë, kurse variacionet paksa të ndryshme të këtij modeli mund që të gjenden në kohëra të ndryshme dhe në shumë vende tjera.

Pothuajse të gjitha mbretëritë në Mesdhe që nga koha më e vjetër, e kanë pasur si traditë që popullit të vet dominant t'i japin njëlloj pavarësie e cila ka qenë edhe në interes të bashkësive tjera që kanë qenë pjesë e mbretërive. Gjithsesi se më i njohur për një gjë të tillë ka qenë Leka i Madh, i cili në perandorinë e vet ka formuar njëfarë *komonuellthi antik*. Mirëpo, osmanlinjtë përmes Sistemit të Miletit kanë sjellur risi me atë që kanë ndërtuar një lloj sistemi shtetëror dhe janë vendosur rregulla të qarta, me çka sistemi në fjalë është bërë pjesë e strukturës shtetërore. Sot, disa pakica joliberalë dëshirojnë pikërisht një sistem të tillë (Sistemi i Miletit). Ky lloj sistemi (Sistemi i Miletit) kërkohet më shumë në emër të tolerancës. Mirëpo, toleranca për të cilën liberalët historikisht janë thirrur nuk është e tillë. Këto grupe nuk kanë dashur që shteti t'i respektoj liritë e shprehjes, dyshimeve dhe ndryshimit të qëndrimit fetar. Ato në fakt kërkojnë pushtet që ta kufizojnë lirinë fetare të pjesëtarëve të vet.¹¹¹

Në shekullin e XIX miletet në Perandorinë Osmane kanë qenë nën ndikim të ideve liberale që kanë ardhur nga Evropa, me çka ato kanë filluar që dalngadalë të shndërrohen në kombe, më saktë në shtete kombëtare. Të parët kanë filluar serbët me kryengritjen në vitin 1812, por që janë mundur në këtë kryengritje, e që më pas në vitin 1817 serbët fitojnë pavarësi në një pjesë të vogël të Serbisës, përkatësisht në Pashallëkun e Beogradit.

Shtetet evropiane do të tregojnë interes fill pas Kryengritjes Greke të vitit 1821, kur edhe do të fillojë të paraqiten ndjenjat e solidaritetit në Evropë. Formimi i shtetit kombëtar të Greqisë ka qenë mjaft i lehtë, pasi që territori vetëm se ka qenë i përcaktuar. Mirëpo, situata ka qenë krejtësisht ndryshe në pjesët tjera të Ballkanit, ku popujt kanë jetuar të përzier në mes veti. Një situatë e tillë ka ndikuar që tek elitat intelektuale të zhvillohen vizione dhe aspirata, në të cilat janë përfshirë sa më shumë rajone ku kanë jetuar pjesëtarët e mileteve të dikurshme. Kështu ka ardhur deri te paraqitja e projekteve për Serbinë e Madhe, Bullgarinë e Madhe, Greqinë e Madhe, Rumaninë e Madhe etj.¹¹²

¹¹⁰ Po aty, fq. 75.

¹¹¹ Po aty, fq. 75-76.

¹¹² Po aty, fq. 76.

Sistemi i milletit ka qenë funksional përderisa në Perandorinë Osmane nuk depërtuan konceptet e nacionalizmit dhe të etnicitetit në gjysmën e dytë të shekullit XIX.¹¹³

Fuqitë evropiane intensivisht janë përzier dhe i kanë përdorur idetë nacionaliste të elitave lokale, me qëllim që t'i kënaqin qëllimet e veta, mes tjerash edhe për shkatërrimin e një shteti vigan siç ka qenë ai osman. Për shkak të motiveve gjeopolitike, fetare dhe motiveve tjera, Rusia e ka përkrahur idenë për Bullgarinë e Madhe, Franca ka përkrahur idenë për Serbinë e Madhe, kurse Britani e Madhe ka përkrahur idenë për Greqinë e Madhe. Mund të arrihet në konkludimin se, paqja në Ballkan ka qenë e mundur nëse ndonjë fuqi imperialiste merrte detyrën si gjyqtar mes popujve dhe grupeve të ndryshme fetare dhe duke vendosur ndonjë lloj rendi ndërkulturor. Me shekuj ato kanë qenë perandoritë, e veçanërisht osmanët me parimin e “*milletit*”.¹¹⁴

Më pas, në shekullin XIX dhe XX, Austro-Hungaria dhe fuqitë e mëdha evropiane, kanë qenë në gjendje që bashkë me aleatët e tyre të Ballkanit, që të vendosin për kombet se cilat territore do t'i kenë si pjesë e shteteve të tyre, dhe në këtë mënyrë kanë shkaktuar ngritjen e tensioneve në mes popujve dhe paraqitjen e konflikteve të armatosura. Gjatë periudhës së komunistëve, në territorin e Jugosllavisë përsëri është arritur një baraspeshë në mes popujve, e cila ka zgjatur thuajse gjysëm shekulli. Kjo baraspeshë është arritur me atë që, pushteti u ka garantuar të drejta kombëtare popujve të ndryshëm që kanë jetuar në ish-Jugosllavi, por në aspekt fetar pushteti ka ndjekur një politikë antifetare, ngase në kuluaret e pushtetit jugosllavë ka ekzistuar frikë për paraqitje të problemeve në aspekt fetar. Pushteti jugosllavë është munduar që feja të mos luaj rol në jetën e përditshme të qytetarëve, por edhe duke mos penguar në shfaqjen e bindjeve fetare.

Sllovenët, kroatët dhe serbët kanë qenë popuj të rendit të parë, pra kanë qenë të privilegjuar në mesin e popujve që kanë jetuar në ish-Jugosllavi. Popujt të rendit të dytë në ish-Jugosllavi janë llogaritur muslimanët e Bosnjës, maqedonasit dhe malaziasit, kurse popujt të rendit të tretë janë llogaritur pakicat kombëtare si romët, vlllehët, hungarezët, rumunët etj. Mund të përmenden shembuj të shumtë për ekzistim të baraspeshës në mes popujve në ish-Jugosllavi, ku në vijim do t'i theksojmë. Shqiptarët kanë qenë të lirë që të përdorin gjuhën e tyre amtare dhe simbolet e tyre kombëtare në vendet ku kanë jetuar, por njëherit ato të njëjtën mundësi e kanë pasur edhe në kryeqytetin e Serbisë, Beograd. Shqiptarët kanë mundur që pa asnjë pengesë të mund punojnë, veprojnë dhe të lëvizin lirshëm nëpër të gjithë territorin e Jugosllavisë. Të njëjtën gjë e kanë gëzuar edhe popujt e tjerë më në numër dhe ato pakicë. Poashtu, duhet theksuar se në mes popujve ka pasur marrëdhënie të mira dhe respekt, si dhe ka pasur mirëkuptim për dallimet kombëtare, gjuhësore dhe fetare. Harmonia në mes popujve në ish-Jugosllavi nuk ka zgjatur shumë, por afro një gjysëm shekulli.

¹¹³ Yilmaz, I. “Diversity, Legal Pluralism and Peaceful Co-Existence in the Ottoman Centuries”, *SSRN Electronic Journal*, shkurt 2013, fq. 92.

¹¹⁴ Иванов, Ѓ. (2004): “Милетскиот систем – модел на религиозна толеранција”, *Политичка мисла*, Институт за демократија, солидарност и цивилно општество, Скопје, fq. 76.

Me fillimin e rënies së Jugosllavisë dhe pas luftërave të përgjakshme që ndodhën, detyrën e qetësuesit të tensioneve e marrin SHBA-të, që deri diku i shuan konfliktet mes serbëve dhe popujve tjerë. Konflikti i armatosur mes serbëve nga njëra anë, dhe kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve të Kosovës nga ana tjetër, lanë gjurmë të thella në historinë e Ballkanit. Gjithë ai tmerr që u përjetua është si tregues për mungesën e mirëkuptimit, tolerancës dhe gjetjes së mënyrës paqësore për të rregulluar mosmarrëveshjet, qofshin ato me karakter kombëtar, fetar apo politik. Me rëndësi është të theksohet se, popujt e Ballkanit në vazhdimësi kanë qenë të manipuluar nga jashtë dhe kjo gjë është bërë edhe më e fuqishme, duke pasur parasysh oreksin për dominim të popujve të mëdhenj ndaj popujve të vegjël.

Në Ballkan procesi i formimit të shtet-kombeve shfaq një tregues fetar të veçantë për nga lloji, krahasuar kjo me të gjitha vendet e tjera përreth. Fetë u përdorën politikisht si element i dallimit etnik në konflikte. Ideja se çdo komb ka fenë e tij, në thelb është një ide jofetare, si prodhim i interferimit nacionalist në fe. Duke qenë se fetë përfaqësojnë një element mjaft të rëndësishëm në strukturën dhe mentalitetin e çdo kombi, kjo ideologji dominuese është përdorur si arsye për luftëra dhe pushtime nga udhëheqës politik të mbështetur nga një pjesë e klerit fetar. Sipas historianit polak Marek Waldenberg kjo dukuri u quajt etnicizëm fetar. Etnicizmi fetar, ishte një dukuri që shëmbëlleu keqpërdorimin politik të fesë.

Një popull mund të identifikohet përmes përkatësisë kombëtare, fetare, gjuhësore dhe kulturore. Të gjitha këto elemente karakterizojnë një popull, i cili nëpër histori ka zhvilluar atë. Dy shtyllat kryesore më të rëndësishme të një populli janë kombi dhe feja, të cilat janë ruajtur me një fanatizëm gjatë rrjedhave të ndryshme historike. Përkatësia kombëtare e një populli ngërthen këto elemente përbërëse: të kaluarën historike, karakteristikat gjenetike dhe fizionomike, gjuhën, traditat dhe zakonet. Ndërsa përkatësia fetare në përbëhet nga besimin fetar që ka populli, ritet dhe objektet fetare që janë pjesë e fesë, ligjet fetare dhe mënyra e organizimit të jetës bazuar në parimet fetare.

Në debatet e shumta të organizuara nëpër vende të ndryshme të botës flitet për liritë dhe të drejtat e pakicave kombëtare dhe fetare. Pothuajse nuk ka vend në botë që është i pastër etnikisht apo fetarisht, gjë që është mjaft normale, ngase njerëzit janë në lëvizje të përhershme dhe ndërrojnë vendbanimin, në veçanti në kohë të sodit, të periudhës së globalizimit kur bota është shndërruar në një “fshat global”. Disa shtete po mundohen që përmes politikës së asimilimit t’i homogjenizojnë vendet e tyre në aspekt kombëtar. Kjo gjë nuk ndodh vetëm në vendet me pushtet monist, por edhe në disa shtete që njihen si vende me demokraci të vjetër. Aspekti kombëtar i pakicave paraqitet si problem mjaft i shprehur në shumë vende të botës, ku çuditërisht popullsisë shumicë sikur i pengojnë pakicat kombëtare dhe dëshirë e shumicës është dominimi i plotë ndaj pakicave, madje edhe mohimi i lirive dhe të drejtave të pakicave etnike. Në shumë shtete si problem paraqet përkatësia kombëtare e pakicave, por edhe ajo fetare e qytetarëve. Kjo e fundit në veçanti vlen për vendet europiane ku ka një numër të madh të emigrantëve nga Azia dhe Afrika.

Në të kaluarën, por edhe sot, në vendet ballkanike kanë ekzistuar probleme sa i përket sigurimit të lirive dhe të drejtave për pakicat kombëtare, ku kjo gjë ka ndikuar edhe në situata konfliktuale midis pakicave kombëtare dhe popullsisë shumicë në shtetin e caktuar. Edhe pse tani gjendemi në shekullin XXI, në vendet ballkanike edhe sot ka probleme sa i përket pranimi të lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare dhe religjioze. I tillë është rasti edhe në Maqedoni, ku entiteti shumicë mundohet që t'i ruajë privilegjet dhe të akordojë të drejta për komunitetet “me lugë”, në masë më të madhe kur rriten tensionet dhe kur ka presione ndërkombëtare, gjë që krijon një nebulozë lidhur me të ardhmen e këtij shteti të ri dhe labil.

Sistemi i Miletit mund të përdoret si model për sa i përket lirive dhe të drejtave fetare grupeve fetare pakicë. Ky sistem ka qenë praktik në Perandorinë Osmane dhe ka siguruar një bashkëjetesë midis grupeve të ndryshme fetare, por i cili mund të praktikohet edhe sot si model bashkëjetese midis grupeve të ndryshme fetare. Diversiteti osman nuk ka qenë një rastësi historike, por rrjedhim i natyrë rrënjësore të së drejtës islame. Ky rend në vijë me të drejtën islame i ka ushqyer gjithnjë dallimet dhe është parë si një virtyt nga osmanët¹¹⁵. Shteti osman nuk është si ato moderne që targetojnë unifikimin. Sipas Ostrorogut, shteti osman u ka dhënë liri të plotë të krishterëve dhe çifutëve për të vendosur në çështje të tyre sipas parimeve të së drejtës së tyre, ka implementuar një juridiksion të veçantë për këtë qëllim për autoritetet fetare të këtyre dy komuniteteve; autoritetet osmane kanë ndërhyrë në raste të veçanta vetëm për të zbatuar ekzekutimet. Sistemi i milletit ka kontribuar në ruajtjen e identitetit të veçantë të popujve dhe në formimin e ndërgjegjes nacionaliste të ndryshme nga ajo e muslimanëve.

Sipas McCarthy: “Osmanët i kanë mbështetur traditat fetare të Lindjes së Mesme dhe Ballkanit dhe i kanë kodifikuar ato në ligje. Çdo grup fetar është emëtuar si millet.... Prijësit e tyre i kanë përfaqësuar nevojat e popujve të vet para qeverisë së sulltanit. Nganjëherë, si në rastin e ortodoksëve grekë, vendi i milletit ka qenë i njohur specifikisht me ligj. Miletet e tjera, si hebrenjtë thjasht kanë qenë të njohur nga tradita. Me kalimin e shekujve, numri i sekteve të njohura zyrtarisht është rritur... por sistemi i milletit ka qenë një element thelbësor i qeverisë osmane që nga kohërat më të hershme. Madje edhe para njohjes së tyre zyrtare, milletet *de facto* kanë pasur ekzistencë të veçantë.”¹¹⁶

Mirëpo, sipas disave, ky sistem nuk mund të jetë praktik për liritë dhe të drejtat kombëtare për pakicat kombëtare, pasi që ai në thelb ka të bëjë me të drejtat fetare. Sa i përket lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare nuk ekziston një model i vetëm, por ka më shumë modele që në mënyrë shumë të mirë i rregullojnë liritë dhe të drejtat e pakicave kombëtare dhe të cilat sigurojnë një bashkëjetesë midis popullit shumicë dhe grupeve kombëtare pakicë. Si modele më të mira për respektimin e lirive dhe të drejtave të pakicave kombëtare mund të merren: modeli i Zvicrës, Gjermanisë, Holandës, Belgjikës, Britanisë Madhe, Kanadasë, Danimarkës etj.

¹¹⁵ Yilmaz, I. “Diversity, Legal Pluralism and Peaceful Co-Existence in the Ottoman Centuries”, *SSRN Electronic Journal*, shkurt 2013, fq. 83, 92.

¹¹⁶ Po aty, fq. 93.

Si përfundim i kësaj pjese mund të thuhet se Perandoria Osmane i ka respektuar liritë fetare, “ajo nuk kishte planifikuar as kompaktësim demografik të muslimanëve, as segregim të të krishterëve, po kishte inkurajuar jetën e përbashkët në tolerancë e harmoni, gjë që u tregua fatale për vetë muslimanët”. McCarthy thotë se “osmanëve u janë atribuar merita të pakta për traditën e tyre të gjatë dhe unike të tolerancës fetare.” Ç’është më ironizuese, ata e paguan atë me një çmim shumë të shtrenjtë. Të huajt e përdorën arsyetimin e mbrojtjes së mileteve të krishtera dhe vëllazërive të krishtera si pretekste për të ndërhyrë në punët e brendshme të osmanëve. Anëtarët e mileteve të krishtera e përdoren këtë sens të ndarjes fetare si burim për të krijuar një nacionalizëm anti-osman¹¹⁷. Sistemi i milletit nuk u shkatërrua për shkak se ishte jofunksional por për shkak të rrymave të nacionalizmit ezogjen dhe shkatërrimit të vetë Perandorisë.

Sidoqoftë, një gjë është e padiskutueshme, sistemi i milletit, i cili sipas Bullaçit, rënjtë i ka te Karta e Medinës, që paraqet zbatimin e parë të sistemit të milletit në historinë islame, ka menaxhuar me sukses bashkëjetesën paqësore të pakicave jomuslimane.¹¹⁸ Sot shumë islamistë apo autoritete të islamit politik pohojnë se ky sistem është aktual dhe i përdorshëm edhe për kohën e sodit. Madje ka pasur edhe të atillë, si disa anëtarë të partisë turke të Mirëqenies që në vitin 1997 janë shprehur e drejta nuk duhet të prodhohet nga shteti, por nga individët dhe bashkësitë, se shteti duhet të luajë vetëm rolin e koordinatorit. Në shekullin tonë, ku dialogu, pranimi i tjetrit, toleranca, respektimi i drejtësisë, legjitimiteti ndërkombëtar, mbrojtja e pakicave dhe sundimi i ligjit janë të sfiduara nga sisteme të ndryshme, sistemi i milletit mund të jetë një model për t’u marrë si shembull apo si referencë.

Marrëdhëniet midis politikës moderne dhe fesë, pavarësisht shekullarizmit shtetëror, sjell eksperiencë të ndryshme. Ndonjëherë është e vështirë të përcaktosh ku fillon njëra e ku mbaron tjetra sepse aplikimi praktik i hapësirave nuk ka të njëjtën formë. Shpesh ato mundohen të përfitojnë nga njëra-tjetra duke u bërë njëkohësisht pjesë e tërësisë. Midis lirisë fetare si një e drejtë universale dhe laicizmit si parim kushtetues modern në praktikë ka shembuj kontradiktorë.

Mesa duket ndarja e fesë nga politika ligjërish nuk garanton ndikimin e tyre tek njëra-tjetra. Megjithatë nëse vlerësojmë elementët e ndryshëm që përbëjnë marrëdhëniet mes fesë dhe politikës disa përgjigje megjithëse jot ë përsosura duhet t’i japim. Nisur nga kjo, një përkufizim enciklopedik do të ishte një fillim i mirë për të vlerësuar hapësirat e përbashkëta dhe kundërshtitë mes tyre. Politika është një process ku një grup njerëzish, mendimet e të cilëve ose interesat e tyre, janë fillimisht divergjente, marrin vendime kolektive të cilat konsiderohen si detyruese për grupin dhe zbatohen si politikë e përbashkët. Ekziston një numër elementesh të rëndësishëm që mund të bëjnë të mundur interferimin e politikës me fenë.

¹¹⁷ Krasniqi, M. (2017), “Gjenocidi kundër muslimanëve të Perandorisë Osmane- i fshehur rreth 100 vjet”, *Res Publica*.

¹¹⁸ Yilmaz, I. “Diversity, Legal Pluralism and Peaceful Co-Existence in the Ottoman Centuries”, *SSRN Electronic Journal*, shkurt 2013, fq. 93.

III.2 SHOQËRIA MULTIKULTURORE NË MAQEDONI – SHEMBULLI I PROJEKTIT SKANDALIZ “SHKUPI 2014”

III.2.1 Përbërja kombëtare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë

Territori në të cilin shtrihet Republika e Maqedonisë, qysh në kohërat më të lashta ka qenë i banuar nga popuj të ndryshëm, të cilët kanë lënë gjurmë në histori. Para më shumë se 1.500 vite, në territorin e Maqedonisë kanë jetuar disa fise ilire dhe fiset e maqedonasve antikë. Me ardhjen e sllavëve duke filluar nga shekulli VI, vjen deri te ndërrimi i strukturës së popullsisë së Maqedonisë, madje njëherit gradualisht fillon humbja e gjurmëve të maqedonasve antikë si pasojë e përzierjes me fiset sllave. Fiset sllave ishin fise barbare dhe barbarizmi i tyre u shpreh në sulmet dhe shkatërrimet që kryen ndaj fiseve ilire dhe fiseve të maqedonasve antikë. Fiset ilire edhe përkaj sulmeve që pësuan nga sllavët, arritën të vazhdojnë ekzistencën e tyre në trojet shekullore të Maqedonisë. Maqedonasit antikë nuk arritën të mbijetojnë nga sulmet dhe procesi asimilues që kryen sllavët ndaj tyre. Pasardhës të ilirëve janë shqiptarët, të cilët edhe në ditët e sotme kryesisht banojnë pjesën perëndimore dhe veriore të Republikës së Maqedonisë, por edhe disa zona të rajonit të Pellagonisë (Dollnen, Krushevë dhe Manastir).

Me vendosjen e osmanlinjve në territorin e Maqedonisë kah fundi i shekullit XIV dhe fillimit të shekullit XV, ndodhën ndryshime. Osmanlinjtë përveç se u vendosën me ushtrinë dhe administratën, ata me vete sollën edhe fiset konjare dhe juruke, të cilët njiheshin si fise endacake blegtorale. Në territorin e Maqedonisë së sotme u vendosën edhe romët dhe hebrenjtë. Romët njiheshin si popull endacak dhe merreshin kryesisht me disa lloje të zejeve, kurse hebrenjtë (jehudët) ishin si popull i zgjuar dhe kryesisht njiheshin si tregtarë mjaft të mirë. Gjatë periudhës osmane pesë-shekullore, qytetet e Maqedonisë njohën një zhvillim shumë të madh në shumë lëmi si në: arkitekturë, infrastrukturë, tregti, arsim, shëndetësi, kulturë, etj. Atëbotë Shkupi ishte qendër e Vilajetit të Kosovës, qyteti më i madh në trojet etnike të Shqipërisë, ishte qendër e rëndësishme ekonomike, tregtare, politike, arsimore, fetare dhe kulturore e shqiptarëve dhe njëherit edhe e Perandorisë Osmane në pjesën evropiane.

Pas largimit të Perandorisë Osmane nga territori i Maqedonisë, populli shqiptarë nuk fitoi lirinë dhe nuk iu bashkua Shqipërisë së pavarur, tokat e shqiptarëve që jetonin në Maqedoni u ankesuan nga Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene. Që pas largimit të osmanlinjve gjithandej fillon një periudhë shumë e errët për popullin shqiptarë, i cili sistematikisht u gjend nën shtypjet, sulmet dhe politikën diskriminuese dhe asimiluese të pushtetit serbo-sllav. Përfshirja e territorit të Maqedonisë njëherë ndër Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene, e pas Luftës së Dytë Botërore në kufijtë e Jugosllavisë, ishte data e nisjes së një periudhe shumë të rëndë për shqiptarët. Si pasojë shtrirja e tyre territoriale në Maqedoni pësoi tkurrje, pasi nga ana pushtuesit serbo-sllav u përdorën masa të ndryshme ç’njerëzore ndaj popullsisë shqiptare.

Politika diskriminuese dhe asimiluese e drejtuar kryesisht ndaj shqiptarëve, e më pak edhe ndaj pakicave tjera kombëtare, nuk u ndal edhe me pavarësimin e Maqedonisë në shtator të

vitit 1991. Pushteti maqedonas vazhdoi në të njëjtën linjë që t'i trajtojë shqiptarët, edhe pse shqiptarët si popull kontribuan në pavarësimin e Maqedonisë nga Jugosllavia ose federate me “mangësi fabrike”. Pushteti maqedonas me politikën diskriminuese të përdorur në ekonomi, infrastrukturë, kulturë, arsim, shëndetësi, administratë, etj., ndikoi që një pjesë e popullsisë shqiptare të emigrojë në vendet e Evropës Perëndimore, me qëllim që të ketë sigurojë një të ardhme më të mirë për gjeneratat e reja. Politika diskriminuese e pushtetit maqedonas ka pasur ndikim në strukturën kombëtare të popullsisë. Qëllimi i pushtetit maqedonas ka qenë dhe është qëllimi që shteti të banohet nga shumicë maqedone dhe ajo të dominojë ndaj grupeve të tjera kombëtare, të cilat nga qarqet më radikale quhen “pakica”.

Me qëllim të njohjes së numrit të popullsisë dhe karakteristikave të saj gjinore, moshore, kombëtare, fetare, gjuhësore (etno-linguistike), arsimore, ekonomike etj., realizohen regjistrime të cilat nxjerrin në pah veçoritë e popullsisë së një vendi. Në territorin e Maqedonisë që nga viti 1900 e deri më vitin 2002 janë realizuar disa regjistrime. Regjistrimi i vitit 1900 dhe 1913 nuk merren si regjistrime zyrtare, kurse si regjistrim zyrtar merret ai i realizuar në vitin 1921. Nga viti 1921 e deri më vitin 2002, në Maqedoni ka pasur gjithsej 10 regjistrime. Në të gjitha regjistrimet e bëra nga viti 1900 e deri në atë të vitit 2002, është përcaktuar përkatësia kombëtare e popullsisë. Në të gjitha regjistrimet e popullsisë që janë realizuar, të dhënat kanë treguar se në Maqedoni jetojnë disa popuj dhe grupe kombëtare. Pra, Maqedonia ka qenë dhe vazhdon të jetë shtet multietnik dhe multikulturor.

Në të gjitha regjistrimet të dhënat flasin se maqedonasit gjithëherë kanë qenë popullsi shumicë, kurse popullsia shqiptare është populli i dytë për nga numri pas maqedonasve. Grupet e tjera kombëtare si turqit, romët, serbët, boshnjakët, vllehët dhe tjerët *de facto* janë pakica kombëtare, kurse me kushtetutë konsiderohen komunitete. Maqedonasit jetojnë pothuajse në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, por shumicë janë në këto rajone: Rajonin e Vardarit, Rajonin Juglindor, Rajonin e Pellagonisë, Rajonin Lindor, Rajonin Verilindor, Rajonin e Shkupit dhe Rajonin Jugperëndimor. Ndërsa shqiptarët përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë së Rajonit të Pollogut, por ata jetojnë edhe në numër të konsiderueshëm edhe në Rajonin e Shkupit, Rajonin Verilindor dhe Rajonin Jugperëndimor.

Tabela 4. Përbërja kombëtare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë e bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2002.¹¹⁹

Kombësia	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Serbë	Boshnjakë	Vllehë	Tjerë ¹²⁰
Numri	1.297.981	509.083	77.959	53.879	35.939	17.018	9.695	20.993
Përq. (%)	64,18	25,17	3,85	2,66	1,78	0,84	0,48	1,04

¹¹⁹ Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, Vjetari statistikor i vitit 2002, Shkup.

¹²⁰ Në grafën të regjistruar si “Të tjerë” bëjnë pjesë këto pakica kombëtare: egjiptasit 3.713 ose 0,18%, kroatët 2.686 ose 0,13%, muslimanë 2.553 ose 0,13%, malaziasit 2.003 ose 0,10%, bullgarët 1.417 ose 0,07%, grekët 422 ose 0,02%, rusët 368 ose 0,02%, sllovenët 365 ose 0,02%, polakët, ukrainasit, gjermanët, çekët, sllovakët, hebrejët, italianët, austriakët dhe disa grupe tjera në numërojnë 7.466 persona ose 0,37%.

Pra, bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2002, në Republikën e Maqedonisë jetojnë më shumë se 22 grupe kombëtare, prej tyre maqedonasit dhe shqiptarët janë dy popujt më të mëdhenj të cilët jetojnë në vend. Maqedonasit në vitin 2002 kanë qenë 64,18% e popullsisë së përgjithshme, kurse shqiptarët dhe grupet e tjera kombëtare përbënin 35,82% të popullsisë së përgjithshme. Bazuar në ndarjen e re territoriale-administrative, maqedonasit janë shumicë në 60 komuna, shqiptarët janë shumicë në 15, turqit në 2, romët në 1 komunë dhe në 2 komuna asnjë grup kombëtar nuk është shumicë. Duhet theksuar se në Qytetin e Shkupit shumicë janë maqedonasit, të cilët përbëjnë 66,75% të popullsisë së përgjithshme të qytetit, kurse shqiptarët përbëjnë 20,49%.

Popullsia shqiptare shumicë, pra mbi 50% është në këto 15 komuna të Republikës së Maqedonisë: Likovë, Haračinë, Studeniçan, Çair, Saraj, Zhelinë, Tearcë, Tetovë, Bogovinë, Bërvenicë, Gostivar, Vrapçishtë, Kërçovë, Dibër dhe Strugë. Popullsia shqiptare nuk përbën shumicë, mirëpo është mbi 20% edhe në 11 komuna të vendit dhe në to gëzon të drejtën e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe dhe të alfabetit të saj. Pak mbi 20% shqiptarët janë edhe në Qytetin e Shkupit.

Pakicat kombëtare tjera shumicë janë në 3 komuna dhe atë: turqit përbëjnë shumicën e popullsisë në Pllasnicë dhe Qendër-Zhupë, kurse romët përbëjnë shumicën e popullsisë në komunën e Shuto Orizarës. Në 2 komunat me shumicë turke, turqit në komunikim zyrtar përdorin gjuhën turke dhe alfabetin e saj, si dhe flamurin dhe simbolet kombëtare. E njëjta gjë vlen edhe për romët në komunën e Shuto Orizarës.

Që nga viti 1991 e deri më vitin 2000, shqiptarët kanë qenë mjaft të diskriminuar në të gjitha lëmitë e jetës, dhe si pasojë në vitin 2001 ka ndodhur konflikti i armatosur në mes forcave të policisë dhe ushtrisë maqedonase nga njëra anë, dhe forcave të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të organizuar nga vetë populli shqiptar në Maqedoni. Konflikti i vitit 2001 përfundoi me arritjen e Marrëveshjes së Ohrit, e cila solli një ndryshim në gjendjen e popullit shqiptar dhe pakicave kombëtare, të cilët fituan më shumë të drejta nga ato që i kishin para konfliktit. Me arritjen e Marrëveshjes së Ohrit nuk fituan të drejta vetëm shqiptarët, por në krah të shqiptarëve të drejta fituan edhe turqit, romët, serbët, boshnjakët dhe pakicat e tjera.

Marrëveshja e Ohrit është një dokument i cili përmirësoi statusin e shqiptarëve dhe pakicave kombëtare që jetojnë në Maqedoni. Kjo marrëveshje i dha fund konfliktit të armatosur dhe vendi fitoi të drejtën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Asocimit dhe Stabilizimit, një hap i rëndësishëm për fillimin e rrugës drejtë integritetit të vendit në NATO dhe Bashkimin Evropian.

III.2.2 Përbërja fetare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë

Mendimi unanim i thujtë se gjithë sociologëve është se feja është njëra nga institucionet kryesore të shoqërisë. Henri Bergson thotë se si në të kaluarën, ashtu edhe sot mund të rastisim në shoqëri që nuk kultivojnë shkencë, art ose filozofi, por nuk mund të hasim në asnjë shoqëri ku nuk ekziston feja. Feja, e cila depërton në këndet ose sferat më të fshehta të shpirtit, që i jep

njeriut fuqi dhe i ndihmon atij në trajtësimin e botëkuptimit, është një dukuri me ndikim të madh në jetën shoqërore.¹²¹

Feja, pos me individin, është në interaksion të vazhdueshëm edhe me shoqërinë.¹²²

Feja paraqet vetëdijen njerëzore që shprehet me besimin në ekzistencën e Zotit. Në hapësirën e Maqedonisë, në shekullin e I të erës sonë, apostull Pali ka qenë misionari i parë i cili ka përhapur fenë krishtere. Popujt që kanë jetuar në territorin e Maqedonisë nga shekulli i I-rë e deri në fund të shekullit XIV, kanë qenë pjesëtarë të fesë krishtere, kurse me ardhjen e osmanlinjve dhe me të edhe thirrësve në fenë islame, filloi që harta e kësaj hapësire të marrë edhe ngjyrim islam.

Republika e Maqedonisë është një hapësirë komplekse shoqërore dhe religjioze ku kryqëzohen dy fe universal dhe shumë rrethe kulturore. Komunizmi edhe pse për më tepër se katër dekada u mundua ta fshijë ndjenjën fetare prej mendjes dhe zemrës së njeriut dhe prej shoqërisë, nuk arriti sukses në këtë aspekt. Sot, në Maqedoni veprojnë mbi 40 komunitete fetare. Por, realiteti flet se në këtë vend dominon një dikotomi, pra fetë kryesore janë Krishterimi ortodoks dhe Islami. Përveç tyre, në këtë nënqiell hasim edhe sekte dhe fraksione të shumta religjioze dhe kuazireligjioze.¹²³

Me ndryshimin e sistemit politik dhe ekonomik në Republikën e Maqedonisë, natyrisht ndryshoi edhe qëndrimi i shtetit karshi fesë. Për herë të parë në kushtetutën e këtij vendi gjeti vend emri i njëres fe, ai i Krishterimit ortodoks. Marrja e një vendimi të këtillë të shtetit shkaktoi reagime të ashpra te pjesëtarët e feve tjera, për arsye se subjekti fetar që përmendej në aktin më madhor juridik të këtij vendi *de facto* mori statusin e fesë zyrtare shtetërore.¹²⁴

Në Maqedoni, në kuadër të fesë krishtere kemi tre drejtimet kryesore krishtere: ortodoksizmin, katolicizmin dhe protestantizmin. Të tre drejtimet krishtere janë të përhapura në mesin e popullsisë së vendit tonë me shumicë absolute të ortodoksisë. Ndërsa në kuadër të fesë islame dominant është sunizmi dhe më pak shi'izmi. Multifetarizmi dhe toleranca fetare që ekziston në Maqedoni, paraqet një pasuri më vete.

Tabela 5. Përbërja fetare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë e bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2002.¹²⁵

Besimtarë	Ortodoksë	Muslimanë	Katolikë	Protestantë	Tjerë	Gjithsej
Numri	1.310.184	674.015	7.008	520	30.820	2.022.547
Përq. (%)	64,78	33,32	0,35	0,03	1,52	100,00

¹²¹ Pajaziti, A.(2002): Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia Universitare dhe religjioni (studim sociologjik), Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 28.

¹²² Po aty.

¹²³ Po aty, fq. 29.

¹²⁴ Po aty, fq. 40.

¹²⁵ Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, Vjetari statistikor i vitit 2002, Shkup.

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2002, pjesa më e madhe e popullsisë së Maqedonisë i takon fesë krishtere, respektivisht pjesëtarë të kësaj feje janë 1.317.712 qytetarë. Fe e dytë me më shumë besimtarë është feja islame, të cilës në vitin 2002 i kanë takuar 674.015 besimtarë muslimanë ose 33,32% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Përveç besimtarëve të krishterë dhe muslimanë, në territorin e Maqedonisë jetojnë edhe pjesëtarë të feve tjera, të cilët për shkak të numrit të vogël ata janë regjistruar në grafën si “tjerë” dhe numri i tyre në vitin 2002 ka qenë 30.820 persona, të cilët kanë përbërë 1,52% të popullsisë së përgjithshme.

Pjesa më e madhe e besimtarëve të krishterë në Maqedoni i takojnë ortodoksizmit, respektivisht 1.310.184 persona janë besimtarë ortodoksë, të cilët përbëjnë 64,78% të popullsisë së përgjithshme të vendit. Ndërsa, besimtarët katolikë dhe protestantë janë me numër të vogël, më saktë në vendin tonë në vitin 2002 ka pasur 7.008 besimtarë katolikë, të cilët kanë përbërë 0,35% të popullsisë së përgjithshme të vendit, si dhe ka pasur 520 besimtarë protestantë ose 0,03%.

Tabela 6. Përbërja fetare e popullsisë së Republikës së Maqedonisë e bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2010.¹²⁶

Besimtarë	Ortodoksë	Muslimanë	Katolikë	Tjerë	Gjithsej
Numri	1.300.000	771.672	8.229	28.801	2.108.702
Përq. (%)	61,65	36,59	0,39	1,37	100,00

Në të dhënat nga vlerësimi statistikor i vitit 2010, vërehet se gjatë periudhës 2002-2010 shënohet rritje e numrit të muslimanëve dhe rënie e numrit të besimtarëve ortodoksë.

Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM-i) është institucion fetar kryesor në Republikën e Maqedonisë. Besimtarët ortodoksë rritet e tyre fetare i kryejnë nëpër kisha dhe manastire, të cilat janë pronë e Kishës Ortodokse Maqedonase. Kisha Qendrore Ortodokse (Soboren Hram) gjendet në Shkup, e cila llogaritet si objekti fetar krishter më me vlerë në Republikën e Maqedonisë.

Përderisa në vitin 2002 numri i muslimanëve ka qenë 674.015 besimtarë, në vitin 2010 numri i tyre ka arritur në 771.672 besimtarë, që krahasuar me vitin 2002 është shënuar rritje për 97.657 besimtarë muslimanë, rritje kjo shumë e madhe. Institucioni më i lartë fetar islam në Republikën e Maqedonisë është Bashkësia Fetare Islame, e cila është zotëruese e të gjitha xhamive dhe pronave tjera që kanë statusin e vakëfeve islame. Ky institucion është përgjegjës kryesor për organizimin e jetës fetare islame në Maqedoni, njëherit edhe për organizimin e mësimbesimit fetar në shkollat e mesme për djem dhe vajza dhe në institucionin e lartë arsimor fetar Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup.

Sipas të dhënave të vitit 2011, në territorin e Maqedonisë kanë ekzistuar gjithsej 580 xhami, kurse në ditët e sotme numri i tyre është diçka më i madh krahasuar me vitin në fjalë.

¹²⁶ Po aty, vlerësim statistikor i realizuar në vitin 2010, Shkup.




Foto. 5. Xhamia e Sulltan Muratit në Shkup dhe Kisha e Shën Jovan Kaneos në Ohër, objekte fetare të vjetra me vlerë artistike dhe kulturore.

Një nga dukuritë e rëndësishme të tranzicionit shoqëror është edhe politizimi i fesë dhe në këtë periudhë është shumë rëndë të shënohet vija ndarëse ndërmjet këtyre dy institucioneve të rëndësishme shoqërore. Liderët partiakë premtonin “një rend të ri botëror”, “arritjen e lirisë së popujve të vet dhe çlirimin nga okupatorët e armiqtë”, “arritjen e kufijve gjeografikë kombëtarë, bashkimin e elementeve fetare dhe kombëtare dhe, për pasojë, realizimin e ëndrrave shekullore”. Ata veten e shihnin si shpëtimtarë, për të cilët populli duhej të sakrifikonte gjithçka. Liderët nacional, nuk harronin që t’i përgëzonin besimtarët me rastet e festave fetare, nëpër tubiet e ndryshme fetare garonin se kush do të zhvillonte aktivitet politik më të mirë. Madje në disa raste, siç janë ditët e festave fetare ose kombëtare, edhe vetë ata organizonin ceremonial të larmishme. Në ndërkohë, nga goja e liderëve politikë të ndikuar nga ekstremizmi dhe ultranacionalizmi i shfaqur në trojet më veriore të ish-Jugosllavisë, dilnin fjalë që elektrizonin atmosferën, si “gjaku”, “trimëria”, “lufta”, “fitorja”...!¹²⁷

Bashkësitë fetare me kalimin në shoqërinë demokratike e ngritën zërin për kthimin e pasurive të veta “të uzurpuara nga pushteti në kohën e komunizmit nën parullën e nacionalizmit dhe ekspropriacionit”. Ato shpresojnë se me kthimin e pronave të veta do t’ju hapen shtigje dhe mundësi të reja për veprimtari më përfshirëse dhe më efektive.¹²⁸

¹²⁷ Pajaziti, A.(2002): Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia Universitare dhe religjioni (studim sociologjik), Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 21.

¹²⁸ Po aty, fq. 41.

Me kalimin e sistemit socialist në histori, edhe qytetarët e Maqedonisë filluan t'i ndryshojnë mendimet e veta ndaj tërësisë së quajtur jetë, po edhe ndaj fesë. Së pari u shënua një proces i shpëtimit apo katarzës nga devijimet ideologjike marksiste-leniniste lidhur me vlerësim të fesë. Në kuadër të zhvillimeve dramatike politike, njerëzit kërkonin një fole me të cilën do ta identifikonin vetveten. Një nga elementet më të rëndësishme të kësaj foleje u bë ai fetar. Është një fakt shkencor se në kohën e krizave vjen deri te rritja e nivelit të fetarësisë, pra deri te ngritja e ndjenjave fetare.¹²⁹

Ringjallja ose rizgimi fetar ndjehet në çdo aspekt të jetës, në ndërtimin e tempujve të ri, në veprimtarinë botuese, në aktivitetet politike dhe kulturore, në medium e kështu me radhë.¹³⁰

Vitet '90-të dallohen edhe me “modernizimin, individualizimin dhe subjektivizimin e fesë”, me dukurinë e fetarësisë pa qenë i lidhur për ndonjë fe ose bashkësi fetare, “arritjen deri te Zoti me përpjekje dhe hulumtim vetjak”. Këto dukuri më tepër vërehen tek maqedonasit ortodoksë se sa te muslimanët. Kjo ndodh për shkak të dobësimit të institucionit të Kishës, i cili supozohet të jetë pasojë e shtyrjes së fesë në kohën e monizmit në “fushën e sferës subjektive të njeriut”.¹³¹

Edhe pas aprovimit të kushtetutës së re, organet shtetërore deri më vitin 1997 nuk aprovuan ndonjë ligj të ri për organizimin e jetës fetare. Deri në zyrtarizimin e ligjit të ri të 23 korrikut të vitit 1997, që flet për pozitën e bashkësive fetare, për themelimin dhe veprimtarinë e grupimeve fetare, për mësimbesimin dhe shkollat fetare, të cilat janë forma e shprehjes së lirive fetare.¹³²

Mund të themi se e shenja dhe elementi fetar përsëri janë kthyer në Maqedoni, e me këtë është vërtetuar hipoteza se njeriu nuk mund të jetojë pa Zot dhe pa fe. Feja dhe besimi janë nga nevojat ose dëshirat themelore të njeriut, e nevojat themelore nuk mund të zhduken ose të mohohen. Ato e ruajnë gjallërinë e vet, madje edhe nëse ne i refuzojmë. Edhe nëse shtypen, vazhdojnë të jetojnë në vetëdijen e njeriut dhe e kryejnë funksionin e vet.¹³³

Republika e Maqedonisë mund të jetë shembull shumë i mirë për bashkëjetesën në mes pjesëtarëve të konfesioneve të ndryshme fetare. Në vend ekziston tolerancë fetare, e cila është ndërtuar gjatë një periudhe të gjatë kohore. Besimtarët muslimanë dhe ato krishterë me rastin e festave urojnë njëri-tjetrit. Vlen të theksohet se të dyja palët respektojnë njëri-tjetrit edhe përsëri dallimeve fetare. Besimtarëve muslimanë asnjëherë nuk iu kanë penguar objektet fetare krishtere, kurse të krishterëve nuk iu kanë penguar objektet fetare islame (flitet për shumicën dërrmuese të besimtarëve muslimanë dhe atyre të krishterë).

¹²⁹ Po aty, fq. 41-42.

¹³⁰ Po aty, fq. 42.

¹³¹ Po aty, fq. 42-43.

¹³² “Закон за верските заедници и религиозните групи, Службен весник на РМ, 23 korrik 1997, Shkup.

¹³³ Pajaziti, A.(2002): Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia Universitare dhe religjioni (studim sociologjik), Sh.b. Logos-A, Shkup, fq. 43.

III.2.3 Projekti “Shkupi 2014”: Kontrovers dhe tendencioz

Pas vitit 2001, në periudhën 2002-2006, qeveria ka punuar në drejtim të relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike, kurse ardhja e OBRM-PDUKM-së (VMRO-DPMNE) në pushtet në mesin e vitit 2006 dhe që ka zgjatur deri në 2016, ishte një kthesë negative për Republikën e Maqedonisë, një frymë nacionaliste me ngjyrimet ortodokse që pretendonte etnizim të çdo sferë të jetës, dominim të kombit shumicë ndaj të gjitha elementeve të tjera kombëtare. Partia OBRM-PDUKM ishte ajo që hartoi planin e Projektit “Shkupit 2014”, projekt shumë kontrovers dhe tendencioz. Ky projekt u kritikua mjaft si në vend, ashtu edhe jashtë vendit, megaloman dhe që rrezikonte marrëdhëniet ndëretnike, ndërfetare dhe politike brenda vendit, ndërkohë rrezikonte edhe marrëdhëniet me Greqinë. Për t’u shënuar është heshtja e politikës shqiptare në Maqedoni, e cila në Parlament nuk ngriti zërin për ndaljen e këtij projekti kontrovers dhe tendencioz.

“Shkupi 2014” ishte një projekt që përfshin ndërtimin të përmendoreve të figurave të njohura nga historia maqedonase, të ndërtesave të mëdha në shërbim të pushtetit qendror dhe Qytetit të Shkupit, të gjitha në stilin barok. Pjesë e Projektit “Shkupi 2014” ishin edhe dy urat e reja mbi lumin Vardar: „Ura Syri“ dhe „Ura e Artit“.



Foto. 6. Disa objekte pjesë e Projektit “Shkupi 2014”.

Përmendoret e Metodija Andonov Çento, Mbretit Samoil dhe Justinianit të I-rë duhej të punohen nga mermeri, kurse të gjitha përmendoret e tjera në mes të cilave ajo e Goce Dellçevit, Dame Gruevit, e Gemixhinjve, Shën Kirilit dhe Metodi, Shën Klimentit dhe Naumit të Ohrit, luanët në urën “Goce Dellçev”, etj., të punuara nga bronzi. Plani përfshin edhe një kishë ortodokse e cila do mban emrin „Shën Konstantini dhe Elena“ dhe shtatoren e Lekës së Madh i hipur në kalin e quajtur Bukefal.



Foto. 7. Fontana e madhe dhe përmendorja e „Lekës së Madh të Maqedonisë“.

Projekti “Shkupi 2014” ngërthen edhe sheshin „Kryengritja e Karposhit“, fontanave në lumin Vardar, objekti i Teatrit të Vjetër në Shkup, Muzeu i Luftës Revolucionare të Maqedonisë, ndërtesën e Gjykatës Kushtetuese, Arkivit Shtetëror dhe Muzeut Arkeologjik, të gjitha këto në stilin barok.

Në hapësirën më të ngushtë të qendrës së Shkupit ka dhjetëra përmendore, prej tyre 15 janë dhuratë, tregon hulumtimi i BIRN-it. Ato formalisht nuk janë të paguara me para publike, por paraqitet lidhje në mes donatorëve dhe partisë e cila qëndron pas idesë së projektit “Shkupi 2014”. Në të njëjtën ditë, në të njëjtën seancë sillet vendim që të përkujtohen figura të caktuara të historisë maqedonase, pranohet donacion për përmendore të atyre figurave dhe caktohet këshilli për vendosjen e tyre, me lokacion të definuar, gjë që flet se vendosja e tyre paraprakisht është e përgatitur dhe më pas është pranuar nga shumica e këshillit të komunës Qendër që atëherë i takonte partisë në pushtet, VMRO-DPMNE-së.¹³⁴

Një hulumtim i BIRN Maqedoni¹³⁵ zbulon se çmimi i publikuar prej 80 milionë eurosh për t’i dhënë kryeqytetit të Maqedonisë një pamje antike, si duket është rritur në mbi 560 milionë euro. Çmimi për pamjen e re të Shkupit është rritur shtatëfish nga shuma e planifikuar fillimisht nga shkaku se është rritur edhe numri i monumenteve dhe ndërtesave që u ndërtuan. Kur fillimisht ishte publikuar plani për riorganizimin madhor të kryeqytetit në vitin 2010, projekti i njohur si “Shkupi 2014” parashihte ndërtimin e diku rreth 40 monumenteve, skulpturave, fasadave dhe ndërtesave të reja. Mirëpo, kur shihet në vitin 2015, numri i ndërtesave dhe

¹³⁴ Чаусидис, Т. (2017): Истражување на БИРН за проектот „Скопје 2014“, Скопје.

¹³⁵ Balkan Investigative Reporting Network – Macedonia.

monumenteve është trefishuar. Hulumtimi i BIRN dëshmon që ndërkohë edhe çmimi për pamjen e re të Shkupit është rritur, duke tejkaluar shumë çmimin e paralajmëruar në fillim prej 80 milionë euro, në diku në mbi 560 milionë euro.¹³⁶

Hulumtimi tetëmujor mbështetet në të dhëna të marrura përmes Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, fques zyrtare në internet të Byrosë së Prokurimit Publik, auditimit të Projektit “Shkupi 2014” dhe një raporti të përbashkët të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Komunës Qendër dhe Ministrisë së Kulturës, raport ky i prezantuar pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Hulumtimi mbulon më shumë se 130 objekte, që të gjitha të financuara me para publike dhe investitorë të cilave janë: Ministria e Kulturës, Byroja e Prokurimit, Komuna Qendër, Qyteti i Shkupit, si dhe shoqata dhe shoqëri aksionare ku shteti ka aksione. Dokumentet e marra nga BIRN tregojnë se më shumë se 260 subjekte juridike dhe persona fizikë kanë marrë pjesë në riorganizimin e pamjes. Dokumentet tregojnë që shumë prej tyre kanë marrë kontrata të shumta dhe kanë ndërtuar disa objekte dhe përmendore. Dokumentet gjithashtu, dëshmojnë se autorët janë shpërblyer me shuma të majme për dizajnet e tyre.¹³⁷

Për herë parë që nga promovimi zyrtar i Projektit “Shkupi 2014”, BIRN ka arritur të sigurojë kontratat e skulptorëve të cilat e kanë formësuar këtë projekt. BIRN ka siguruar qindra dokumente nga shumica e marrëveshjeve që e përbëjnë Projektin “Shkupi 2014”. Hulumtimi përfshin objektet e ndërtuara gjatë viteve të fundit që kanë pasur rol jetik në ndryshimin e pamjes së kryeqytetit. Ndërtesat e Filharmonisë, zyrat qendrore të kompanisë shtetërore të energjisë “ELEM”, Gjykatës Penale dhe Pallati administrativ dhe disa ndërtesa tjera ishin të fundit që u përfunduan në Projektin “Shkupi 2014”.

Shpenzimet e sigurimit dhe mirëmbajtjes vazhdimisht po thithin edhe më shumë fonde nga buxheti shtetëror. Një analizë e të dhënave të siguruara nga BIRN tregon që kompania ndërtimore “Beton” ka fituar shumicën e kontratave dhe ka ndërtuar shumicën e ndërtesave dhe skulpturave që formojnë “Shkupin 2014”. Kjo kompani ka fituar 163 milionë euro, një të tretën e parave të përgjithshme të shpenzuara në riorganizimin e qytetit të Shkupit nga projekti. Katër kompani tjera ndërtimore janë lojtarët e tjerë të mëdhenj, përkatësisht kompanitë “Granit”, “Strabag”, “Beton-Shtip” dhe “Bauer BG”.¹³⁸

Rreth 85 kontrata janë nënshkruar vetëm për Teatrin e Ri Kombëtar, përderisa për Muzeun e Luftës Maqedonase dhe VMRO janë nënshkruar 90 kontrata, fakte këto të zbuluara nga BIRN. Profilet e kompanive që tregojnë se kush qëndron mbrapa tyre, zbulohet në një hulumtim të posaçëm të BIRN për këtë çështje. Ministria e Kulturës dhe Byroja e Prokurimit Publik kanë shpenzuar më së shumti para në Projektin “Shkupi 2014”. Ata dëshmohen se janë investitorë në projektet e mëdha si Muzeu i Luftës Maqedonase dhe VMRO, Teatri Kombëtar, Gjykata Kushtetuese, Filharmonia dhe zyrat qendrore të Qeverisë të ridekoruara së fundmi. Sipas

¹³⁶ Jordanovska, M. (2015): Zbulohet çmimi i vërtetë i “Shkupi 2014”, BIRN Maqedoni, Shkup.

¹³⁷ Po aty.

¹³⁸ Po aty.

të dhënave nga dokumentet, objekti më i kushtueshëm i Projektit “Shkupi 2014” është objekti ku është gjenden Gjykata Kushtetuese, Muzeu Arkeologjik dhe Arkivi Shtetëror, vlera e të cilit arrin 42,89 milionë euro. Vetëm Filharmonia ka kushtuar 39 milionë euro, rreth 3 milionë euro më pak se tre objektet në fjalë. Poashtu, të dhënat tregojnë se Teatri Kombëtar ka kushtuar 37 milionë euro, para këto të shpenzuara në jo më pak se 85 kontrata të ndryshme.¹³⁹

Anekset e kontratave, kontratat shitesë, kontratat për punë ndërtimore të parapara dhe shumë kontrata të tjera kanë përbërë rrugën deri te ndërtimi i Muzeut të Luftës Maqedonase dhe VMRO-së. Sa i përket vetëm këtij objekti, Rrjeti Ballkanik i Reporterëve Hulumtues ka siguruar mbi 90 dokumente dhe marrëveshje të nënshkruara me njerëz dhe kompani të ndryshme. Në një konferencë për shtyp të mbajtur në 2013, Ministria e Kulturës, Elizabeta Kançeska-Milevska, kryetari i atëhershëm në largim i komunës Qendër, Vlladimir Todoroviq, dhe kryesuesi i Byrosë së Prokurimit, Vase Donevski, kanë thënë që shuma totale e Projektit “Shkupi 2014” arrin vlerën 207 milionë euro. Megjithatë, dëshmitë e dokumentuara të siguruar nga BIRN, tregojnë që shuma reale e projektit është më shumë se dyfishi i këtij çmimi. Tre autorët kryesorë që kanë marrë pjesë në projekt kanë fituar 4,7 milionë euro. Një nga misteret e këtij organizimi përveç çmimit final që vazhdon të rritet, janë edhe shumat e dhëna autorëve si pagesë për monumentet dhe skulpturat.¹⁴⁰

Kompania Neimar Inxhinering (Neimar Engineering), e cila ka numrin më të madh të kontratave të marra, vjen e dyta në radhë pas Valentina Stevanovskës, ngase është shpërblyer me kontrata për ndërtesa kyçe si Muzeu i Luftës Maqedonase, pallatit “Llazar Pop Trajkov”, Teatri Kombëtar dhe Porta Triumfale. Të dhënat nga Regjistri Qendror tregojnë që si pronarë të kompanisë Neimar Inxhinering janë Ana Kedeva-Petrova dhe burri i saj Zoran Petrov. Zonja Ana Kedeva është motra e kardiologut të njohur Sashko Kedev, kandidat për kryetar shteti nga radhët e VMRO-DPMNE-së në zgjedhjet presidenciale të vitit 2014. Kompania Neimar Inxhinering ka fituar kontrata në vlerë prej 1,1 milionë euro për Projektin “Shkupi 2014”.¹⁴¹

Zharko Çaushevski, një arkitekt i ri dhe kompania Arhitektonika, drejtor i së cilës është vetë ai dhe pronar i saj është vëllai i tij Nikolla, ka lënë gjurmët më të mëdha në fasadat të cilat kanë ndryshuar pamjen e Shkupit. Dizajni i Qendrës Tregtare të Qytetit të vitit 1970 me fasadë imituese të stilit barok, fasada e re e Qeverisë, zyrat qendrore të Ujësjiellësit të Shkupit dhe dizajnimi i ndërtesës administrative në rrugën Bihačka, të gjitha këto janë punë të vëllezërve Çaushevski. Dokumentet tregojnë që ata janë paguar mbi gjysëm milionë euro.¹⁴²

Dokumentet zbulojnë që autoritetet shtetërore u janë shmangur nënshkrimit të kontratave të veçanta me autorë, të cilat specifikisht do të zbulonin pagesat e tyre. Në vend të kësaj, ata kanë nënshkruar kontrata që kanë të bëjnë me punët ndërtimore që kërkohen për punim të skulpturave.

¹³⁹ Po aty.

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² Po aty.

Numrat kyç nga Projekti “Shkupi 2014” janë këto: 137 objekte të dokumentuara deri në vitin 2017, 32 investitorë, 146 ndërmarrje që kanë kryer punët ndërtimore, 9 fabrika ku janë punuar skulpturat në bronzë, 151 përzgjedhje ideore të autorëve dhe para të harxhuara për gjithë projektin mbi 684 milionë euro.

Synimet e VMRO-DPMNE-së ishin që përmes këtij projekti të propagandohet se, ajo është partia e vetme e cila kujdeset për interesat kombëtare të popullit maqedonas, se është mbrojtëse e vetme e historisë dhe ekzistencës së shtetit të Maqedonisë. Projekti në fjalë gjeneroi një atmosferë euforike tek një pjesë e popullit maqedonas, kurse nga ana tjetër objektiv real ishte qëndrimi në pushtet dhe pasurimi në mënyrë kriminele.

Hartimi dhe më pas miratimi i këtij projekti ndodhë gjatë periudhës 2006-2008, pra në kohën kur në qeveri është partia VMRO-DPMNE. Fillimet e punëve në Projektin “Shkupi 2014” nisin diku kah fillimi i vitit 2009, kur VMRO-DPMNE fiton shumicën e deputetëve në zgjedhjet parlamentare të vitit 2008. Ky projekt është realizuar për 9 vite.

Me Projektin “Shkupin 2014” u shkaktua ndarje në shoqëri, respektivisht si ndarje e parë ishte ajo rreth vetë projektit, në pjesën e popullsisë (përfshirë edhe atë etnike maqedonase) që e përkrahnin këtë projekt dhe grupin e popullsisë që me të madhe ishin kundër projektit në fjalë. Ndarje tjetër ishte ajo që kishte të bëjë me thellimin e urrejtjes në mes shumicës maqedone dhe popullsisë shqiptare. Edhe pse populli shqiptar njihet si kontribues i madh në buxhetin e shtetit, por pushteti gjatë periudhës së përmendur në mënyrë arbitrare i ka përdorur paratë për një projekt që kishte të bëjë kryesisht me historinë maqedonase. Ky projekt kishte karakter monoetnik, edhe pse Republika e Maqedonisë është shtet multietnik.

III.3 KOHA MODERNE – SENSI I PATRIOTIZMIT KOMBËTAR DHE TOLERANCA TEK SHQIPTARËT

III.3.1 Sensi i patriotizmit kombëtar tek shqiptarët

Patriotizmi zakonisht përkufizohet si dashuri ndaj vendit, atdheut, me apo pa histori. Fëmijët i duan prindërit jo pse janë të mençur dhe me vlera të jashtëzakonshme, por sepse janë fryt i tyre. Nuk duhet harruar faktin se fjala komb në latinisht ndërlidhet me dukurinë e lindjes. Rrjedhimisht e do nënën pse të ka lindur, e do atdheun ngaqë ke lindur aty, je pjesë e tij, ngjarjeve, traditës, dokeve, zakoneve, gjuhës, kulturës e kështu me radhë. Në njëfarë mënyre, patriotizmi është sikur besimi shekullar: sa më të zhvilluar dhe të qytetëruar janë popujt, aq më lojalë janë ndaj atdheut të tyre¹⁴³, ndonëse ka edhe tendenca planetariste, kozmopolitite, për qytetari të botës, që bine ndesh me nacionalizmat e ngushtë.

¹⁴³ Lili, Y. (2012): “Patriotizmi shqiptar”, *Panorama*.

Shikuar në kontekstin shqiptar, patriotizmi dhe nacionalizmi lexohet, përkthehet, trajtohet, ligjërohet dhe kumtohet në mënyra të ndryshme. Një pjesë në emër të moderimit rreken t'i japin konotacione dhe ngjyra folklorike deri në negative, e disa japin shpjegime dhe shembuj që hera-herës dalin jashtë temave të debatit, e ca të tjerë janë shumë më racionalë, por ato etiketohen si radikalë. Sidoqoftë, i rëndësishëm është fakti që mediat, oponionistët, intelektualët dhe botuesit, rastësisht apo qëllimisht, kanë filluar t'i shndërrojnë në debate shoqërore nocionet “patriotizëm” apo “nacionalizëm”.¹⁴⁴

Shqiptarët në tërësinë e tyre, në ndryshim nga disa kombe të tjera, dallojnë edhe në raport me qasjen ndaj patriotizmit dhe kombëtarizmit. Jugosllavia u shpërbë jo për shkak të patriotizmit apo kombëtarizmit, por për shkak të keqpërdorimit të tyre, që përmes gjuhës së urrejtjes, nacionalizmin e deformoi në shovinizëm. Në këtë kontekst, kombëtarizmi sllav është agresiv, pushtues, ekspansionist, apo ai grek është terrorizues dhe ofensiv, ndërkaq patriotizmi dhe kombëtarizmi shqiptar janë mbrojtës. Pothuajse në të gjitha etapat historike shqiptarët kanë mbajtur qëndrime patriotike, në funksion të mbrojtjes së identitetit dhe lirisë së tyre.¹⁴⁵

Janë patriotizmi dhe kombëtarizmi që i nxitën rilindësit tanë për shtetformim, falë patriotizmit, natyrisht mbrojtës, shqiptarët në ish-Jugosllavi i mbijetuan asimilimit dhe për të ardhur në ditët e sotme, rasti i luftës për liri dhe pavarësi në Kosovë, si dhe rasti i luftës në Maqedoni që ishte për shkak të fitim të drejtave themelore të popullsisë shqiptare të këtij shteti jostabil.

Sikundër sot e gjithë kohën shqiptarët demonstrojnë pjekuri maksimale duke mos lejuar deformimin e patriotizmit dhe kombëtarizmit, edhe pse politika i prish baraspeshat. Të reagosh dhe protestosh për gjuhën, simbolet, për të drejtat e patjetërsueshme për dinjitet dhe integritet, natyrisht që është një patriotizëm racional. Më konkretisht, shqiptarët e Maqedonisë, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës janë në dimensionin e mbrojtjes së identitetit të tyre kombëtar. Shikuar nga kjo pikëpamje, shqiptarët vazhdojnë të mbeten patriot dhe kombëtarë paçka se elitat politike tentojnë ta relativizojnë këtë fakt kokëfortë. Për sa kohë që të tjerët kanë tendenca uzurpuese, tjetërsuese, përvetësuese, mohuese ose terrorizuese, shqiptarët nuk mund të rrijnë duarkryq, padyshim se do të reagojnë, protestojnë, kontestojnë, madje do të veçohen edhe nga tone të ashpra patriotike, që nuk duhet të kalojnë në nacionalizëm ekstrem dhe shovinizëm.

Përveç periudhës së monizmit, ku “ideologjia e pafe e kuqe” sundoi patriotizmin duke e shndërruar atë në një doktrinë në funksion të një klike për të mbajtur gjallë frymën e sundimit, shqiptarët kanë dëshmuar dhe treguar në praktikë patriotizëm racional dhe funksional.

Nëse deri dje shumë çështje edhe dashuri ndaj atdheut dhe kombit janë trajtuar si tabu, tashmë ndodhemi në një tjetër kontekst krejtësisht tjetër. “Vetëvendosja” me tezën për bashkim kombëtar doli si subjekt fitues në zgjedhjet parlamentare të Kosovës.

¹⁴⁴ Po aty.

¹⁴⁵ Po aty.

III.3.2 Toleranca fetare tek shqiptarët

Shkencëtarët, studiuesit e sociologjisë politike dhe të fesë, qofshin të huaj apo vendës, përdorin terma të ndryshme lidhur me tolerancën. Historianët e fesë dhe teologët flasin për “ekumenizëm ndërfitar”. Njohësit e mesjetës dhe etnologët përdorin termin “konvergjencë ndërfitare”. Sociologët dhe historianët sekularë priren nga termat “tolerancë”, “bashkëjetesë” apo “harmonizim fetar”.¹⁴⁶

Vlen për të theksuar që në fillim se ndjenja për besim në një fuqi absolute të quajtur Zot, ka qenë pjesë shpirtërore e njeriut që nga momentet e para të daljes së tij mbi sipërfaqen e tokës. Kjo ndjenjë është dhe do të vazhdojë të jetë e pranishme pandërprerë te njeriu. Historia nuk njihet njerëz të cilët nuk kanë besuar në fuqi absolute, të cilën e kanë definuar dhe emëruar këtë dukuri sipas shkallës së akceptimit të tyre.¹⁴⁷

Me zgjedhjen e të dërguarve nga Zoti dhe librave hyjnore-qiejlore njerëzit u ftuan që të besojnë në besim të drejtë – në Një Zot – monoteizëm. Ithtarë të këtyre të dërguarve dhe librave janë sot ithtarët e tri feve të mëdha monoteiste në botë: islamit, krishterizmit dhe judaizmit. Përmes librave hyjnore njeriu gjithnjë është ftuar që të jetë në shkallën e duhur të dëgjimit, nënshtrimit, si dhe të zbatimit të porosit të Zotit, në mënyrë që të jetojë në dashuri, mirëqenie, në paqe dhe liri me vetveten, familjen, rrethin dhe shoqërinë njerëzore në përgjithësi.¹⁴⁸

Toleranca dhe barazia janë fryt i njohjes hyjnore në formën e saj të dëlirë. Zoti na ka pajisur qëllimisht me arsye dhe njohuri, në mënyrë që të kuptojmë vetveten dhe rolin tonë në shoqërinë njerëzore, dhe si rrjedhojë e kësaj të zhvillojmë marrëdhënie njerëzore të bazuara në tolerancë dhe në barazi. Larmia, ndryshueshmëria dhe llojllojshmëria e njerëzve është një akt i qëllimshëm i Zotit për njohjen dhe afrimin e pjesëtarëve të këtij lloji mes vete, e jo për të treguar ose për të shprehur urrejtje ndaj njëri-tjetrit në baza racore, fisnore apo edhe fetare. Kjo gjë theksohet edhe në Kur'an: *“O ju njerëz, vërtetë Ne u krijuam juve prej një mashkulli dhe prej një femre, ju bëme popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete. Ndërsa më i ndershmi ndër ju është ai i cili më së shumti ka frikën e Zotit. Zoti është i gjithëdijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”*(49:13). Bazuar në këtë citat kur'anor gjeneza njerëzore ka vetëm një burim dhe vetëm një Krijues – Zotin. Ndarja në fise, etnitete e popujtë ndryshëm është zgjedhje dhe vullnet i Zotit për njerëzit, andaj si e tillë duhet pranuar dhe respektuar nga të gjithë. Dhuna në fe nuk duhet të ekzistojë në bazë të librit hyjnor, Kur'anit.¹⁴⁹

Shqiptarët janë ndër popujt më të vjetër jo vetëm të gadishullit ballkanik, por edhe të Evropës. Ata ndër shekuj janë ballafaquar me probleme, sociale, kulturore, ekonomike dhe politike, por gjithnjë kanë kultivuar një tolerancë ndërfitare brendashqiptare, por edhe ndaj të

¹⁴⁶ Hamiti, Xh. (2009): Toleranca fetare dhe shqiptarët, ligjëratë e mbajtur në Universitetin e Vjenës – Fakulteti i së Drejtës dhe Filozofisë, telegrafi.com.

¹⁴⁷ Po aty.

¹⁴⁸ Po aty.

¹⁴⁹ Po aty.

tjerëve kanë kultivuar tolerancë shembullore. Kjo tolerancë mbështetet në vetëdijen kombëtare për faktin se të gjithë shqiptarët të të gjitha besimeve janë të një gjaku dhe të një gjuhe, kanë origjinë, truallin dhe traditën e përbashkët. Populli shqiptarë me dy besime, islam dhe krishterë (ortodoks dhe katolik), ka qenë simbol i harmonisë fetare në historinë e popujve të Ballkanit. Vetë ekzistenca e objekteve të kultit, respektivisht xhamive, kishave dhe manastireve, simbolizon të kaluarën e popullit shqiptar. Bashkëjetesa në harmoni e besimeve fetare në trojet shqiptare përgjatë historisë e deri më sot, është shembull dhe dhurata më e mirë e brezave të shkuar për ne sot dhe për ata që do të vijnë pas nesh. Trashëgimia e bashkëjetesës fetare njëkohësisht me vetëdijen se ideja kombëtare qëndron dhe duhet të qëndrojë mbi çdo ide tjetër, është dhurata më e çmuar që ne si komb e kemi.¹⁵⁰

Për shqiptarët toleranca shkon deri në atë masë, saqë të gjitha diskutimet e të tjerëve rreth saj, ndiqen me një lloj indiferentizmi dhe moskokçarje, e cila herë-herë është keqinterpretuar. Jo rrallë herë, studiues të ndryshëm, kur analizojnë dukurinë e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare ndër shqiptarë, e trajtojnë atë përciptaz ose tërthorazi.

Kulturën e tolerancës, shqiptarët e ekspozuan po me të njëjtin përkushtim si vlerë të tyre, kudo që jetuan, madje edhe jashtë vendit. Federata shqiptare “Vatra” në SHBA, megjithëse pjesa më e madhe e anëtarëve të saj ishin të besimit ortodoks, kishte për kryetar një musliman. Rasti unik dhe i pazakontë për opinionin atje, ndodhi kur në krye të saj erdhi protestanti Kristo Dako, ndërkohë që asnjëri nga anëtarët e saj nuk i përkiste kishës protestante.¹⁵¹

Modeli i qeverisë së parë shqiptare pasqyroi edhe realitetin e bashkëjetesës fetare. Rëndësia e ruajtjes së baraspeshës të besimeve fetare në politikën dhe diplomacinë shqiptare nuk mund të nënvlerësohet. Si një vazhdimësi konstante kjo u pasqyrua edhe statutin e Lushnjës. Në njërin nga nenet e tij merreshin në mbrojtje edhe besimet fetare: “Shqipëria njeh dhe mbron baraz, synizëm, bektashizëm, ortodoksizëm dhe katolicizëm”. Zgjedhja e Këshillit të Lartë të Regjencës si organ ekzekutiv në Kongresin e Lushnjës më vitin 1920, i përbërë nga katër anëtarë të komuniteteve fetare kryesore, si një dimension i rëndësishëm për formimin e organeve të shtetit shqiptar, ishte një rikonfirmim i netit të lartpërmendur.¹⁵²

Mirëkuptimi fetar, si pjesë e kulturës shqiptare me një dimension të gjerë shoqëror, paraqet një strukturë të qëndrueshme si një sistem vlerash, pjesë e traditës shekullore. Mungesa e fanatizmit fetar është traditë e hershme. Këtë realitet historik Faik Konica e shpreh kështu: “Unë besoj se dihet gjithkund që shqiptarët janë tolerantë për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare”.¹⁵³

Shkaqet e grindjeve, përçarjeve, kacafytjeve, luftërave me bazë kombëtare, racore, fetare etj., janë rezultat i injorancës, zemërngushtësisë dhe fanatizmit të tepruar, e kurrësi element

¹⁵⁰ <https://portalb.mk/448750-toleranca-fetare-te-shqiptaret/>

¹⁵¹ Basha, A. (2005): *Nëpër gjurmët e islamit*, Tiranë, fq. 543.

¹⁵² Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, *Historia e Shqipërisë, vëllimi III*, Tiranë, 1984.

¹⁵³ Konica, F. (1993): *Shqipëria kopshti shkëmbor i Europës Juglindore*, *Marin Barleti*, Tiranë, fq. 431.

natyral i vetë qenies së njeriut. Shqiptarët falë predikimeve të drejta të prijësve të tyre fetarë, që herët i kishin kuptuar këto fakte të rëndësishme hyjnore duke kuptuar fenë si vlerë shpirtërore të çdo njeriut e jo si një element përçarës, kanë krijuar një frymë të veçantë harmonie mes besimeve. Si rrjedhim në analet e historisë shqiptare asnjëherë nuk është shkaktuar ndonjë konflikt në baza fetare siç ka pasur raste të tilla drastike në të kaluarën në Evropë dhe në disa vende të Azisë.¹⁵⁴

Kjo vetëdije ka ndikuar fuqishëm në kohezionin kombëtar në përmasa më të gjëra dhe ka mobilizuar popullin shqiptar gjatë historisë për t'iu bërë rezistencë përpyekjeve të vazhdueshme të të huajve që ta përçajnë dhe ta sundojnë atë. Se sa e fortë ishte dhe vazhdon të jetë tolerance fetare mes shqiptarëve tregon një dukuri e rrallë dhe e pashoqe në Ballkan. Fjala është për familjet e përziera për nga besimi, për familjet që jetojnë së bashku në një shtëpi dhe që kanë çdo gjë të përbashkët përveç fesë, sepse një pjesë e saj janë muslimanë, e pjesa tjetër katolikë. Familje të tilla ka pasur dhe ende ka në Has, Rugovë, Dushkajë të Gjakovës, në Lug të Baranit, Suharekë, Karadak dhe në shumë zona tjera të Kosovës dhe Malësisë.¹⁵⁵

Në këtë kontekst vlen për tu theksuar kontributi jashtëzakonisht i prijësve fetarë. Ata asnjëherë në predikimet dhe shkrimet e tyre nuk lënduan pjesëtarët e besimeve tjera ndër shqiptarë. Hafiz Ibrahim Dalliu, hoxhë, studiues dhe komentues shumë i njohur i Kur'anit në gjuhën shqipe gjatë viteve të '30-ta, në lidhje me bashkëjetesën ndërfitare nënvizonte: “Na shqiptarët prej çdo feje qofshin jemi te tanë vëllezër gjaku dhe vëllezër vatani. Do të shkojmë mbarë e mirë shoq me shoq si jemi tue shkue, do të punojmë së bashku në lulëzimin e atdheut tonë, dhe do të mbrojmë atë me gjakun tonë”.¹⁵⁶

Në shtypin islam të viteve të '30-ta në lidhje me tolerancën dhe respektin e ndërsjelltë shqiptar shkruhej: “Feja është një institut që vëllazërimin e ka parim themelor, e kur ajo bie në shkallë sa bëhet vegël anarkie për të përçarë një popull, nuk është më fe, por është shoqëri politike e fshehur nën maskën e fesë, është një fe deformuese”.

Faik Konica në shkrimet e tij për tolerancë fetare ndër shqiptarët thoshte: “Unë besoj se shqiptarët gjithkund janë tolerantë për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare”. Sami Frashëri në lidhje me tolerance fetare shkruan: “Ndarjet në besim nuk sollën çarje në mes të shqiptarëve. Gjendjet e besimit, jo vetëm në vendet e lindjes, por edhe në Evropë, e në vendet e ndriçuara me qytetërim, shumë herë kanë nxjerr vrasje të mëdha të tmerruara. Në Shqipëri, këto grindje nuk ndihen dhe kurrë në këtë vend s'kanë ngjarë”. Ndërsa Tomas W. Arnold nënvizonte: “Muslimanët shqiptar, sikur edhe të krishterët flasin me një gjuhë, kanë traditat dhe moralin e njejtë, nuk kanë fare urrejtje, sepse me gjenerata nuk kanë pasur armiqësi. Faktori fetar nuk ka qenë shkak për përçarje”.¹⁵⁷

¹⁵⁴ Hamiti, Xh. (2009): Toleranca fetare dhe shqiptarët, Ligjëratë e mbajtur në Universitetin e Vjenës – Fakulteti i së Drejtës dhe Filozofisë, telegrafi.com.

¹⁵⁵ Po aty.

¹⁵⁶ Po aty.

¹⁵⁷ Po aty.

Veçori tipike e shoqërisë dominante islame ndër shqiptarët, është se ajo nuk u zhvillua duke mohuar apo shkatërruar shoqëri dhe bashkësi paralele me të. Ajo realisht edhe sot jeton përkrah tyre, gjallëroi dhe lulëzoi në klimën e bashkëjetesës duke zhvilluar identitetin e sajë në harmoni dhe liri.

Harmonia dhe toleranca fetare e shqiptarëve si vlerë thuajse unike kombëtare fetare, u formua nëpër shekuj, paralelisht me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, nën kujdesin e veçantë të rilindësve tanë dhe në kushte specifike, të ndryshme nga kombet e tjera në Ballkan. Kemi shembuj të shumtë të tolerances fetare në të kaluarën ndër shqiptarë të dy besimeve, që nuk mund t'i gjesh askund tjetër në Evropë. Shembuj që kanë lënë gjurmë edhe në ditët e sotme.¹⁵⁸

Të qenët e shqiptarëve me shumicë të besimit muslimanë, tregon dy gjëra shumë me rëndësi për historinë e kombit shqiptar. E para është se, në mesin e shqiptarëve nuk ka pasur dhunë fetare me rastin e islamizimit të tyre. Dhe e dyta është se, kjo tolerancë fetare te shqiptarët i ka bërë shqiptarëve muslimanë, sepse askund në histori, te shqiptarët nuk hasen akte dhune ndaj pjesëtarëve të besimit krishterë e bërë nga muslimanët si shumicë në trojet shqiptare.¹⁵⁹

Shqiptarët, me dukurinë e tolerancës fetare të trashëguar ndër shekuj nga antikiteti dhe mesjeta, përbëjnë një përvojë interesante për botën dhe një dimension të veçantë kulturor. Hapësira shqiptare e ndodhur në kryqëzimin e rrugëve që lidhin Lindjen dhe Perëndimin, kaloi një pjesë të madhe të historisë së saj nën perandoritë e mëdha të botës: Perandorinë Romake, atë Bizantine dhe atë Osmane. Natyrisht, secila prej tyre pati ndikim në historinë e shqiptarëve. Por, si muslimanët ashtu edhe të krishterët, asnjëherë nuk e kanë vendosur në diskutim identitetin e tyre të vetëm dhe të përbashkët, pra atë shqiptar. Me plotë të drejtë, shumë studiues dhe historian, i cilësojnë marrëdhëniet ndërfetare, si pasuri kombëtare të shqiptarëve. Tek shqiptarët, tradita ndërfetare dëshmon se horizontet e kulturës dhe të civilizimit zgjerohen atëherë kur secilit i jepet vendi dhe hapësira e nevojshme për të qenë pjesë sado e vogël e këtij mozaiku shumë të bukur.

Dialogu ndërfetar është forma e duhur dhe një përgjigje korrekte ndaj pluralizmit fetar, jo vetëm në situatë konflikti. Ai paraqitet nga domosdoshmëria për të kuptuar se njerëzit vijnë nga tradita fetare të ndryshme, për të kontribuar në ndërtimin e paqes shoqërore dhe nxitjen e respektit të ndërsjelltë. Pluralizmi fetar nuk është burim konflikti, por intolerance në formë dogmatizuese dhe fantike formon terrenin e nevojshëm për keqkuptime dhe urrejtje.¹⁶⁰

Si përfundim mund të themi se çështjet fetare në hapësirat shqiptare janë të lidhura ngusht me sigurinë tonë kombëtare. Prandaj ruajtja e vlerave kombëtare e fetare të shqiptarëve është një obligim i shqiptarëve kudo që ndodhen, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malë të Zi, Luginë të Preshevës dhe në Çamëri, si dhe në diasporë.

¹⁵⁸ <https://portalb.mk/448750-toleranca-fetare-te-shqiptaret/>

¹⁵⁹ Po aty.

¹⁶⁰ Merdjanova, I & Brodeur, P. (2009): Religion as a Conversation Starter Interreligious Dialogue for Peacebuilding in the Balkans, *Continnum*, New York, fq. 4.

PËRFUNDIME

Sistemi i “miletit” është një sistem i instaluar nga Perandoria Osmane në shekullin e XV dhe që ka qenë në fuqi deri në fillim të shekullit XX, i cili përcaktonte me ligj statusin e pakicave jomuslimane dhe pavarësinë e bashkësive fetare. Gjatë ekzistencës së saj 600 vjeçare, Perandoria Osmane u zhvillua në një sistem shtetëror shumë besimesh, ku sistemi i “miletit” përbënte sistemin ligjor të statusit të secilës bashkësi të veçantë fetare dhe të të gjithë jomuslimanëve në bazë të të drejtës islamike. Domethënë miletet ishin formuar në bazë të feve dhe jo sipas përkatësisë kombëtare të popullsisë.

Perandoria Osmane nuk e ka njohur kuptimin modern për kombin. Organizimi i jetës së përgjithshme në Perandorinë Osmane është bazuar kryesisht në aspektin fetar, njësoj sikur që ishte praktikë edhe në Perandorinë Bizantine. Duke u nisur nga ideja qendrore për bashkësinë (xhematin), sulltani gjatë udhëheqjes është konsultuar me shoqëritë e zanateve (esnafet) ose me bashkësitë fetare (miletet), të cilat e kanë përbërë bazën e jetës shoqërore në perandori.

Fjala *milet* rrjedh nga gjuha arabe apo kur'anore dhe shënjon bashkësinë fetare, përkatësinë fetare, kurse sot ka marrë kuptimin e asaj që në civilizimin perëndimor quhet „komb“. Pakicat e njohura ligjërisht ishin të organizuara si milete sipas përkatësisë së tyre fetare. Ky sistem u garantonte këtyre grupeve fetare disa të drejta, në mënyrë që ata të rregullonin vetë çështjet e tyre fetare. Nënshetësit hebraitë dhe të krishterë quheshin sipas të drejtës islamike *dhimmi* që do të thotë „të mbrojtur“. Me çështjet dhe konfliktet që prekin si nënshetësit muslimanë ashtu edhe ata krishterë, merrej e drejta islame e njohur si „Sheriati Islam“.

Deri në shekullin e XIX ekzistonin vetëm tre milete (bashkësi fetare) të njohura nga osmanët: bashkësia fetare greke, ajo armene dhe ajo hebraike. Gjatë periudhës së Tanizamit (1839-1876) numri i mileteve ariti në 17, ku pjesë bënin edhe bashkësi konvertuesish nga kishat e ndryshme kombëtare të lindjes (protestantë dhe të bashkuar me Romën). Miletet gëzonin të drejta familjare dhe private, dhe të njëjtat etnitete udhëhiqeshin nga autoriteti fetar përkatës. Ata nxirrnin ligje dhe caktonin taksa brenda sferës së kompetencave që kishin. Këtu ata duhej të ishin besnikë ndaj Perandorisë Osmane.

Nga fillimi i shekullit XIX, Perandoria Osmane ishte vetëm hija e vetvetes. Trazirat e brendshme politike dhe sociale, disfatat ushtarake dhe ndikimi gjithnjë e më i madh i shteteve të fuqishme evropiane, e kishin keqësuar në masë të madhe gjendjen e jetës sociale të popullsisë në Perandorinë Osmane. Fuqia në rritje e botës krishtere dhe idetë e Revolucionit Borgjez Francez, tek nënshetësit krishterë të Perandorisë Osmane shkaktuan një valë pakënaqësish.

Këndvështrimi i sistemit të “miletit” nga ana fetare ndryshoi për njerëzit, duke kaluar në një identitet të ndjerë si pakicë kulturore, pikëpamje kjo që përputhej me idetë e politikanëve evropianë (kjo problematikë ra në një kohë kur në Evropë po lindte kombëtarizmi), ku si pasojë

politika ishte përqendruar tek dhënia e të drejtave të veçanta për pakicat sipas saj “të shtypura jomuslimane”. Në këtë mënyrë bashkësitë fetare, të cilat ishin integruar në konceptin e shtetit osman nën termin e mileteve, ushndërruan në pakica kombëtare të disfavorizuara nga ana sociale që duheshin mbrojtur.

Pas rënies së Perandorisë Osmane, republika e re laiciste (jo fetare) i dha fund Sistemit të Miletit, duke refuzuar përkatësitë kombëtare pos asaj turke. Megjithatë sistemi i miletit ende është aktual: studiuesi grek Tsitselikis e përdor shprehjen “neo-milet” që konsiston në sistemin e mbrojtjes së pakicave që i mban gjallë ndarjet ligjore paramoderne të bazuara në fe dhe i shfrytëzon ato bashkë me qytetarinë moderne.¹⁶¹

Sistemi i Miletit ishte një sistem i cili ekzistoi një kohë shumë të gjatë dhe ishte një sistem i mirë që garantonte disa të drejta dhe liri bashkësive fetare që jetonin në Perandorinë Osmane. Realisht Sistemi i Miletit ishte funksional në Perandorinë Osmane gjatë një periudhe 600 vjeçare, mirëpo, ky sistem mund të jetë praktikë vetëm sa i përket të drejtave fetare, por gjithsesi se me të nuk sigurohen të drejtat kombëtare dhe gjuhësore (etno-linguistike). Në shoqëritë e sotme, pakicat duhet të gëzojnë jo vetëm të drejta dhe liri fetare, por duhet t’i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë që realisht ju takojnë atyre. Sistemi demokratik është një sistem me të cilin garantohen të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut, pra si populli shumicë, poashtu edhe pakicat i gëzojnë të drejtat dhe liritë që iu takojnë, qoftë ato private apo shoqërore.

E kaluara e përbashkët disashekullore ka bërë që shqiptarët t’i perceptojnë turqit “si pjesë e jona”, kurse veten si pjesë e qenies osmane, si “komunitet i integruar në Perandorinë Osmane”, kurse të tjerët sllavët dhe popujt e tjerë t’i identifikojnë shqiptarët si “dorë e zgjatur e Turqisë”, madje Shqipërinë ta cilësojnë si Turqie Vogël ose “ishulli islamik i Ballkanit”. Puna shkon deri atje sa shqiptarët muslimanë, edhe nga vetë greqishtfolësit shqiptarë, të cilësohen si turq, siç tregohet në një reportazh lidhur me Himarën. Bashkësia shqiptare e ka shfrytëzuar mundësinë e inkuadrimit në hierarkinë drejtuese të shtetit osman, kështu që shqiptarët kanë dhënë shejhu-islam, komandantë eminentë, poetë e shkrimtarë të famshëm, sadr-i azemë, vezir e valinj, madje edhe rektorin e Universitetit të Stambollit (Daru’l-funun), eruditin hoxhë Hasan Tahsini.¹⁶²

Individët me prejardhje shqiptare janë bërë pjesë e pandashme e historisë dhe kulturës osmane dhe turke. Mehmed Akif Pejani, autor i Safahatit (Fletë) e himnit kombëtar turk, dhe Sami Frashëri (Shemsedin Sami), i cili në vitin 1898 ka shkruar një sërë artikujsh lidhur me rindërtimin e turqishtës dhe i cili në vitin 1899 përgatiti fjalorin e parë shpjegues të turqishtës, Kamusu’t-turki, ndërkohë edhe përfaqësues i parë i nacionalizmit turk dhe i lëvizjes osmaniste. Që të dy kanë mbetur si figura më emblematike të historisë osmane dhe Perandorisë Osmane.¹⁶³

¹⁶¹ Tsitselikis, K.. (2012): Aspects of Legal Communitarianism in Greece: Between Millet and Citizenship. Oñati Socio-legal Series [online], 2 (7), 106-118. Akses në: <http://ssrn.com/abstract=2050345>, vizituar më 1 janar 2019.

¹⁶² Pajaziti, A. (2018): Turku fatal: mes kujtesës dhe interesit, Opinion/analizë, Shkup.

¹⁶³ Po aty.

Fletët Mehmed Akif Pejani, që konsiderohet "bilbili i islamit" dhe simboli i mendimit islam të një periudhe, janë interpretim i së kaluarës dhe i së ardhmes dhe asnjëherë nuk do ta humbin vlerën, sepse janë shkruar me shpirt, janë poezi konstruktive e jokonformiste. Ai është ideator i solidaritetit social organik, i ekulibrit social të bazuar në një *modus vivendi* islamik, është ummetist, antidespotist, është kundër depersonalizimit dhe desocializimit.¹⁶⁴

Edhe njeriu i pavarësisë shqiptare, Ismail Bej Qemali, përkundër asaj që tek opinionin më i gjerë njihet si kundërshtar dhe armik i shtetit osman, gjatë tërë jetës së tij ka shërbyer shtetit të madh osman.¹⁶⁵

Shqiptarët si popull më i vjetër në Ballkan, si gjatë kohës së Perandorisë Osmane, por edhe në periudhat më pas, janë shembull mjaft i mirë për tolerancën fetare. Ndonëse përkatës të besimeve të ndryshme, ata kanë bashkëjetuar në harmoni duke treguar tolerancë e respekt ndaj njëri-tjetrit. Muslimanët, ndonëse shumicë në trojet shqiptare, në maksimum janë tolerantë ndaj pakicës ortodokse dhe katolike. Asnjëherë nuk ka pasur konflikt në mes tyre, gjithmonë kanë jetuar në raporte dhe ndërveprim korrekt dhe njerëzor. Kombi ka qenë si urë bashkuese në mes shqiptarëve muslimanë, ortodoksë dhe atyre katolikë.

Siç është e njohur, muslimanët e Ballkanit për një shekull jetojnë nën tryzni. Ata përbëjnë konceptin kyç të "tjetrit" për kombet e reja ballkanase. Pas vitit 1913 e deri më sot, shqiptarët kanë jetuar në shtete dhe regjime të ndryshme, duke u ballafaquar me sfida madhore për ruajtjen e kodit autentik të identitetit kombëtar dhe fetar.¹⁶⁶

Shoqëritë ballkanike kanë nevojë për një sistem të ngjashëm si ai i milletit që do të krijonte një klimë multikulturaliste dhe integruese, të ndryshme nga ajo e ballkanizimit dhe nacionalizmave vrasarë që e kanë shënuar fundin e shekullit XX, kur u shënuar një faqe e zezë në historinë e këtij gadishulli. *Pax Ottomana* dhe refleksionet e saj janë çështje që meritojnë analiza më të thella dhe objektive. Institutet e ndryshme të historisë ato ballkanike duhet t'i hyjnë në palcë kësaj çështjeje, këtij agjenti të rëndësishëm të kulturës osmane.

Bashkësitë fetare të sodit mund t'iu ndihmojnë shumë atyre politike, kombeve në jetësimin e frymës së tolerancës, të qasjes më liberale ndaj dallimeve-diversitetit të të gjitha llojeve. Shkurt e shqip, sistemi i milletit është një shkollë historike të cilës çdo shoqëri mund t'i referohet për ndihmë lidhur me organizimin shoqëror, e në veçanti në këto kohëra të ekstremizmave dhe antagonizmave etnocentrike, të tendencave për përjashtim të tjetrit dhe tjetërsisë.

Fetë sikurse civilizimet kanë ulje-ngritjet e tyre. Marrëdhëniet mes tyre ngjasojnë me ato të qytetërimeve, në këmbime, solidaritet, bashkëekzistencë dhe kontradita. Historia ka njohur një mpleksje kontradiktore me asaj që predikojnë fetë dhe ndjekësve të saj. Kjo mospërputhje midis

¹⁶⁴ Pajaziti, A. (2015): Shoqëri-Ndërtimi në opusin letrar të Mehmet Akif Ersojit, EBSCO Information Services.

¹⁶⁵ Pajaziti, A. (2018): Turku fatal: mes kujtesës dhe interesit, Opinion/analizë, Shkup.

¹⁶⁶ Po aty.

pacifizmit të doctrines fetare dhe militantizmit të praktikimit të fesë nga ndjekësit e saj, është një realitet i pakontestueshëm, por jo dhe një burim i madh keqkuptimi. Është e rëndësishme diferenca midis fesë si mënyrë jetese e përcaktuar në doctrine dhe fetarizmit si formë sjellje e perceptuar individualisht.

Në disa raste ndarja e fesë nga politika nuk ka mjaftuar për të garantuar influencën e tyre tek njëra-tjetra. Instrumentalizmi i fesë nga politika apo anasjelltas është ndërthurje që sjell kaos për shkak të modelit të deformuar që formon. Feja, sipas doktrinës së saj, është një mënyrë e të jetuarit sipas rregullave dhe kanoneve të pandryshueshme për shkak të burimit të tyre, ndërsa politika ekziston dhe realizohet nëpërmjet njerëzve si një veprimtari shoqërore e kolektive dhe ndryshon sipas interesave që përfaqëson.

Megjithëse të gjitha fetë kanë në zanafillën e tyre përhapjen e paqes mes njerëzve, marrëdhëniet mes tyre jo gjithnjë kanë qenë paqësore. Historiku i këtyre marrëdhënieve transmeton mes tjerash perceptimin që fetë kanë shfaqur ndaj njëra-tjetrës në kohë të ndryshme, ku jo gjithmonë kërkimi i të vërtetës dhe paqja kanë qenë qëllim. Kurba e marrëdhënieve islamo-krishtere me ulje-ngritjet e saj, ka kaluar një process dialogu teologjik e institucional të gjatë e të ndërlikuar.

Dialogu nga këndvështrimi fetar është obligim hyjnor. Dialogu ndërfaqësor është forma e duhur dhe një përgjigje korrekte ndaj pluralizmit fetar, jo vetëm në situatë konflikti. Ai lind nga domosdoshmëria për të kuptuar se njerëzit vijnë nga tradita fetare të ndryshme, për të kontribuar në ndërtimin e paqes shoqërore dhe nxitjen e respektit të ndërsjellë. Pluralizmi fetar nuk është burim konflikti, por intoleranca në formë dogmatizuese dhe fanatike, formon terren të nevojshëm për keqkuptime dhe urrejtje.

Diversiteti kulturor meriton të shihet si një vlerë pozitive. Problemi i vërtetë nuk qëndron brenda qytetërimeve, por në faktin se nuk i japin vetes mundësinë për të komunikuar dhe kuptuar njëri-tjetrin. Njohja dhe vlerësimi real i diferencave midis njëri-tjetrit ul mjaft keqkuptimet, mosbesimin dhe i hap rrugën një dialogu human larg tendencave dominuese.

Toleranca kombëtare, fetare dhe kulturore tek shqiptarët dhe popujt e tjerë ballkanik mund të arrihet vetëm përmes njohjes më të mirë ndërmjet tyre dhe shuarjen e paragjykimeve që kanë për njëri-tjetrin. Për të pasur tolerancë ndërmjet popujve në ballkan më se e rëndësishme është që liderët fetar dhe politikë të japin mesazhe për paqe dhe harmoni të ndërsjellë, të ndalohet gjuha e urrejtjes në baza fetare dhe kombëtare, përmes konferencave të ndryshme të arrihet ofrimi dhe njohja e pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare dhe kombëtare, organizimi i aksioneve humanitare nga kleri fetar dhe politikë me qëllim ofrimin e ndihmës grupeve të marginalizuara të shoqërisë etj. Ngritja mirëbesimit, tolerancës dhe respektit të ndërsjellë është punë shumë e rëndësishme që vazhdimisht duhet t'i kushtohet kujdes, pasi që vetëm ashtu mund të arrihet paqja dhe harmonia midis grupeve të ndryshme kombëtare e fetare.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

1. Ajid, S. (2005): Të drejtat e jomuslimanëve në shtetin islam, Sh.b. Logos-A, Shkup.
2. Barkey, K. (2008). *Empire of Difference: The Ottomans in Comparative Perspective*, Cambridge University Press.
3. Basha, A. (2005): Njëpër gjurmët e islamit, Tiranë.
4. Berisha, A. (2011): Toleranca osmane dhe të krishterët, *Ditura Islame*.
5. Boshkoski, M., Ilioski, J. Dervishi, N. (2016): Historia për klasën e VII, Prosvetno Dello, Shkup.
6. Braude, B. (2014): Christians and Jews in the Ottoman Empire, Lynne Rienner Publishers.
7. Çakir, C. (2014): Civilizimi Osman - Politikë•Ekonomi•Art, Sh.b. Logos-A, Shkup.
8. Чаусидис, Т. (2017): Истражување на БИРН за проектот „Скопје 2014“, Скопје.
9. Frashëri, S. (2009): Qytetërimi Islam, Sh.b. Logos-A, Shkup.
10. Grup autorësh (1996): Historia e popullit shqiptar, Instituti i Historisë dhe Akademia e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë.
11. Hasanoviq, B. (2000): Ilmuddin, Sh.b., Furkan ISM, Shkup.
12. Hamiti, Xh. (2009): Toleranca fetare dhe shqiptarët, ligjëratë e mbajtur në Universitetin e Vjenës – Fakulteti i së Drejtës dhe Filozofisë, telegraf.com.
13. Иванов, Ѓ. (2004): Милетскиот систем-модел на религиозна толеранција, Политичка мисла, Институт за демократија, солидарност и цивлно општество, Скопје.
14. Yilmaz, I. “Diversity, Legal Pluralism and Peaceful Co-Existence in the Ottoman Centuries”, *SSRN Electronic Journal*, shkurt 2013.
15. Jahja, H. (2014): Islami dënon terrorizmin, Alb-Books, Tiranë.
16. Jordanovska, M. (2015): Zbulohet çmimi i vërtetë i “Shkupi 2014”, BIRN Maqedoni, Shkup.
17. Kurtaran U. (2011). “Osmanli İmparatorluğu’nda Millet Sistemi”, Journal of the Institute of Social Sciences 8- 2011.
18. Konica, F. (1993): Shqipëria kopshti shkëmbor i Europës Juglindore, *Marin Barleti*, Tiranë.

19. Krasniqi, M. (2017), “Gjenocidi kundër muslimanëve të Perandorisë Osmane i fshehur rreth 100 vjet”, *Res Publica*.
20. Lili, Y. (2012): Patriotizmi shqiptar, *Panorama*, Tiranë.
21. Mc Carthy, J. (2015). *Vdekje dhe dëbim-Spastrimi etnik i muslimanëve osmanë, 1821-1922*, Tiranë: Alsar.
22. Merdjanova, I & Brodeur, P. (2009): Religion as a Conversation Starter Interreligious Dialogue for Peacebuilding in the Balkans, *Continnum*, New York.
23. Merrit, T.: “Religious tolerance in the Ottoman Empire”, <https://prezi.com/md4-lp-xyd4/success-in-religious-tolerance-for-the-ottoman-empire/>
24. Несими, Ќ. (2015): Мултирелигиозноста во мултикултурното османлиско општество, Sh.b. Logos-A, Shkup.
25. Ortayli, I. (2015): Paqja Osmane (përkthyer nga turqishtja nga Altin Qefalia), Sh.b. Logos-A, Shkup.
26. Ortayli, I. (2014): Familja në shoqërinë osmane, Sh.b. Logos-A, Shkup.
27. Pajaziti, A.(2002): Maqedonia në periudhën e tranzicionit shoqëror (1990-1997), Rinia Universitare dhe religjioni (studim sociologjik), Sh.b. Logos-A, Shkup.
28. Pajaziti, A. (2009). Fjalor i sociologjisë, Sh.b. Logos-A, Shkup.
29. Pajaziti, A. (2015): Shoqëri-Ndërtimi në opusin letrar të Mehmet Akif Ersojit, EBSCO Information Services.
30. Pajaziti, A. (2018): Turku fatal: mes kujtesës dhe interesit, Opinion/analizë, Shkup.
31. Raimi, S. (2009): Sociologjia, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë.
32. Ristovski, B., Rahimi, Sh., Mlladenovski, S., Kiselinovski, S., Çepreganov, T. (2016): Historia për klasën e VIII, Sh.b. Albi, Shkup.
33. Ristovski, B., Rahimi, Sh., Mlladenovski, S., Kiselinovski, S., Çepreganov, T. (2016): Historia për klasën e IX, Sh.b. Albi, Shkup.
34. Salabi, M. A. (2009): Perandoria Osmane - Faktorët e ngritjes dhe rënies së saj, Sh.b. Fjala e Bukur, Prishtinë.
35. Sahin, E. (2012). “The Millet System: An Overview of Ottoma Social Policy”, *Cultural Sociology of the Middle-East, Asia and Africa*, New Delhi: Sage Publications.
36. Sopi, M. S. (2018) “Njeriu në botën bashkëkohore dhe tiparet e saj”, *Bota sot*.

37. Temkov, K. (2010): Etika për klasën e VI, Qendra Grafike, Shkup.
38. Tsitselikis, K.. (2012): Aspects of Legal Communitarianism in Greece: Between Millet and Citizenship. Oñati Socio-legal Series [online], 2 (7), 106-118. Akces në: <http://ssrn.com/abstract=2050345>
39. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Historia e Shqipërisë, vëllimi III, Tiranë, 1984.
40. “Europa dhe turqit: Qytetërimi i Perandorisë Osmane”, 25 maj, 2018.
41. Balkan Investigative Reporting Network.
42. Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, Vjetari statistikor i vitit 2002, Shkup.
43. Enti Shtetëror për Statistikë i Republikës së Maqedonisë, vlerësim statistikor i realizuar në vitin 2010, Shkup.
44. “Закон за верските заедници и религиозните групи, Службен весник на РМ, 23 korrik 1997, Shkup.
45. “Tolerance: The threshold of peace” (1994): UNESCO, Paris.
46. https://sq.m.wikipedia.org/wiki/Sistemi_i_Miletit
47. <https://sbunker.net/op-ed/82780/mbi-semundjet-e-shoqerise-moderne/>
48. <https://portalb.mk/448750-toleranca-fetare-te-shqiptaret/>
49. https://en.m.wikipedia.org/wiki/Ottoman_Empire
50. www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=1105
51. www.mapo.al/shoqeria-post-industriale-dhe-e-ardhmja-e-saj/
52. www.bota.al/2016/04/kater-forcat-e-shoqerise-moderne-dhe-si-ta-ribejme-strukturen-tone-sociale/